



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

01 Nr. 07/19
Rahovec, 22.07.2019

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më
30 Korrik 2019 (marte) me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kryetarit të Komunës, për periudhën gjashtë mujore Janar – Qershor 2019,
4. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periudhën gjashtë mujore Janar Qershor 2019,
5. Informatë nga DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor 2018/2019,
6. Informatës nga DSHPS-ja, për periudhën gjashtë mujore Janar – Qershor -2019,
7. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Prokurimit, për periudhën gjashtë mujore Janar – Qershor 2019,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores Komunale për Transparencë Komunale 2019,
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës komunale personave fizik dhe juridik,





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



DRAFT- RREGULLORE NR. 03/2019

RREGULLORE KOMUNALE PËR TRANSPARENCË

Rahovec, 2019

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja i) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008"), Dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, Dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, Dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe nenit 12 paragrafi 2 pika 2.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ miraton këtë:

RREGULLORE KOMUNALE PËR TRANSPARENCË

1. DISPOZITATE PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Më këtë Rregullore synohet që të arrihet:

1. Forcimi i transparencës në punë të organeve të Komunës: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punës së ndërmarrjeve publike komunale dhe rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal.
2. Zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.

Neni 3 Përkufizimet

Në hartimin e kësaj Rregulloreje janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:

1. **"Mbledhjet e Kuvendit të Komunës"** - nënkupton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të këshilltarëve të Kuvendit;
2. **"Komitetet"** - nënkupton trupa ndihmëse që i ndihmojnë Kuvendit në përmbushjen e përgjegjësiave të caktuara me LVL dhe me Statutin e Komunës;
3. **"Pjesëmarrja e publikut"** - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje;
4. **"Njoftimi i publikut"** - nënkupton njoftimin e publikuar në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, publikimin e njoftimeve në gazetatat e përditshme dhe në internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të

organeve administrative, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale;

5. **“Tubime publike”** - nënkupton tubimet e organizuara nga organet e Komunës, organet e Administratës – drejtoritë, institucionet dhe ndërmarrjet publike lokale, me qëllim të njoftimit për punën e bërë apo dhënien e propozimeve;
6. **“Peticioni”** - nënkupton kërkesën kolektive me shkrim që i adresohet Komunës, respektivisht Kryetarit të Komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës;
7. **“Konsultim publik i akteve komunale”** - nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit;
8. **“Qasja në dokumentet zyrtare”**- nënkupton shikimin e dokumenteve zyrtare të Komunës, në pajtim me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun dhe për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Kuvendi i Komunës njofton publikun për mbajtjen e mbledhjeve përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun, të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhje urgjente brenda dites.
3. Njoftimi publik bëhet përmes:
 - mediave të shkruara dhe elektronike dhe
 - ueb-faqes së Komunës.
4. Njoftimi me shkrim për publikun përmban: (i) datën e mbajtjes së mbledhjes, (ii) kohën e mbajtjes së mbledhjes, (iii) vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe (iv) rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.
6. Të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të bëhen publike tetë (8) ditë pas konfirmimit të ligjshmerisë së tij.
7. Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës publikohen në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.
8. Transmetimi në ueb-faqe të Komunës i seancave të Kuvendit të Komunës duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna.

Neni 5

Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetet tjera

1. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera mund të jenë të mbyllura për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Vendimin për këtë e

merr kryesuesi i mbledhjes.

- a. Zyra për Komunikim me Publikun njofton mjetet e informimit publik 7 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi duhet të përmbajë: datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
- b. Të gjitha propozimet e komiteteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të jenë në dispozicion për publikun sipas kërkesës.

Neni 6 **Peticioni**

1. Secili qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetiniciativë, përmes formës së peticionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për qytetarët e komunës.
2. Subjektet e përmendura më lart, mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij, në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:
 - rregullimin e qytetit,
 - mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës - qytetit,
 - urbanizimin e qytetit dhe të fshatit,
 - mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,
 - zbatimin e vetëkontrollit dhe
 - çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.
3. Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes zyrës së drejtorit të Drejtorisë së Administratës.
4. Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.
5. Kur një peticion nënshkruhet nga më shumë se 10% e qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjnë me çështjet që janë të lidhura me qytetin, Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë çështjen. Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatra apo lagje të caktuara, peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës, nëse atë e nënshkruajnë së paku 10% e qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve, banorë të atij fshati apo të asaj lagjeje.
6. Nëse një fshat, vendbanim apo lagje, ka më pak se 4 500 banorë të regjistruar në listat e votuesve, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë 10% të banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve.
7. Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të ceket qartë në secilën faqe. Komunitetet mund t'i bëjnë peticione Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë ashtu siç është cekur më lart. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.

8. Drejtori i Drejtorisë së Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm, ia prezanton Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të peticionit.
9. Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 6 (gjashtë) javësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet parashtrues/it-ve të peticionit.

Neni 7 **Takimet me publikun**

1. Komuna/Kryetari organizon takime publike periodike me qytetarë së paku 2 (dy) herë në vit.
2. Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.
3. Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.
4. Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
5. Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.
6. Njëri tubim duhet të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë.
7. Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy takime me qytetarë, atëherë ndërmjet këtyre mbledhjeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku tre muajsh.
8. Tubimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.
9. Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës dhe në vendet më të frekuentuara në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës dhe atë 14 ditë para mbajtjes së tubimit. Shpalljen publike e bën Zyra për Komunikim me publikun.
10. Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij.
11. Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevojë, ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.
12. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.
13. Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

14. Rekomandim nga KDI (Obligim për publikimin e procesverbaleve në uebfaqe të komunës)

15. Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e radhës.

Neni 8

Konsultimi publik i akteve komunale

1. Rregulloret dhe dokumentet me interes të përgjithshëm të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.
2. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për diskutim publik, përmes:
 - a. shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
 - b. mediave të shkruar dhe
 - c. faqes së Komunës në internet.
3. Njoftimi publik, sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje.
4. Organi kompetent që ka propozuar aktin, duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqarojë përmbajtjen e aktit para publikut.
5. Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidencohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve.
6. Organi që ka propozuar aktin, duhet të informojë Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

Neni 9

Caktimi i zyrtarit përgjegjës

Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar dhe njesia/zyrtari për komunikim me publikun.

Neni 10

Parimet e konsultimit publik

Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin e:

1. **Ligjshmërisë** - duke siguruar se procesi i konsultimit publik zhvillohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme brenda kompetencave komunale;
2. **Transparencës** - që nënkupton një qasje e hapur e komunës për të garantuar se

- qytetarët dhe palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhët zyrtare;
3. **Barazisë dhe mosdiskriminimit** - në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të kenë qasje të barabartë dhe jodiskriminuese në procesin e konsultimit publik;
 4. **Efikasitetit në procesin e konsultimit publik** - duke mundësuar aplikimin e formave dhe teknikave më të përshtatshme për të kuptuar më lehtë përmbajtjen dhe ndikimin e pritur të projekt - propozimeve.

Neni 11

Dokumentet për konsultim publik

Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim:

1. Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës / ekzekutivit;
2. Projekt-buxhetin e Komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor;
3. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme;
4. Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimit në nivel lokal në kuader të fushave sektoriale;
5. Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor;
6. Të gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik.
7. Çfarëdo dokumenti tjetër të paraparë në legjislacionin e zbatueshëm që duhet të nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

Neni 12

Format dhe teknikat e konsultimit publik

Publikimet dalin edhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë të integruar si vegëza në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Neni 13

Planifikimi i konsultimeve publike

Planifikimi i përgjithshëm konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim publik.

Rekomandim i KDI-së (forma dhe teknika tjera të konsultimit publik (takimet publike, konferenca, standat në rrugë, konsultim me shkrim (online) si dhe format dhe teknikat tjera të caktuara me UA për standardet minimale të konsultimit publik në Komunë).

Neni 14
Zbatimi i standardeve të konsultimit publik

1. Komuna bën publikimin e projekt-propozimeve në ueb-faqet zyrtare të komunave dhe në Platformën e Konsultimeve Publike në nivel Qendror.
2. Projekt-propozimet të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe të kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.
3. Komuna për politikën e caktuar të parapara në legjislacionin në fuqi, duhet të sigurojë konsultimin në fazat e hershme të hartimit, palët e interesuara që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtëpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes.
4. Komuna është e obliguar të shpallë rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikojë raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jap sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara.

Neni 15
Aktet nënligjore të Komunës për konsultim publik

1. Aktet e Komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:
 - 1.1 Draft-Statuti i Komunës;
 - 1.2 Projekt-Rregulloret Komunale;
 - 1.3 Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale;

Neni 16
Mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik

1. Kryetari i Komunës siguron që projekt-propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i përmbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
2. Kuvendi i Komunës refuzon aprovimin e projekt-propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kritereve të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.

Neni 17
Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi

Komuna obligohet të koordinohet me MAPL dhe me Zyrën për Qeverisje të Mire / Zyra e Kryeministrit dhe për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal për konsultim publik.

Neni 18
Transparenca e vendimeve të organeve të Komunës

1. Publikimi në faqen zyrtare të Komunës i akteve normative të Komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm në afat prej 7 ditë pune nga konfirmimi i ligjshmërisë së vendimit.
2. Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës pas nënshkrimit dhe pas konfirmimit të

- ligjshmërisë publikohen në faqen zyrtare të Komunës.
3. Aktet normative dhe vendimet e organeve të Komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në faqen zyrtare të Komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësia/zyrtari përgjegjës për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të Komunës.

Neni 19

Transparenca financiare

1. Komuna obligohet në transparencë të planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore duke ndërmarrë veprime konkrete në publikimin e tyre në faqen zyrtare të Komunës.
2. Plani i buxhetit pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
3. Raportet tre mujore financiare sipas afateve të parashikuara me legjislacion sektorial.
4. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
5. Raporti përmbledhës financiar për vitin e kaluar fiskal sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin sektorial.
6. Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Neni 20

Transparenca në aktivitetet e prokurimit

1. Komuna publikon në faqen zyrtare elektronike çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial.
2. Komuna publikon planin dhe raportin e prokurimit në faqen zyrtare elektronike, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin sektorial.

Neni 21

Qasja e drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike

Komuna siguron qasje në informata dhe dokumente publike përmes faqes zyrtare të saj, si:

- 1.1 Planin e punës së Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës.
- 1.2 Planin për Konsultim Publik.
- 1.3 Planin për Komunikim Publik.
- 1.4 Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave të miratuara.
- 1.5 Planin Zhvillimor Komunal, Hartat zonale dhe planet rregulluese urbane.
- 1.6 Raportin vjetor të punës së Kryetarit dhe Kuvendit.
- 1.7 Procesverbalet e takimit të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve obligative.
- 1.8 Të dhënat për biografitë e udhëheqësve të lartë të organeve të komunës dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal.
- 1.9 Emrin, numrin e telefonit zyrtar dhe adresën e e-mail-it të drejtuesve të njësive brenda institucionit.

1.10 Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen edhe:

1.10.1 Procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre.

1.10.2 Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar.

Neni 22

Hartimi i Planeve Vjetore të Punës në Komuna

1. Komunat obligohen që të hartojnë Planet Vjetore të Punës së Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit.
2. Në përputhje me pikën 1 të këtij Neni Komunat obligohen të hartojnë Planin për Komunikim me Publik dhe Planin për Konsultim me Publikun.

Neni 23

Format e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje

1. Komuna siguron mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në çdo fazë të procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave lokale, duke filluar nga:
 - 1.1. Planifikimi;
 - 1.2. Diskutimi;
 - 1.3. Marrja e vendimit;
 - 1.4. Implementimi dhe
 - 1.5. Monitorimi.
2. Mekanizmat e lartpërmendura duhet të shfrytëzohen me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, si:
 - 2.1. Informimi me kohë dhe komunikimi, përmes së cilëve qytetarët do të mund të shprehin sugjerimet, kërkesat dhe vërejtjet e tyre;
 - 2.2. Përfshirjen e qytetarëve në grupet punues;
 - 2.3. Organizimi i takimeve periodike me qytetarë në fshatra dhe lagje;
 - 2.4. Themelimi i Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, në veçanti për planifikimin hapësinor dhe buxhetin;
 - 2.5. Fuqizimi i bashkëpunimit në mes të Komunës dhe shoqërisë civile.
3. Duke promovuar qeverisje të mirë, komunat inkurajojnë personat me nevoja të veçanta të moshuarit, minoritetet, të rinjtë, gratë në procesin e vendimmarrjes duke gjetur forma dhe mekanizma shtesë.

Neni 24

Plani i veprimit për transparencë në Komuna

1. Komunat obligohen të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë në komunë, dhe pas miratimit në kuvendin e komunës, i njëjti publikohet në faqen zyrtare të komunës.
2. Plani i veprimit për transparencë në komuna ka për synim t'i ofrojë publikut qasje në monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.

3. Plani duhet të përfshijë:
 - 3.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
 - 3.2 Mbledhjet e Komiteteve;
 - 3.3 Takimet publike;
 - 3.4 Takimet konsultative;
 - 3.5 Takimet obligative në media për çështje që lidhen me shfrytëzimin e buxhetit të komunës;
 - 3.6 Shpalljet publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit administrativ të komunës;
 - 3.7 Takimet me grupet e interesit për të diskutuar çështje të sigurisë në bashkësi;
 - 3.8 Qasje të shpejtë dhe transparente të shërbimeve për qytetarët;
 - 3.9 Procedurat transparente të Prokurimit;
 - 3.10 Procedurat transparente të punësimit;
 - 3.11 Publikimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare;
 - 3.12 Përfshirja aktive e qytetarëve në vendimmarrje.

Neni 25

Gjuhët për komunikim zyrtar

1. Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhët e tyre, në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të Komunës. Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehen në gjuhët e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.
2. Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të Këshillit të Drejtorëve dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të bëhen në të dy gjuhët, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
3. Aktet normative të Komunës shtypen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga organet e administratës, jepen në gjuhën e palës. Gjuhë e palës konsiderohet gjuha në të cilën pala fillimisht i drejtohet Komunës.
4. Rregulloret komunale dhe vendimet mund të shtypen edhe në gjuhën e një komuniteti tjetër, nëse ai komunitet e kërkon atë.
5. Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
6. Komunikimi me institucionet komunale, institucionet e Republikës së Kosovës dhe organet e organizatave tjera, mund të bëhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Gjuha turke dhe gjuha boshnjake mund të përdoren në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
7. Çështjen e përdorimit të gjuhëve, Kuvendi i Komunës do ta rregullojë me rregullore për gjuhët.

Neni 26

E drejta e publikut për qasje në dokumente zyrtare të Komunës

1. Cilido person fizik apo juridik ka të drejtë në qasje të dokumenteve të organeve komunale, duke ju nënshtruar Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Statutit të Komunës së Rahovecit.

2. Kjo Rregullore vlen për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të Komunës, të hartuara apo të pranuara nga këto organe, për të gjitha fushat dha aktivitetet e Komunës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.
3. Personat fizikë dhe ata juridikë, nga paragrafi 2 i këtij neni, e gëzojnë të drejtën të jenë të informuar për politikën, vendimet dhe punën e organeve të Administratës komunale.

Neni 27

Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare

1. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare parashtrohet në formë të shkruar, duke u përshkruar informacioni që kërkohet, në mënyrë që Komuna ta identifikojë dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar t'i japë arsyet për parashtrimin e kërkesës.
2. Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur me informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën.
3. Organet kompetente komunale e kanë për obligim që, që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.
4. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesërishtëm, kërkuesi mundet, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së përgjigjes nga institucioni publik, të parashtrojë kërkesën për rishqyrtim e çështjes duke kërkuar nga institucioni që të rishqyrtojë vendimin.
5. Afatet për realizimin e të drejtës për qasje në informatë, respektivisht në dokumente publike, të përcaktuara me këtë ligj, mund të vazhdojnë më së shumti deri pesëmbëdhjetë (15) ditë, në qoftë se:
 - 1.1. informata ose dokumenti duhet të kërkohet jashtë institucionit publik;
 - 1.2. me një kërkesë kërkohen disa informata ose dokumente publike, nga e njëjta palë;
6. Përkitazi me vazhdimin e afatit, institucioni publik ose sektori i tij, pa vonesë e më së voni brenda afatit prej tetë (8) ditësh të tjera pune, do ta njoftojë kërkuesin me ecurinë dhe arsyet që kanë shkaktuar shtyrjen e afatit.
7. Nëse organet komunale nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi ka të drejtë ta ushtrojë kërkesën konfirmuese. Në rast se kërkesa konfirmuese refuzohet plotësisht apo pjesërisht, organi komunal kompetent e njofton parashtruesin me mjete ligjore që i ka në dispozicion ai/ajo (nisja e procedurës gjyqësore ose parashtrimin e ankesës Avokatit të Popullit).

2. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 28 Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje përgjegjës është Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Komunale.

Neni 29 Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Transparencë 01 Nr. 907 e datës 30.03.2016
2. Çdo dispozitë e kësaj Rregullore që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, përparësi do të kenë dispozitat e ligjit në fuqi.
3. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. _____
Datë: _____

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality of Orahovac



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

-III- Nr. i prot. 876 Më 09.07.2019
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Informatë nga DKA për përfundimin e vitit mësimor 2018-2019

Të nderuar këshilltarë të Kuvendit Komunal!

Drejtoria Komunale e Arsimit e filloi vitin shkollor 2018-2019 më 3 Shtator 2018 sipas kalendarit të paraparë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Viti shkollor, ndonëse filloi mirë dhe me sukses u përmbyll gjysmëvjetori i parë, në gjysmëvjetorin e dytë sikur në të gjitha komunat, edhe në komunën tonë punëtorët e arsimit u hodhën në grevë, e cila u organizua nga SBASHK dhe zgjati për 3 javë të tëra. Drejtoria Komunale e Arsimit disa herë bëri përpjekje që t'i bindë grevistët për ndërprerjen e grevës, por pa sukses. Edhe pas ndërprerjes së grevës dhe rifillimit të procesit mësimor, Drejtoria e Arsimit bëri përpjekje disa herë të realizojë kompensimin e orëve dhe ditëve të humbura, por në çdo përpjekje u përballëm me bojkotin e organizuar nga sindikalistët.

Me një fjalë, me veprimet e papërgjegjshme të sindikatës edhe pas grevës, rezultoi që viti mësimor 2018-2019 të mos jetë i plotë, por me 15 ditë mësimi të humbura. Për pasojë, mbetëm prapa me realizimin e planprogrameve mësimore në të gjitha nivelet e shkollimit dhe më së keqi e pësuan nxënësit e klasave të para, të cilët mezi arritën t'i mësojnë shkronjat dhe të festojnë festën e Abetares.

Ky vit shkollor vazhdon, ndërkohë që përfundoi viti mësimor, gjegjësisht gjysmëvjetori i dytë i vitit mësimor, por mund të themi se ishte një vit mësimor i vështirë për DKA-në, mësimdhënësit dhe veçanërisht me pasoja për nxënësit.

Përkundër të gjitha zhvillimeve dhe vështirësive që na përcollën gjatë vitit mësimor, DKA u angazhua maksimalisht që gjatë ditëve kur u mbajt procesi mësimor të kemi mbarëvajtje.

Gjatë vitit mësimor nuk munguan edhe aktivitete të ndryshme edukativo arsimore, kurrikulare dhe jashtë kurrikulare me nxënësit tanë. U mbajtën aktivitete të shumta kulturore e sportive dhe u organizuan gara nga më të ndryshmet, duke filluar me nxënësit e klasave të ulëta të programit fillor e deri tek klasat e Shkollave të Mesme të Larta.

Garat kryesore që u mbajtën gjatë vitit mësimor janë:

- ❖ Garat e Olimpiadës Matematike;
- ❖ Garat e Olimpiadës së Fizikës;
- ❖ Garat e kreativitetit dhe mendimit kritik të organizuara nga Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport;
- ❖ Garat e diturisë, të organizuara poashtu nga Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, të cilat vazhduan deri në mesin e muajit Korrik.

Secila prej këtyre garave filluan të zhvillohen nga niveli i klasave dhe shkollave e deri tek niveli komunal e republikan. Vlen të theksohen edhe sukseset, por sukcesi më i madh i nxënësve të komunës sonë është vendi i dytë në garën e Olimpiadës Republikane të Fizikës, i nxënësit tonë Selim Krasniqi, nxënës I klasës së 9-ë nga Shfmu "Milaim Krasniqi" në Pastasel, i cili pastaj bashkë me ekipin fitues mori pjesë në Garën Evropiane të Olimpiadës së Fizikës që u mbajt në Riga të Letonisë nga 29 Qershori deri më 5 Maj 2019. Poashtu, në garën e kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik, nxënësit e dy shkollave të komunës sonë, të cilët morën pjesë në garën republikane, zunë vendin e dytë dhe të tretë me shfaqjet e tyre teatrale.

Grupi "Nusja" nga Shfmu "Skender Kastrati" në Malësi të Vogël zuri vendin e dytë.

Grupi "Socializimi" nga SHML "12 Maji" në Ratkoc, zuri vendin e tretë.

Edhe këtë vit mësimor kemi vazhduar me traditën e ndarjes së bursave për studentët e komunës sonë dhe këtë vit është rritur numri i përfituesve të bursave nga 63 studentë përfitues të bursës që ishte vitin e kaluar, në 95 studentë përfitues të bursës në këtë vit.

DKA edhe këtë vit po vazhdon me realizimin e projekteve të saj, siç janë projektet për ndërtimin e 3 objekteve shkollore, për ndërtimin e 3 çerdheve, projekteve për ngrohje qendrore në 3 shkolla dhe projektet për drenazhimin dhe hidroizolimimin e dy objekteve shkollore. Poashtu, DKA ka kontratë edhe për riparime në shkolla dhe furnizime të shkollave me teknologji informative dhe me libra për bibliotekat shkollore.

Edhe këtë vit u mbajt Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasave të 9 –a dhe Testi i Maturës për nxënësit e klasave të 12-a. Rezultatet e kalueshmërisë së nxënësve në Testin e Arritshmërisë në nivel komune ishin 49.25%, ndërsa rezultatet e Testit të Maturës në Shkollat e Mesme të Larta, ishin:

Xhelal Hajda-Toni	64.77%
Ukshin Hoti	50.08%
12 Maji	40.97
Selajdin Mullabazi - Mici	49%

Mesatarja e kalueshmërisë e nxënësve të komunës së Rahovecit në Testin e Maturës ishte 51.20%. Vërehet një rënie e kalueshmërisë në të dyja testet, por kjo është gjendje e cila më së shumti i afrohet gjendjes reale të dijes së nxënësve të komunës sonë. Them i kështu sepse nga MASHT dhe nga DKA u ndërmorën masat adekuate për të reduktuar në maksimum kopjimin përmes moslejimit të përdorimit të telefonave të mençur.

Pasi në kohën kur po raportojmë ende vazhdon procesi i riprovimeve, ne në DKA ende nuk kemi arritur të nxjerrim raportin e saktë të suksesit të nxënësve të këtij viti shkollor. Statistikat e suksesit do të jenë të gatshme në fund të vitit shkollor, gjegjësisht më 31 Gusht 2019.

Ndërkohë, ka mbaruar edhe afati i parë i regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme dhe kompletimi i regjistrimit të tyre sipas drejtimeve dhe profileve arsimore do të ndodhë në afatin e dytë, i cili do të realizohet në gjysmën e dytë të muajit Gusht. Poashtu, regjistrim të nxënësve kemi patur edhe në klasat parafilllore dhe në klasat e para.





Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu
Department of Health and Social Welfare



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 2133 Më 10.07.2019
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

INFORMATË NGA DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE JANAR-QERSHOR 2019

Drejtori i DSHPS-së
Samir Mustafa

Rahovec, Korrik 2019

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Aktivitetet e DSHPS-së për periudhën raportuese janë:

- Konsultimet dhe takimet e rregullta me stafin, Drejtorin e QPS-së dhe QKMF-së në Rahovec,
- Përpilimi i raporteve të punës për vitin 2019, dhe krijimi nevojës për raportim të vazhdueshëm,
- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHMS-së,
- Shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve si dhe të atyre për ndihmë momentale-financiare,
- Takimi me Drejtorin e SHSKUK-së lidhur me funksionalizimin e Qendrës së Dializes,
- Shëndeti Publik: Në kuadër të Drejtorisë komunale të Shëndetësisë egziston edhe shërbimi për mbrojtjen e shëndetit publik i cili kujdeset për mbrojtjen e shëndetit të popullatës pa dallime etnike, race, moshe, gjinie etj. sikurse edhe shërbime të tjera. Kjo Jane evidentuar dhe shpërndare gjithsejtë 1322 thirrje-ftesa për vaksinimin e fëmijëve në komunë tonë.
- Përpilimi shkresave të ndryshme zyrtare (vendime, njoftime, propozime, autorizime etj gjithsej 59).
- Takim pune me përfaqësuesit e Shoqatave të dala nga Lufta ,vazhdimi i bashkëpunimit me këto kategori dhe caktimi i takimeve të rregullta mujore në mes të DSHPS-se dhe kryesisë së shoqatave,
- Pjesëmarrje në komisione të ndryshme,
- Komisioni për ndarjen e ndihmave momentale-financiare ka shqyrtuar kërkesat dhe janë aprovuar dhe refuzuar si më poshtë:

Nr.i kërkesave për ndihmë momentale-financiare	Miratuara	Refuzuara	Gjithsej
	209	56	265

- Kërkesat për ndërtimin e shtëpisë në bashkëpunim me Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit “

Nr.i kërkesave	Miratuara	Refuzuara	Gjithsej
	8	24	32

- Gjatë kësaj periudhe ne maternitet janë kryer gjithsej keto lindje:

Komuna e Rahovecit	Komuna e Malishevës	Gjithsej
39	2	41

- Lëshimi i vërtetimeve për familjar të personave të vrarë, zhdukur, dëshmor, të plagosur, gjithsej të **64 vërtetime**, si dhe janë vërtetuar **52 formular** për punëtorët tanë që përkohësisht punojnë dhe veprojnë në shtetet tjera, të cilët gëzojnë të drejtën në shtesat fëmijërore në vendin ku punojnë dhe veprojnë.
- Janë evidentuar dhe percjellë 12 vendime për kompenzimin e derivateve të naftës në Hemodializë për periudhër gjashtë mujore Janar- Qershor 2019
- Plotësimi i **formularëve(aplikacioneve)** për shërim jashtë vendit në bazë të udhëzimeve të QKUK-së (komisioni mjekësor) dhe janë udhëzuar palet ta dorëzojnë aplikacionin në Ministrinë e Shëndetësisë.

RAPORT FINANCIAR

JANAR – QERSHOR 2019



HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit të Drejtorisë për Shëndetsi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën Janar – Qershor 2019, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.

Buxheti i Komunës për vitin 2019, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2019, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

BUXHETI I PLANIFIKUAR PËR VITIN 2019

Kategoritë Ekonomike	Vlera	Burimi i Financimit
Paga dhe Mëditje	949,227.00	Granti Specifik
Mallra dhe Shërbime	324,449.00	Granti Specifik-Humarrja
Shpenzimet Komunale	60,000.00	Granti Specifik
Subvencionet	50,000.00	Te hyrat vetanake
Investimet Kapitale	490,000.00	Granti Specifik

Totali i Buxhetit të Planifikuar 1,873,676.00

Granti Specifik 1,688,778.00

Huamarrja 134,898.00

Te Hyrat vetanake 50,000.00

RAPORTI I SHPENZIMEVE PËRMBLEDHËSE

Mallra dhe shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencionet dhe Transferet	Investimet kapitale	Paga dhe Meditje	TOTALI
99,420.70	25,463.63	27,780.00	304,982.30	451,682.91	909,329.54

BUXHETI I PLANFIKUAR 2019	BUXHETI SHPENZUAR	%
1,873,676.00	909,329.54	48.53

MALLRA DHE SHERBIME

Nr	KODI EKONOMIK	PËRSHKRIMI	2018	2019
1	13130-43	Meditjet e udhetimit	246.80	
2	13310	Shpen.per internet		
3	13320	Shpen.tjera tel.	1,624.78	
4	13330	Shërbime postare	383.00	451.80
5	13430	Sh.ndry.shendet	180.00	120.00
6	13460	Sherb kont tjera	15,346.50	19,218.27
7	13470	Sherbime teknike	92.00	
8	13501	Moblje me pak se 1000 euro	7,210.50	
9	13509	Pai. Mëpak1000e(41)		
10	13610	Furnizimi i zyres	2,731.30	1,988.37
11	13620	Fur.ushq.dhe pije	64.60	527.02
12	13630	Furn. me medik.	2,864.37	19,024.90
13	13640	Furn.hixhien	496.50	1,237.36
14	13650	Furn.me veshmb.		116.00
15	13720	Nafte per ngrohje	23,745.50	22,016.37
16	13720	Nafte per gjenerator		
17	13760	Dru		495.00
18	13780	Karbu.për vetura	10,546.97	16,516.00
19	13950	Regjistrimi i auto	555.00	480.00
20	13951	Sigurimi i auto.	821.28	2,262.06
21	14010	Mirmb.rip.i auto	7,274.06	9,479.81
22	14020	Mirmb.e ndërtes		361.00
23	14024	Mirmb objekte shendetsore	23,687.77	4,671.52
24	14210	Reklama		
25	14220	Botime publikime		320.00
26	14310	Dreka zyrtare	72.20	135.22
27	14410	Shpenz sipas gjykatës		
		TOTALI	97,943.13	99,420.70

1.51

%

KOMUNALITË

Nr	KODI EKONOMIK	PËRSHKRIMI	2018	2019
1	13210	Rryma	23,160.58	19,437.57
2	13220	Uji	4,108.47	3,650.74
3	13230	Mbeturinat	1,441.57	1,830.38
4	13250	Telefoni	374.63	544.94
		TOTALI	29,085.25	25,463.63

(12.45)

%

SUBVENCIONET

Nr	KODI EKONOMIK	PËRSHKRIMI	2018	2019
1	21200	Subvencione	32,650.00	27,780.00
		TOTALI	32,650.00	27,780.00

(14.92)

%

INVESTIMET KAPITALE

Nr	PROJEKTI	PËRSHKRIMI	2019
1	45693	Ndertimi i Qendres Kryesore te Mjeksis Familjare-Emergjencia	249,982.30
2	48171	Vitalizimi i infrastruktures per funksionalizimin e projektit shtruterit shtepiak	55,000.00
		TOTALI	304,982.30

PAGAT

Nr	KODI	PËRSHKRIMI	2018	2019
1	111	JANAR	71,707.70	72,323.43
2	111	SHKURT	72,560.81	73,395.63
3	111	MARS	70,479.49	74,807.39
4	111	PRILL	70,116.66	73,992.69
5	111	MAJ	70,650.69	77,601.88
6	111	QERSHOR	70,642.20	79,561.89
		TOTALI	426,157.55	451,682.91

5.99


%

PARTICIPIMI

Nr	KODI	PËRSHKRIMI	2018	2019
1	21	JANAR-QERSHOR	16,098.50	18,655.20
		TOTALI	16,098.50	18,655.20

15.88

%



1. RAPORTI I SHËRBIMEVE SOCIALE TË QPS-së 01.01.2019 deri 30.06.2019

#	Kategoria e shërbimeve (aktivitetet ofrimit të shërbimeve)	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Gjithsej
		TM 1		TM 2				
1	Delikuenca e të miturve	23	2	6	2	0	1	34
2	FAKP	1	0	0	1	3	1	6
3	Besimi i fëmijëve j.martesor	1	0	0	0	2	0	3
4	Lidhja e kurorës para moshës madhore	1	0	0	0	1	0	2
5	Bashkëjetesa e hershme	0	0	0	0	0	1	1
6	Vlerësim social lirim nga nënsht.	6	5	4	11	10	8	44
7	Vërtetim për zotësinë e veprimit	64	22	33	15	23	22	179
8	Verifikimi i gjendjes faktike	1	159	1	3	4	2	170
9	Kërkesë për kont. personale	1	0	1	0	0	1	3
10	Kërkesë për adoptim	0	0	0	0	0	0	0
11	Mendim për adoptim	0	0	0	0	0	0	0
12	Heqja e së drejtës prindërore	0	0	0	0	1	0	1
13	Dhunë në familje	2	0	4	1	2	4	13
14	Rreg. i marrëdhënieve bashkëshortore	0	1	0	2	0	0	3
15	Heqja e zotësisë për veprim	0	0	0	0	0	0	0
16	Shërbimet tjera	0	0	0	0	0	0	0
17	Shkurorëzimi dhe besimi i fëmijëve	2	0	0	0	0	0	2
18	Shkurorëzimi pa fëmijë	2	1	0	0	0	0	3
19	Tentim vetëvrasje	0	1	1	0	0	1	3
20	Fëmijë me sjellje asociale	0	0	3	2	3	5	13
21	Regjistrim i mëvonshëm i fëmijut	0	0	1	0	0	0	1
22	Fëmija i braktisur	0	0	1	0	0	0	1
23	Person me të meta psikike	1	0	0	0	0	3	4
24	Fëmijë i keqtrajtuar	0	0	1	0	0	0	1
25	Rregullimi i marrëdhënieve në familje	0	0	1	0	0	0	1
26	Strehimi i përkohshëm i familjes dhe tek të afërmit	0	0	1	0	1	0	2
27	Vërtetim mbi zbatimin e masës edukative	0	0	3	0	0	0	3
28	Kujdestaria e rregullt	0	1	0	0	0	0	1
39	Mbikëqyrja - Pezullim nga mbajtja e dënimit	0	1	0	0	1	0	2
30	Pranimi i atësisë	0	1	0	0	0	0	1
31	Tentim dhune në familje	1	0	0	0	0	0	1
32	Kujdestaria ndaj të miturve	0	0	0	1	2	0	3
33	Viktimë e dhunës seksuale	0	0	0	1	0	1	2
Totali:		106	194	61	39	53	50	503

2. RAPORTI I SKEMËS SË NDIHMËS SOCIALE 01.01.2019 deri 30.06.2019

2.1 Të dhënat për numrin e familjeve dhe shuma e mjeteve sipas muajve

Nr.	Muajt	Numri i familjeve	Shuma e mjeteve
1	Janar	627	67,525.00
2	Shkurt	624	67,237.50
3	Mars	626	67,792.50
4	Prill	639	69,172.50
5	Maj	631	68,245.00
6	Qershor	634	68,957.50
Totali:			408,930.00 EUR

2.2 Aktivitetet

#	Kategoria e shërbimeve (aktivitetet e ofrimit të shërbimeve)	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Gjithsej
		TM 1			TM2			
1	Nr. i rasteve që kanë aplikuar për here të parë	09	09	04	07	05	02	36
2	Nr. i rasteve që kanë ri aplikuar	110	80	103	81	39	37	450
3	Nr. i familjeve të verifikuara dhe ri verifikuara	114	89	107	88	44	39	481
4	Nr. i familjeve të dërguara në Komision Mjekësor	50	66	63	69	58	48	354
5	Kërkesa për rishqyrtim (shkalla e parë)	00	01	00	00	00	01	2
6	Ankesa (shkalla e parë)	01	00	00	00	00	01	2
7	Autorizim për tërheqje të mjeteve	00	00	01	00	02	00	3
8	Nr. i familjeve të riaktivizuara	07	11	05	10	09	15	57
9	Nr. i familjeve të ndërprerë	08	07	02	02	02	04	25
10	Kthimi i mjeteve në SNS	00	02	02	01	02	00	7
11	Ndihma momentale (DNS)	01	00	01	00	00	00	2
12	Vërtetim për shfrytëzues të NS	00	00	00	00	00	00	0
13	Vërtetim për jo shfrytëzues të NS	04	11	13	07	07	03	45
Kërkesat për rishqyrtim dhe ankesat								
	Kërkesat të aprovuara	00						
	Kërkesat të Refuzuara	01						
	Ankesat të aprovuara	00			01-në rishq.			
	Ankesat të refuzuara	00-01 në shqyrtim						
	Shuma e mjeteve të kthyera	372.50 EUR						
Punë të kryera, Totali:		304	276	301	265	168	150	1464

3. RAPORTI PËR ADMINISTRATË DHE FINANCA 01.01.2019 deri 30.06.2019

3.1 Lëndë të regjistruara në protokollet e QPS-së

Emërtimi i Protokollit	Numri i lëndëve						
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Gjithsej
01-Administrata	06	05	12	07	08	08	46
02-Shërbimet Sociale	109	193	58	43	54	46	503
03-Skema e ndihmës sociale	15	10	19	08	12	07	71

3.2 Mjetet nga të hyrat vetanake

Mjetet nga pagesat e shërbimeve dhe dorëzimi i tyre			
Muaji	Të dhënat		
	Data	Vlera e dorëzuar	Gjithsej
Janar	18.01.2019	166 EUR	
Shkurt	21.02.2019	133 EUR	
Mars			
Prill	03.04.2019	111 EUR	410 EUR
Maj	24.05.2019	147 EUR	
Qershor	27.06.2019	152 EUR	709 EUR
Mjetet e mbledhura i dorëzohen zyrtarit për pagesa në QKMF!			


RAPORTI NGA QKMF NR I VIZITAVE SHËNDETSORE

01.04-30.06 2019	NR PACIENTEVE	VIZ E PARA	PUNETORET TJERE SHENDETSOR	REFERIME JASHE QKMF RAHOVEC	NR I REF. PER KONSULTE	NR I REF NE DIAGNOSTIKNE SEKONDARE	TE PARTICIPUAR
MJEKSIA FAMILJARE ND I	14733	1455	11929	545	481	64	2321
MJEKSIA FAMILJARE ND II	10297	1946	13287	363	276	87	1959
QMF-I RAHOVEC	8	3	50	0	0	0	0
QMF-I RAHOVEC/ STOM	625	208	0	0	0	0	0
MATERNITETI	1051	95	907	11	0	11	0
DISP GRAVE	1364	38	0	4	0	4	168
PEDIATRIA ND I	6058	1268	4453	422	324	98	9
PEDIATRIA ND II	2028	523	4384	53	19	34	137
VAKCINIMI	0	0	1168	0	0	0	0
KESHILL GRAVE	296	148	173	1	0	1	31
KESHILL DIABET	0	0	105	0	0	0	0
KESHILL HIPERTENSION	0	0	105	0	0	0	0
STOMATOLOGJIA ND I	3954	0	0	0	0	0	233
STOMATOLOGJIA ND II	1027	0	0	0	0	0	213
LABORATORI	0	0	1710	0	0	0	248
RO KABINETI	0	0	1146	0	0	0	409
KUJDESTARIA	7972	4433	10486	675	289	359	573
FIZIOTERAPIA	0	0	944	0	0	0	273
UROLOGJIA	3057	933	138	80	15	58	521
AMBUL LAGJA EPERME	1375	182	981	251	112	139	88
HOQA E MADHE	0	0	0	0	0	0	0
QMF KRUSHE E MADHE	5429	1189	2960	532	213	319	696
LABORATORI K.M	0	0	133	0	0	0	16
STOMATOLOGJIA K.M.	1050	362	0	0	0	0	133
VAKCINIMI K.M.	0	0	1368	0	0	0	0
QMF RATKOC	7916	1681	3108	521	258	263	907
LABORATORI RATKOC	0	0	145	0	0	0	24
STOMAT RATKOC	832	422	346	0	0	0	66
VAKCINIMI RAT	0	0	1587	0	0	0	0
QMF DRENOC	937	406	967	49	26	23	92
STOMAT DRENOC	0	0	0	0	0	0	0
VAKC DRENOC	0	0	195	0	0	0	63
QMF BELLACERK	1906	777	1230	163	136	25	240
LABORATORI BELLACERK	0	0	64	0	0	0	8
STOMAT BELLACER	369	119	0	0	0	0	23
VAKCINIMI BELL	0	0	474	0	0	0	0
QMF ÇIFLLAK	449	216	1227	81	80	1	41
VAKCINIMI ÇIFLLAK	0	0	390	0	0	0	0

QMF APTERUSHË	2339	1207	1847	161	131	30	130
VAKCINIMI APTERUSHË	0	1052	288	206	171	34	295
AMF XËRXE	3077	467	1445	170	135	30	237
AMF RADOSTË	680	192	1393	64	56	8	44
AMF ZAQISHT	0	108	0	9	0	9	10
AMF PALLUZHE	287	224	351	42	21	21	37
AMF BRESTOC	265	123	377	24	17	7	23
	79381	19777	71861	4427	2760	1625	10268


QKMF RAHOVEC : RAPORTI I PERSONAVE TE PICKUAR NGA RIQERAT
KRAHASUAR: 30.06.2017 / 2019

		VITI 2017	2018	2019
1	Rahovec	47	50	21
2	Zoqisht	4	6	1
3	Zatriq	1		
4	Xerxe	6	6	
5	Vrajak	1	3	5
6	Sapniq	3	2	1
7	Senoc	1	8	3
8	Retie	2	5	
9	Ratkovc	7	5	18
10	Radoste	10	6	2
11	Qifllak	1	1	3
12	Palluzhe	9	5	11
13	Pastasel	8	7	4
14	Past. Eper.	7	1	1
15	Past. E Ult	7	3	
16	Apterush		2	3
17	Nashpall	4		3
18	Nagac	1	2	3
19	Kromovik		1	1
20	Kaznik	1	2	1
21	Krusha Madhe	4	5	8
22	Hoqa e vogel	11	4	3
23	Gexhe		2	1
24	Bellacerk	9	7	2
25	Drenoc	5	4	9
26	Dobidol	2	3	1
27	Dejne	3	7	6
28	Celin		3	4
29	Brestovc	17	11	5
30	Bratotin		1	1
31	Apterush	7	6	
32	Komunat tjera	3	4	5
	TOTALI	181	172	126



Sfidat dhe objektivat

- Përkundër të arriturave në KPSH, zbatimi i konceptit të mjekësisë familjare në praktikën e përgjithshme nuk është në nivelin e dëshiruar ku do të përpiqemi që të krijojmë kushte për zbatimin e plotë të mjekësisë familjare duke u angazhuar për shtimin e Specialistëve të Mjeksisë familjare si dhe formimin e kartotekës-kartelave mjekësore, zoonimi i popullatës si parakusht shumë i rëndësishëm për konceptin e mjekësisë familjare.
- Do të vazhdohet me aktivitetet sidomos me investime kapitale.
- Rritja e numrit të mjekëve të rinjë dhe teknikeve medicinale që të mbulohet numri i përafërt me mjek dhe tek.med. për koka banori (zoonimi i popullatës),





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



1

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.06.2019** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi,

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes, i nderuar kryetar i komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i komunës z. **Fatmir Iska**, drejtor të drejtorive komunale, pjesëtar të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, gazetarë dhe media, dh ju kuvendarë të nderuar. Para se të ju lexoj rendin e ditës fjalën ja japë kryetari të komunës z. Smajl Latifi.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ka qenë një kërkesë e kahershme që anëtarët e kuvendit të komunës së Rahovecit të pajisen me lloptop, besoj se në fund të kësaj mbledhje përgjegjësi i IT-së do i kryej ato punë teknike dhe do ju shpërndahen lloptopat secilit anëtar të kuvendit. Kisha kërkuar nga ju që në fund të mbledhjes të merrni një vendim që këto lloptop të ju mbesin në shfrytëzim edhe pas mandatit, besoj se kësso praktika kanë edhe komunat e tjera e jo vetëm ne. Arsyeja është se teknologjia është duke avancuar ditë për ditë dhe ka mundësi që pas dy viteve të dalin pajisje më të reja, dhe këto nuk do të bëjnë punë ashtu siç duhet dhe ndoshta duhet edhe këto të nderohen për të kryer punë siç duhet.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendar është bërë përpjekje dhe është arritur që edhe ne si kuvend të kemi pajisjet e domosdoshme për punën që do të bëjmë. Kjo është kërkuar nga ana jonë edhe për arsye se është duke u bërë shpenzim goxha i madh gjatë shtypjes së materialit si për KPF ashtu edhe për mbledhje të kuvendit. Pastaj disa herë kemi pas probleme me dërgesë të materialit fizik sepse shumë herë disa kuvendarëve nuk i ka shkuar me kohë materiali në shtëpi. Të nderuar kuvendar kemi edhe një kërkesë që të shtohen edhe dy pika shtesë, kjo do të realizohet nëse ju jeni të pajtimit. Pikat shtesë janë: 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës Për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, afatshkurtër dhe afatgjatë, sipas udhëzimit të ri administrativ ky komision duhet të i ketë 5 anëtar, pra nga 7 sa i ka. Dhe pika e 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës Për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave. Ky komision nga 3 sa i ka duhet të i ketë 5 anëtar. Pra këto ndryshime duhet të bëhen në numrat e anëtarëve të komisionit, sepse tani ka dalë një udhëzim i ri administrativ ku na obligon të gjitha komunat e Republikës së Kosovës të i bëjnë këto ndryshime. Për më shumë e ftoj z. Isak Hotin, shefin e zyrës ligjore.

Isak Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar të pranishëm ne në muajin shkurtë i kemi nxjerrë dy vendime të cilat i ceku kryesuesi, ligji i ri ka hyrë në fuqi për dhënien e shfrytëzimit të pronës komunale me datë 03 prill 2019, dhe ky ligj neve na obligon që ne të i plotësojmë dhe ndryshojmë vendimet në bazë të këtij ligji. Arsyeja dhe faji i vetëm është i imi, sepse në kohën kur është dashur të vinë këto vendime në kuvend i kam qitë mbas mendsh, prandaj nëse ju pranoni dhe jeni të gatshëm këto janë thjeshtë formim i komisioneve dhe nuk e besoj se ka diçka për tu shqetësuar. Tek komisioni për ankesa nuk i kemi më 3 anëtar por 5, dhe nuk i kemi më 7 anëtar tek komisioni vlerësues por i kemi 5 anëtar, besoj se përsëri keni mundësi të bëni një kombinim. Kërkoj mirëkuptimin e juaj në mënyrë që mos të mbesim mbrapa me vlerësim të ofertave dhe të ankesave, neve edhe ashtu edhe një muaj e gjysmë na shkon kohë deri sa të i finalizojmë këto dy vendime.

Kryesues – Tani të nderuar kuvendar e qes në votim Propozimin e Kryetarit të Komunës sa i përket pikës për marrje të vendimit që lloptopat që do i merrni të mbesin tek ju edhe pas përfundimit të mandati si kuvendar. Konstatohet se është aprovuar propozimi i kryetarit që si pikë shtesë të jetë edhe pika e lartë cekur.

Të nderuar kuvendar i qes në votim pikat shtesë që të jenë pjesë e kësaj mbledhje: **Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar që këto dy pika shtesë të jenë pjesë e kësaj mbledhje.** Tani të nderuar po ju

lexoj rendin e ditës me këto tre pika shtesë, besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë?
Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Informatë e Raportit Financiar vjetor të Komunës së Rahovecit për vitin 2018 e Auditorit Kombëtar,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër për raste të veçanta,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 110000 m² në Rahovec,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 42099 m² në Rahovec,
8. Informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për objektet e trashëgimisë kulturore – historike të Komunës së Rahovecit,
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit,
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit,
11. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit për vitin 2019,

PIKAT SHITES

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës Për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajshme të Komunës në shfrytëzim, afatshkurtër dhe afatgjatë
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës Për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave,
14. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për dhënien e Lloptopave anë anëtarëve të kuvendit.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikave të rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës për këtë mbledhje me pikat shtesë: Konstatohet se unanimisht është aprovuar Rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush të jepe ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryesues tek diskutimi imë faqe nr.4 tek diskutimi imë është bërë një gabim teknik tek reshti 6, kishte me qenë mirë që ky gabim teknik të përmirësohet.

Kryesuesi – Ju faleminderit z. Cene gjithsesi se do të përmirësohet ky gabim teknik, a ka edhe dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit, nëse jo atëherë e qes në votim Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e 2 të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje e parë i nderuar, ne banorët e ndërtesave të reja që janë afër komunës e kemi dorëzuar një peticion, në lidhje me problemin që janë duke hasur banorët në bartjen e pronës në emër të vetin, pyetje ime është: Sa keni punuar ju si institucion për të bërë diçka në këtë drejtim. Nëse ju nuk keni mundur të gjeni mekanizma ligjor unë propozoj që ajo kërkesë të vijë në kuvend, dhe pastaj ne si kuvend ta formojmë një komision dhe të vazhdohet me procese ligjore të mëtutjeshme. Pyetje e dytë ka të bëjë me parkingje, jemi duke parë çdo ditë gjendjen aktuale të mungesës së parkingjeve, tani edhe policia është duke i dënuar të gjithë ata që i parkojnë makinat në rrugë dhe trotuare dhe që po ndodhë është shumë mirë. Propozoj që të ndërtohet një parking në vendin ku ka qenë shkolla e mesme afër objektit të zjarrfikësve, dhe kjo hapësirë të shfrytëzohet për parkingje. Pyetje e fundit është: ku ka mbetur procesi i ujit të pijes të fshatit Pastasel.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i kam dy kërkesa ose sugjerime, ne e dimë që Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë një vendim për mbylljen e të gjitha lojërave të fatit ose basteve sportive. Por ne si komunë e kemi ende në fuqi rregulloren 01 Nr.576 të datës 28.02.2017, në atë kohë është bërë plotësim ndryshimi i kësaj rregullore, ku janë liruar 63% të bizneseve nga taksa komunale. Duke marrë për bazë tani vendimin e qeverisë dhe shumë taksa që është dashur të inkasohen tani më nuk do të inkasohen sepse janë mbyllur të gjitha lojërat e fatit, prandaj propozoj dhe kërkoj nga Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim Ekonomik, duke u bazuar në lëvdatat e mëdha që i ka marrë nga USAIDI për lehtësirat në zhvillimin e bizneseve, që të i zhvilloj procedurat për plotësim ndryshimit të rregullores për taksa dhe tarifa. Pastaj të gjitha bizneset që janë në komunën e Rahovecit të lirohen nga taksa komunale që është diku rreth 200-250 €. Me këtë veprim besoj se do i marrim poenët edhe më pozitivë në të ardhmen si komunë, po ashtu besoj se shumë grande do të vinë në komunë si nga ana individuale që kërkojnë bizneset komunale ashtu edhe si komunë. Kërkesa tjetër është për Drejtorin e DSHPS-së, i nderuar më parë barnatoret kanë punuar në Rahovec me një orar prej 24 orë, personalisht e kam rastin por ka edhe raste të tjera nuk jam vetëm unë, pas orës 23:00 në Rahovec çdo barnatore e ke të mbyllur, ne që kemi nevojë duhet të shkojmë në Gjakovë që ti blejmë barërat elementare. Kishte me qenë mirë që drejtori të i ftojë të gjithë këta pronarë të barnatoreve dhe të mbajë një takim, dhe të bëjnë një orarë ku të paktën një barnatore të qëndrojë e hapur për 24 orë, shumica e komunave e kanë këtë rregull.

Afërdita Thaqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam një kërkesë, të nderuar besoj se njëra ndër kërkesat më të domosdoshme dhe më emergjente është që të bëhet rruga dhe mbrojtja e banorëve të shumë fshatrave, e sidomos e fshatit Kramovik dhe Çifllak. Për arsë se nga gropat e zhavorrit dhe të shtratit Drini i Bardhë ne i kemi pasur dy viktima, njëri nga fshati Çifllak dhe tjetri nga fshati Kramovik. Këto dy fshatra dhe fshatrat e tjerë derti tek fshati Xërxë që shtrihen lumit Drini i Bardhë, janë të rrezikuar çoftë nga lumi, çoftë nga gropat e zhavorrit. Kërkoj nga komuna dhe institucionet më të larta që të ndërmarrin masa deri sa

nuk është bërë shumë vonë, kjo pjesë pop ashtu çdo ditë bëhet më e rrezikuar nga gjallesat e ndryshme. Ideja ime është që buzë shtratit Drini i Bardhë të ndërtohet një rrugë dhe krahas rrugës të bëhet mbrojtja nga Drini i Bardhë, dhe ndoshta me këtë një ditë do ti kthehet bukuria e kësaj pjesa ashtu siç ka qenë dikur, besoj se nuk është e vështirë të gjenden mjetet për këtë punë, por mendoj se duhet më shumë angazhim nga komuna, pastaj lënda e parë që është zhavorri gjendet dhe sigurohet shumë lehtë. Për këto investime po ashtu ka donacione që jepen nga Bashkimi Evropian, pasi këta ndihmojnë shumë në projekt për mbrojtjen e tokave dhe lumenjve, por një gjë duhet të kemi të qartë që Bashkimi Evropian investon vetëm atëherë kur bëhet projekti, kurse për projekt besoj se duhet të kujdeset komuna si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendrorë, për realizimin e këtij projekti kërkoj mbështetjen e kryetarit të komunës.

Vahid Krasniqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryetar në kodin buxhetor vitin e kaluar i kemi futur ndërtimin e disa rrugëve dhe kanalizimeve në fshatin Drenoc, këto rrugë nuk janë përfunduar ende, disa punime janë ndërprerë në gjysmë. Një kanalizim afërsisht me distancë prej 100 m ka mbetur në gjysmë, kjo është tek lagja Makshana, ky kanalizim që nga mandati i kaluar ka mbetur ashtu edhe pse është premtuar që do të rregullohet. Pastaj i kemi edhe dy rrugë të pa përfunduara në fshatin Senoc edhe këtu janë ndërprerë punimet edhe pse janë të përfshirë në kodin buxhetor. Po ashtu desha të bëjë një pyetje rreth riparimit të shkollës në Drenoc, është fituar një projekt nga Bashkimi Evropian, ku ka mbete ky projekt pse nuk është duke filluar. Pastaj në fund është bërë një riparim i pjesë së rrugës tek ura, por për shkak të vërshimeve të fundit që kanë qenë, përsëri kjo rrugë është dëmtuar, desha të ngris së çështje që edhe kjo rrugë të rregullohet. I nderuari kryetar në rrugët e fshatit Drenoc mungojnë pengesat të cilat quhen polic të vdekur, siç e dini shkolla jonë është mi rrugë dhe të gjithë nxënësit duhet patjetër të kalojnë rrugën që të shkojnë në shkollë, nxënësit janë të rrezikuar nga makinat, prandaj ju kisha lutur që të merrni parasysh këtë kërkesë.

Dervish Çadraku – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje rreth një raporti që është dashur të jetë sot në kuvend, pra raporti mbi gjendjen e dëmeve pas të reshurave që kanë ndodhur në komunën tonë. Pastaj pyetje e dytë është: Si qëndron puna e mirëmbajtjes së parqeve si të qytetit ashtu edhe në vende tjera kudo që gjenden ato.

Shqipe Kryeziu – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, pyetje ime i drejtohet kryetarit të komunës, i nderuari pse është duke heshtur projekti i shkollës së muzikës, e cila shkollë ka një numër të madh të nxënësve, u bënë 7 vite që këta nxënës janë pa objekt.

Ali Zhuniqi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, sa i përket dëmeve të shkaktuara nga reshjet e fundit që ju janë bërë ekonomive familjare, e kërkoj një raport edhe z. Çadraku, pyetje ime i drejtohet kryetari të komunës: I nderuari kryetar kolegu juaj, kryetari i Suharekës dëmet e vitit të kaluar ju janë kompensuar me aq sa ka pasur mundësi. Drejtorët që janë përgjegjës për këtë punë, e kam parë që edhe tani por edhe në vitin e kaluar kanë dalë në teren që të marrin të dhënat sa i përket dëmeve të shkaktuara, nuk e di se në cilën bazë dalin që të bëjnë vlerësimin e ekonomive familjare, kur ne e dimë që dëmet nga viti i kaluar në amvisëri nuk janë paguar, kurse tani jeni duke bërë përsëri llogaritje të dëmeve.

Munib Durguti – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, desha të ju paraqes një shqetësim tek rruga e gjimnazit “Xhelal Hajde – Toni”, pas reshjeve të shiut që kanë rënë në kohën e fundit në komunën tonë, ju kujtoj se me rrethimin e oborrit të gjimnazit është krijuar një gjendje shumë e rëndë për banorët e kësaj lagje. Këtë problem e kam diskutuar edhe me drejtorin z. Përparim Krasniqi, në kohën kur është bërë rrethimi i oborrit të shkollës, ju kam bërë me dije se ajo pjesë është niveli më i ulët i lagjes, dhe në këtë pjesë akumulohet të gjitha ujërat që vinë nga rrugët e epërta siq është rruga “Gëzim Hamza – Piktori”, pastaj “Martirët Abazibra” e kështu me radhë. Në të kohë kam kërkuar që përfund murit të lejohet një Baj – Pas, ku ujërat ku ujërat që vinë nga rrugët e tjera të derdhen në oborrin e gjimnazit dhe në këtë formë të shkojnë në rrjedhën normale tek lumi Dullo. Kjo nuk është bërë edhe përkundër sugjerimit të inxhinierëve komunal z. Topalli dhe z. Kadiri të cilët kanë qenë në teren, po ashtu edhe ata e kanë konstatuar se kjo duhet të bëhet në formën që e përmenda më parë, pra si pasojë e mos bërjes së kësaj e tërë lagja është vërshuar nga vërshimet që kanë ndodhur ditët të fundit. Më të rrezikuar janë familja Shala sepse në secilën reshje që e

kemi pasur kohën e fundit uji i ka hyrë në oborre dhe podrumet e shtëpive, kërkoj që të bëhet ndërhyrja e nevojshme dhe të funksionoj ashtu si duhet, e di që ne nuk mundemi me e ndalë shiun, por si qeverisje komunale na takon që ti ndalim shkaqet që mos me i rreziku banorët. Pastaj po ashtu edhe ky shqetësim që do e paraqes tani ndërlidhet me të parin, të nderuar pas këtyre reshjeve lumi Dullo nuk ekziston në disa segmente, e sidomos mbrapa kafiterisë Konaku, e kisha ftuar kryetarin që të del në teren së bashku me drejtorin dhe inxhinierët komunal dhe të bëjnë një zgjidhje emergjente. Ky lumë duhet të pastrohet, unë e shohë që si pasojë e mbushjes së këtij shtrati kanë pasuar shumë banorë nga këto reshje, siç janë familja Canziba dhe disa shtëpi që janë afër tyre. Nëse ka mundësi do të ndërlidhesha me kërkesën që e bërë kolegja znj. Mirjeta Krasniqi sa i përket ndërtimeve të reja të ndërtesave që gjenden afër komunës të cilat ende nuk kanë pranimit teknik. Para disa muajve e kam ngritë edhe unë këtë çështje në kuvend ku kam biseduar me Drejtorin, ku kemi kërkuar që të iniciohet procedura e pranimit teknik, në mënyrë që banorët e këtyre banesave ta fitojnë të drejtën pronësore. Në aspektin tjetër po ashtu edhe komuna ka një humbje të madhe sepse nuk i taton këto banesa që 20 vite, e di që nuk është e lehtë kjo por besoj se secili problem e ka zgjidhjen aty ku është vullneti, kishte me qenë mirë që me vullnetin e kryetarit të komunikojmë me zyrat ndërlidhëse dhe të gjejmë një formë që këta banorë ta fitojnë pronësinë ashtu siç i premtim ligji.

Fehmi Cena – Çështja të cilën desha të diskutoj në fakt u diskutuat nga parafolësi, por unë do të japë kontributin tim, sa i përket çështjes së vërshimeve kohëve të fundit, me një theks të veçantë në qytetin e Rahovecit. Sa herë bie shi qytetin po vërshohet nga ujërat, dhe po krijohen dëme nëpër shtëpitë e qytetarëve, përveç dëmeve çdo vërshime ngre në vete edhe rrezikun e shpërthimit të ndonjë epidemie, e aq më tepër që ne tani jemi në muajt e verës, gjatë vërshimeve ujërat e kanalizimeve dalin jashtë, përzihen me ujërat e pijes etj. Mendoj se duhet të gjendet një zgjidhje në theks të veçantë për qytetin e Rahovecit, ne e dimë se Rahoveci e ka reliefin karakteristik dhe ujërat mbledhen shumë lehtë poshtë në qytet, por mendoj se zgjidhja duhet të gjendet dhe për këtë përgjegjëse është komuna. I nderuari kryetar duhet të investohet më tepër në ndërtimin e kanalizimeve për ujërat atmosferik, nëse mbetet kështu besoj se edhe në të ardhmen do të ketë vërshime jo në mënyrë lokale por në mënyrë të përgjithshme. Sa më kujtohet mua investimet janë bërë shumë më herët në kohën kur kanë qenë në pushtet LDK-ja, ku është bërë rrjeti i kanalizimit për ujërat atmosferik rreth 1.5 km, prej asaj kohe nuk e di nëse është bërë diçka në këtë drejtim. U cekë po ashtu edhe kanali i lumit Dullo, ky kanal duhet të pastrohet së paku një herë në vit, por nëse ka nevojë edhe dy herë në vite, sepse me të vërtetë ky kanal është mbushur me zhavorr dhe mbeturina të ndryshme, për këtë arsye nuk ka kapacitet të e yerë sasinë e ujit kur bie shi. Propozoj që drejtoria përkatëse të na përgatit për mbledhje të ardhshme një raport në lidhje me këto vërshime, në mënyrë që ti shohim shkaqet e vërshimeve dhe ne si komunë pastaj ne si komunë dhe si asamble të ndërhyrë, dhe të gjenden metoda që në të ardhmen të zgjidhet ky problem.

Masar Popaj – Përshëndetje për ët gjithë të pranishmit, pyetje ime i drejtohet Drejtorisë për Punë Inspektuese, inspektorati i higjienës sanitare kanë vizita të shpeshta në teren, ku i bëjnë vizitat lokaleve të ndryshme dhe e bëjnë një punë të shkëlqyer. Pyetja ime është: I nderuar a e ka inspektuar inspektorati ndonjëherë objektin e vjetër të komunës, pasi që në këtë objekt higjienë vërehet që nuk është në nivel, si në tualete, shkallë, korridore e mos të themi edhe nëpër zyre. Po ashtu e pyes drejtorin se punëtorët shëndetësor si mjekë, infermier etj, a janë të pajisur me librezë sanitare, pas vizitës së bërë në QMF në fshatin Fortesë, stomatologjia e kësaj ambulante më tha se i mungon një helioaparat për pastrimin e dhëmbëve me emrin kavitrin, po ashtu edhe karrika është jo funksionale.

Rexhep Oruçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar do e potencoj edhe një herë çështjen e pensionistëve të moshës së tretë, pasi që si duket pas 6 viteve, këtë vite për herë më parë do të mbesim pa u subvencionuar nga komuna. Këtë vite për shkaqe procedurale do të mbesim, kam biseduar me kryetarin e komunës, ku më njoftoi se komuna ka bërë një shpallje publike për organizatat jo qeveritare ku ne duhet të aplikojmë, atë shpallje nuk kam mundur me e pa dhe si duket kam aplikuar me vonesë. Po ne asnjë përgjigje nuk e kemi pranuar nga komuna që së paku të na informojnë që shkresa jonë është refuzuar, pastaj ju kam drejtuar kryetari të komunës në emrin personal, është mirë që të kryhet kjo punë sepse i kemi rreth 3000

anëtar të pensionuar, dhe mos na krahasoni me shoqatën e sindikatave të pensionistëve shoqatën e Fadil Durguti që i ka anëtar 50 arsimtar të pensionuar. Ata po ashtu e kanë bërë një shoqatë pensionale e cila është po ashtu kundra ligjit, ata e kanë bërë vetëm që ti marrin ato 3 paga e fundit që duhet komuna të i paguaj, këtë çështje e kam ngritur edhe para dy muajve me nënkryetarin, por ai më thotë se ju keni dualizëm, nënkryetar ju jeni juristë i thash sikurse që është z. Qazim Qeska dhe unë. Të nderuar nuk ka kurrfarë dualizmi, nuk e di interesat e kujt i mbron ajo sindikatë. Vitin e kaluar ata morën subvencione nga komuna njëjtë sikurse ne, edhe pse ata janë 50 anëtar, kurse ne jemi 3000 anëtar. Këtë vite si duket nuk do ti kmeri as këto mjete, por po ju them se ligji për asocimin e organizatave jo qeveritare është decidivë dhe ky ligj në nenin 1 thotë: Se ky ligj nuk vlen për parti politike, nuk vlen për sindikata dhe organizata sindikale etj. pra kjo është kundra ligjore kurse ne jemi duke e subvencionuar, po ashtu edhe zyrtar ja kemi dhënë, vitin a kaluar me ato mjete që i kanë mare nga komuna, 3 veta kanë shkuar në pushime. Të nderuar ne jemi shoqatë e regjistruar në MAPL etj. Të nderuar ka komuna që mjetet për shoqatën e pensionistëve i kanë të darë edhe në kodin buxhetor, ne nuk jemi duke kërkuar atë, por ju lutem mos na lini në haresë, sepse ne në vit ka raste që japim deri në 30 raste ndihma momentale me shumën deri në 50.00 €, ka pensionistë që nuk kanë as barna esenciale me i ble. Prandaj po ju them mos u rrudhni kur bëhet fjalë për njerëzit e moshës së tretë sepse dashtë zoti do ta keni shëndetin edhe ju kryetar dhe të mbërrini këtë moshë.

Kryetari – Ju faleminderit ë gjithëve për pyetjet e parashtruara, të nderuar me të drejtë plotës shqetësime janë me vend dhe janë legjitime, do mundohem të ju japë disa sqarime që bien në përgjegjësin e kryetarit të komunës, kurse një pjesë të përgjigjeve do ju japin drejtorët e drejtorive përkatëse. Po ja filloj nga pyetje e fundit, i nderuar z. Rexhep Oruçi, sipas ligjit ne subvencionet duhet që ti japim në bazë të thirrjes publike për aplikim, ne e kemi pas një thirrje por siç e tha edhe i nderuari z. Oruçi ndoshta ka pasur mungesë të informatave, ose ka bërë aplikim me vonesë. Të gjitha organizatat që kanë aplikuar për subvencione i kemi trajtuar, më vije shumë keq që nuk është përfshirë shoqata e pensionistëve të Rahovecit në këtë thirrje, por kjo ka ndodhur sepse nuk ka pasur aplikacion, por ne nuk e kemi harruar këtë shoqatë sepse jam i interesuar që ti mbështesë këtë shoqatë, do të shohim se cila do të jetë mundësia e jonë si komunë që ti dalim në ndihmë shoqatës së pensionistëve sa më parë që është e mundur. I nderuari z. Fehmi Cena, z. Ali Zhuniqi, z. Munib Durguti dhe disa të tjerë kanë bërë pyetje sa i përket çështjeve të vërshimeve, të nderuar kohëve të fundit ka pasur vërshime të shumta, posaçërisht në qytetin e Rahovecit, Fortesë, Pataqan të ulët, Drenoc, Hoçë të Vogël dhe Brestoc, por kryesisht dëmet kanë dominuar në qytetin e Rahovecit. Ajo që kemi bërë ne si komunë është se të gjitha ekipet dhe njësitë tona maksimalisht, ku janë përpjekur që të bëjnë aq sa kanë pasur mundësi të bëjnë në situata të tilla. Por çfarë kemi bërë pastaj, ne si komunë kemi formuar komision për vlerësim të dëmeve, si në amvisëri, në ekonomi familjare dhe në bujqësi. Para meje e kam një raport të dëmeve në amvisëri dhe totali i dëmeve është 98,244.00 €, kjo është sipas komisionit profesional që është themeluar me vendim të kryetari të komunës. Ne ende nuk e kemi raportin e dëmeve në bujqësi, arsyeja është se ne nuk mundemi të angazhojmë vlerësimin e dëmeve në bujqësi njerëz jashtë administratës komunale për momentin, siç e dini tani për tani drejtoria e bujqësisë ballafaqohet me pritjen dhe absorbimin e të gjitha kërkesave dhe nevojave që kanë fermerët në aplikim për grande të cilët vinë nga Ministria e Bujqësisë. Pastaj për subvencione dhe thirrje direkt që është një tjetër subvencion nga ministria e bujqësisë edhe pse këtë vite janë vonuar pak, pastaj drejtoria e bujqësisë është e mobilizuar që ti shqyrtoj edhe situatat që janë bërë dëmet e vitit të kaluar. Komisioni për vlerësimin e dëmeve ka dalë në teren por ende nuk e ka sjellë raportin sepse duhet edhe disa ditë angazhim, nëse ka nevojë edhe ditëve të shtunë në mënyrë që ta kemi raportin nga dëmet në bujqësi. U përmend nga z. Zhuniqi Suhareke, i nderuar Suhareka vitin e kaluar është vlerësuar në infrastrukturë publike dhe amvisëri në vlerën prej 1,100,000.00 €, por atyre nuk ju është kompensuar dëmi në bujqësi i cili nuk është 5,700,000.00 € sikurse tek ne, por është përafërsisht 2 milion. Ne i kemi marr shpërblimin 1 milion vetëm në bujqësi, por jo edhe për dëme në amvisëri. E di që situata nuk është e mirë me ujërat në qytet, nuk është çështje me e akuzu dike sepse secili në mënyrën e vetë është munduar me bë një zgjidhje këto 20 vite, mos harroni se këtu ka ndërtime të egra, ka ndërtime të reja, ka ndërtime nëpër territore të lumenjve, pastaj ka prona private përkaj lumit Dullo.

Pozita gjeografike e qytetit të Rahovecit është e tillë që prurjet e ujit vinë nga të gjitha pjesët dhe derdhen tek rruga kryesore “Xhelal Hajda – Toni”. Pastaj ju e dini se gypin kryesore të qytetit e ka për detyrë që të bëjë pastrimi KRU- Gjakova, vitin e kaluar i kanë bërë disa pastrime të pusetave. Për fund të nderuar e dimë që kemi problem me lumin rimnik, e dimë që kemi problem ka bërnjakë deri tek pika që është me e ulët, e dimë që kemi probleme tek muri te shkolla e mesme Xhelal Hajda – Toni, e dimë që shtrati i lumit Dullo është duke u mbushur çdo ditë me mbeturina, po ashtu e dimë që shumë qytetar ndoshta edhe nga mungesa e informatave i kanë përzier ujërat e zeza me ujërat e bardha. Ne kemi filluar të marrim masa, i kam ftuar në një takim të gjithë inxhinierët dhe arkitektët e Komunës së Rahovecit, jemi duke e bërë incizimin e gjendjes së pikave dhe pastaj ata do të na tregojnë se cila do të jetë detyrat projektuese në mënyrë që kompania ta hartojë projektin, dhe kjo është për ne një prioritet i lartë, për arsye se ne nuk jemi të gatshëm që për 10 minuta shi të na shkoj i gjithë munda dëm. Ne idetë i kemi mare dhe detyra projektuese pothuajse është qartësuar se çfarë projekti do të duhej të bënte kompania që ne kemi kontratë, por unë shumë shpejtë do të kërkoj edhe ndihmën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Planifikimit Hapësinor që ta mbështesë realizimin e një projekti maksimalisht do ta zgjidhë problemin e ujërave atmosferik në qytetin e Rahovecit. Pastaj kompensim të dëmeve nga komuna vështirës që mundet të ketë edhe pse janë diku rreth 99,000.00 €, por ne si komunë as 20,000.00 € nuk po kemi mundësi me i kompensu dëmet, ne do të kërkojmë ndihmë nga qeveria qendrore. Ne së bashku me dy apo tre komuna i kemi kërkuar kryeministrit që me shumën prej 400 – 500 mijë euro të i ndajë dhe të na ndihmojë pasa vërsimeve të ditëve të fundit. I nderuari z. Munib Durguti do të bisedoj me drejtorin z. Perparim Krasniqi ku do të shoh se si është situata e atij muri që ju e ceket, por i nderuar duhet të dini se disa kontrata ne i kemi trashëguar, nuk është që nuk mundemi të ndryshojmë diçka, por do të shikojmë pse është ajo situata ashtu, do të njoftohem pak më mirë. E nderuar znj. Afërdita Thaqi, problemet që janë duke u shkaktuar shkaktuar brigjeve të lumit Drini Bardh, ku ditëve të fundit e patëm një rast tepër të rëndë në Kramovik. Ne jemi të gjithë të informuar se çfarë degradimi i shkajshëm dhe i egër është duke ju bërë lumit Drini i Bardh që nga Klina e deri tek Vërmica, ne e dimë që operatorët nuk e kanë ekspluatue rërën dhe zhavorrin sipas kritereve, ne dimë po ashtu se inspektorati nuk e ka kryer punën ashtu si duhet, të gjithë jemi dakord se vërejtjet janë serioze dhe me vend. Ne e kemi dërguar një projekt në IBG në Londër, pra kemi konkurrar në samitin e Londrës me projektin e shtratit lumi Drini, vlera e projektit është gati 100,000,000.00 €, ku do të përfshihet deri në fshatin Gjonaj. Ne nuk kemi ende ndonjë përgjigje direkte, pra jemi në pritje sepse ky projekt është një projekt shumë i madh, presim që një e ardhme e afërt mos do të na sjellë diçka pozitive. E nderuara znj. Mirjeta Krasniqi sa i përket çështjes së bartjes së pronave, edhe objekti që ne jemi për momentin nuk ka pranim teknik, e di që është shumë keq që po e them, por realiteti është se ne jemi duke qëndruar në një objekt që nuk ka pranim teknik. Fatkeqësisht edhe ky objekt si objekt i ri nuk është i pranuar nga komisioni i pranimit teknik, po ashtu edhe për ato ndërtesa e di që janë disa probleme të cilat besoj se z. Qeska i dinë edhe si avokatë, por edhe si ish kryetar komune. Jam dakord që ne duhet ndoshta të bëjmë një përpjekje, ndoshta edhe si kuvend që të krijojmë një farë baze më të shëndosh, në mënyrë që institucionet e tjera të kenë pastaj më shumë respekt për vendimet e kuvendi të komunës. Nuk dua të hy në detale por problem është edhe objekti që jemi ne edhe ato ndërtesa, po ashtu i kuptoj edhe ato shqetësimet e banorëve të kësaj ndërtese, më kujtohen këto shqetësime më kanë ardhur edhe në mandatin e parë që kam qenë kryetar komune. Sa i përket parkingut, operatori ka marr autorizim që të bëjë pastrimin e oborrit të ish shkollës së mesme, besoj se do të jetë i gatshëm së paku në muajin e mërgimtarëve dhe do të jetë funksional. Po ashtu për muajin e mërgimtarëve ne në oborrin e komunës do ti lëmë disa vend parkime të rezervuara, e dimë që nuk janë të mjaftueshme, por besoj se parkingu që e ceka më parë do të mjaftojë. E nderuara znj. Shqipe Kryeziu sa i përket objektit të shkollës së muzikës, z. Naser Dula është shumë entuziastë, ka kërkuara që të ndërtohet shkolla në vendin e ish shkollës së mesme. E nderuar është shumë problem të ndërtohet shkolla e muzikës në këtë vend, për arsye se ne shumë e vlerësojmë rendësin e një objekti shumë të përshtatshëm me kushte të mira për shkollën e muzikës, por ky vend mundet të jetë me prioritet tjetër, kurse për momentin nuk kemi vend të përshtatshëm për ndërtimin e objektit të shkollës së muzikës. Tash shtrohet pyetje kur do ta bëjmë shkollën e muzikës dhe ku,

këtë pyetje edhe ne jemi duke je bërë shumë shpesh vetës, të nderuar edhe ne jemi shumë të interesuar që të kemi një objekt të shkollës së muzikës. Por siç e thash nuk kemi vend dhe nuk kemi parë sepse ndërtimi i një objekti të shkollës së muzikës është i kushtueshëm, nuk është sikurse ndërtimi shkollës në fshatin Kaznik. Sa i përket ujit të pijes në fshatin Pastasel, e nderuara znj. Mirjeta Krasniqi, sipas një orientimi që na kanë dhënë ekspertët e KRU-Gjakovës, gypi i ujit i cili ka ardhur nga Guri i Kuq është në rregull, por ai ujë mbledhësi ose ai rezervari që është atje nuk ka kapacitet të mjaftueshëm që ta furnizoj me ujë standard qytetarin e Pastaselit sepse është rezervari është i vogël. KRU – Gjakova na kanë sjellë një opsion tjetër i cili goxha shtrenjtë kushton, por sipas tyre këto gypa nuk janë më funksional. A është prioritet uji i pijes për fshatin Pastasel? gjithsesi se është, unë personalisht i kam biseduar me KRU – Gjakovën, dhe i kam thënë a e keni analizuar mirë kur e keni bërë atë investim, pse e keni ndërtuar nëse është dashur të bëhen zgjidhje tjera, por sidoqoftë ne besoj se do të japim një zgjidhje këtij problemi. I nderuari z. Vahid Krasniqi ne kemi kontrata me operator për rregullimin e kanalizimeve dhe rrugëve si në Drenoc, Senoc dhe plotë fshatra tjerë, po ashtu jemi të vetëdijshme dhe besoj se edhe ju jeni të informuar që ne nuk i kemi të gjitha mjetet, ne nga pak po kemi disa probleme me operator. Disa operator thotë në rregull unë do e kryej punën kurse mjetet kur të i ketë komuna do mi paguaj, por ka operator që nuk punon pa ja lëshuar mjetet dhe atë sa ne ja lëshojmë mjetet atë edhe ata e kryejnë punën. Por për gjithçka që është e paraparë me kontratë do të kryhet, për atë të sigurojë, ndërprerja ndodhë nga një herë sepse nuk ka mirëkuptim në kuptimin që të kryhen punët më shumë se sa ka mjete, ky është problemi, sepse nuk është jashtë vëmendjes as Drenoci dhe as Senoci si për kanalizim dhe rrugë ashtu edhe për pengesat në rrugë ose policë të vdekur. I nderuari z. Fehmi Hoxha, sa i përket lojërave të fatit ato janë mbyllur jo me vendim të qeverisë, por fillimisht me rezolutë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ligji i vjetër është shfuqizuar, kurs në fuqi është ligji i ri i cili i suspendon aktivitetet e lojërave të fatit për një periudhë të caktuar. Sa i përket plotësim ndryshimit të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, i nderuar është duke u hartuar një rregullore e cila do të jetë model për gjithë Kosovën për të gjitha taksat që kanë të bëjnë me të gjitha kategoritë e bizneseve. Ju e dini se kuvendi ka liruar bizneset prodhuese dhe disa biznese tjera, por disa biznese tjerë që janë tregtare janë ngarkuar me rregulloren e cila është ende në fuqi. Besoj se vjeshta do të na gjejë në një pozitë pak më të qartë sepse do të dimë ndoshta se si do të komunikojmë me kuvendin e komunës, ose se si do të veprohet qoftë me plotësim ndryshim të rregullores ekzistuese, çoftë me një rregullore që do të jetë standard për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Lënda për efikasitetin e energjisë në katër shkolla e komunës së Rahovecit ku në këtë rast pyetje ishte për shkollën në Drenoc, i nderuar ka ndodhur një marifet atje në agjension dhe ai marifet se po shprehem pak popullorçe, na ka detyruar që ti drejtohem me një shkresë ministrit, kryeshefit të agjensionit dhe zyrtarit përgjegjës. Të nderuar siç duke ka një tendencë me lojë me fonde dhe ata kushtimisht po e them një projekt Kamenicës ose Podujevës se Rahoveci pret. I nderuar lënda është në agjensionin anti - korrupsion dhe besoj se dikush ka me u përgjigje për këtë vonesë. Mirëmbajtja e ambienteve ose mjediseve të gjelbëruara si praqeve, rrugicave në përgjithësi hapësirave publike, mendoj se ka një përmirësim nëse e bëjmë një krahasim me të kaluarën, por megjithatë vazhdoj të je i pakënaqur për arsye se ka mundësi të bëhet më mirë. Ka mundësi që të mirëmbahen edhe mjediset e gjelbëruara, varrezat civile edhe varrezat e martirëve, varrezat e dëshmorëve si dhe komplekset e dëshmorëve. Ne mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara e kemi ndarë në loto, pra nuk kemi dashur të ja japim një kompanie në kuptimin më pozitiv të fjalës, ka mundësi që një lot të ketë fituar ndonjë kompani që nuk mërzhitet fort, kurse ka ndonjë kompani që është më efikase. Ne do ti qesim edhe disa ambiente që nuk kanë qenë të përfshirë në mirëmbajtje, ato nuk kanë qenë të përfshirë në mirëmbajtje sepse kontrata nuk i ka përfshirë, përveç që do të futen në listë këto, ne ndoshta do të bëjmë edhe lotin e katërt, ku ka mundësi që ti ndajmë me zona. Institucionet që unë sot i drejto jam i interesuar që ti kushtojë shumë më shumë vëmendje, dhe patjetër duhet të i fusim në mirëmbajtje të gjitha rrugët dhe rrugicat publike, po ashtu edhe hapësirat e gjelbëruara që i ka komuna jonë. I nderuar Masar Popaj objekti i vjetër i komunës në mandatin tim të parë është bërë restaurimi dhe renovimi, por është e vërtetë se ai objekt nuk ka mirëmbajtje të mjaftueshme, prandaj është mirë që ne të marrim masa kundër vetvetes ndonjëherë sepse ndonjëherë edhe vetë jemi të pakujdesshëm.

Kur kam ardhur herën e parë në komunë si kryetar e kam gjetur derën e arkivit të hapur, gjithmonë ashtu rinte e hapur, çdo qytetar ka mundur të hy dhe të i merë dokumentet e komunës, kjo nuk guxon të ndodhë askund dhe asnjëherë. I bëjë thirrje Drejtorit të inspektoratit që të kujdeset për mirëmbajtje të ambientet në objektin e vjetër, dhe nëse është e nevojshme le ti ndëshkoj punëtorët ose le ta mbyllë, sepse nuk kemi dëshirë ne të na sëmuret ndonjë punonjës ose ndonjë qytetar që vjen për të kryer punë.

Vjosa Isma – Përrshëndetje për të gjithë të pranishmit, kamë një pyetje rreth një konkursi që është shpallur në QPS, konkursin e keni shpallur për drejtime ekonomi, juridike dhe psikologji, kurse nuk e keni futur si kriter edhe drejtimin përkatës për punë sociale, edhe pse ka kandidat që e kanë të kryer këtë drejtim. Pse është shpallur konkursi në kundërshtim me udhëzimin administrativ, nëse kandidatët që janë përkatës për këtë drejtim nuk kanë mundësi të pranohen këtu atëherë ku do të pranohen.

Kryetari – E nderuar shërbimi i personelit të komunës së Rahovecit e ka një katalog që bazohet për hapje të konkurseve, dhe ekskluziviteti i kësaj çështje dhe çështjeve si kjo i takon vetëm shërbimit të personelit.

Vjosa Isma – I nderuari kryetar kandidatja kur ka shkuar në zyrën e personelit në komunë me e pyet pse nuk e ka futë si kriter në konkurs edhe drejtimin për punë sociale, përgjigja e zyrtarit të personelit ka qenë se nuk e kemi ditur që ka kandidatë të diplomuar me drejtimin për punë sociale. E juaja nuk është që të dini a ka kandidat, e juaja është që ta shpallni konkursin ashtu siç e përcakton udhëzimi administrativ, a ka kandidat apo jo atëherë ajo do të shihet në aplikim.

Kryetari – Edhe një herë e nderuar siç e thash ne e kemi një zyre të personelit, një zyre ligjore, ata do ju japin informata deri në detaje, kompetencat janë të ndara, ne ju kuptojmë shqetësimi ndoshta është me vend, por unë nuk e di se si shkon këto punë dhe as që merrem me këtë punë sepse nuk është detyrë e imja.

Afërdita Thaqi – Më vije shumë mirë që paska filluar kryetari të merret seriozisht me projektin për lumin Drini i Bardh, i nderuar a ka mundësi që së paku një rrugë të hapni deri tek Drini deri sa të filloj ai projekt, sepse nuk ka dalje andej.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendar ju faleminderit për pyetjet e parashtruara, po ashtu falënderoj kryetarin e komunës, për përgjigjet e dhëna. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Informatë e Raportit Financiar vjetor të Komunës së Rahovecit për vitin 2018 e Auditorit Kombëtar.

Afrim Limani – Drejtori Limani përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, ku ja prezantoi informatën e auditorit të përgjithshëm në pika të shkurta anëtarëve të kuvendit, ku ceku se pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2018 janë kualifikuar si pozitive. Dhe me këtë drejtori Limani tha se komuna e Rahovecit ka krijuar mundësinë që të thithë grande si nga qeveria e Republikës së Kosovës ashtu edhe nga ndonjë donator i jashtëm, po ashtu kjo është një imazh i mirë për komunën e Rahovecit. Po ashtu drejtori limani tha se plotësisht pajtohet me rekomandimet e auditorit të jashtëm që i ka dhënë për vitin 2018, ku shpreson se shumica e rekomandimeve do të përmirësohen.

Masar Popaj – Kam dy pyetje për drejtorin z. Limani, pyetje e parë është: I nderuar është viti i dytë me radhë që auditori gjen keq klasifikime, dhe ky keq klasifikim është duke ndikuar negativisht edhe në opinion, a keni mare veprime të duhura që këto keq klasifikimet të mos përsëriten. Pastaj pyetja e dytë i nderuari drejtor, sa kamë vënë re në këtë raport auditori i ka dhënë 21 rekomandime, ajo që mua më intereson është a keni mare veprimet e duhura për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Fahrije Lushi Morina – Përrshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne në mbledhje të KPF-së i kemi diskutuar shumë çështje, prandaj sot do i përsëris vetëm disa nga ato. Tek paga dhe mëditje thuhet se ka mangësi në menaxhimin e personelit, këtu bëhet fjalë për 19 zyrtarë të angazhuar nga Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri, pra komuna nuk ka qenë në gjendje të ofroj dosje të kompletuar për këta punonjës civil. Kjo e gjetur e auditorit konsiderohet si jo e rregullt sepse është bërë në kundërshtim me ligjin për të nëpunësit civil, po ashtu këta punonjës janë të angazhuar nga kjo ministri, kurse pagat dhe kompensimet i marrin nga komuna. Pastaj tek çështja C2 tek dosjet e pa azhurnuara të personelit, kjo lidhet drejtpërsëdrejti me drejtorin e arsimit, ku thuhet se nga të gjeturat e auditorit tek dosjet e pa azhurnuara të personelit, janë analizuar 21 mostra, ku 9 prej tyre janë gjetur në DKA, kurse 2 në DSHPS, këtu mungon dëshmia e përvojës

së punës dhe nuk kishte ndonjë pasqyrë të një vendimi të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar. Pastaj tek çështja A4 ceket parregullsi bë angazhimin e stafit për shërbime të veçanta, e kam përmendur edhe në mbledhje të KPF-së, janë 9 punonjës të cilët që nga fillimi kanë marrë kontratë me bazë jo ligjore, sepse thuhet se duhet të jetë një afat kohorë që komuna duhet të i angazhojë këta nëpunës për shërbime të veçanta në një afat më të shkurtër se 6 muaj, kurse komuna ka angazhuar këta persona në një afat prej 120 ditësh, dhe është dashur të keni parasysh se kjo është në kundërshtim me ligjin. Tek çështja A5 mangësi në procesin e pagesave sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit, në të dy raste pagesat për shërbimet kontraktuese në vlerën prej 20,000.00 €, ku thuhet se komuna ka bërë pagesë për të cilët nuk ka ofruar dëshmi se janë kryer nga komuna.

Fehmi Cena – Të nderuar është një raporte gjithëpërfshirës, duke marr parasysh që është bërë nga ZKA-ja, për ne është një raport shumë i besueshëm, pasi që ata janë më neutral dhe më profesional. Sipas meje ky raport i ka përfshi tre hallkat kryesore, pasqyrat financiare vjetore, menaxhimi financiar dhe i kontrollit dhe zbatimi i rekomandimeve. Në fakte ZKA-ja raportin e ka kualifikuar me opinion të pa modifikuar me theksim të çështjes, por kur ne e lexojmë përmbajtjen, e shohim se në esencë janë duke dalë shumë të gjetura të parregullta, ku rezultojnë në fund me mbi 20 rekomandime, disa nga ta janë duke u përsëritur vit pas viti. Tek theksimi i çështjes e përmendi edhe drejtori dhe e dha arsyetimin se është bërë një mos harmonizim i vlerës p.sh. ceket tek tatimi në pronë 53,515.00 €, që nuk përputhet me saldo përfundimtare me atë fillestare, pastaj është vlera prej 133,918.00 € nga obligimet e papaguara nga viti i 2017 që nuk janë përfshi si obligime të pa paguara dhe janë paguar nga buxheti i vitit 2018, këto ose janë bërë lëshime të pa qëllimshme ose të qëllimshme, do të presim një përgjigje nga drejtori për këtë. Pastaj shpenzimet prej 138,982.00 €, janë si keq klasifikim, u një pjesë e tyre kanë bërë kalim nga një kod në kodin tjetër, sikurse që është rasti me shumën prej mbi 113,000.00 € që janë mare nga investimet kapitale dhe janë shfrytëzuar për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime. Pastaj ceket një shumë prej 24,526.00 €, që janë marr nga mallrat dhe shërbimet dhe janë shpenzuar për paga dhe mëditje si dhe për subvencione, kjo është diçka që nuk është dashur të ndodhte, sepse ne kur e aprovojmë buxhetin komunal nuk duhet të ndryshohen më pastaj kodet. Çështja tjetër është gjithashtu edhe obligimet që komuna i ka paguar diku në vlerën prej mbi 105,000.00 €, përmes vendimeve gjyqësore, pse këto vendime të paguhen përmes vendimeve gjyqësore, kur janë mekanizmat komunal që duhet të i paguajnë. Tek detyrimet kontingjente ceket se ka pasur rritje të vazhdueshme, ku shuma e përgjithshme ka arritur dikur rreth 32 milion euro, kurse për vitin 2018 është rritur edhe për 690,000.00 €, po ashtu kjo ka tendencë që vazhdimisht të rritet, kërkoj një sqarim për këtë nga drejtori, dhe të në tregoj se pse ka rritje të vazhdueshme. Tek menaxhimi financiar dhe kontrolli, planifikimi dhe realizimi i buxhetit, gjithashtu shihet se shpenzimet fondeve që i ka pasur komuna në dispozicion, në raport me burimet e fondeve që është dashur të i shfrytëzoj nuk është e kënaqshme. Përmenden shifrat për vitin 2018, ku thuhet se komuna ka shpenzuar 91.5% të fondeve që i ka pasur në dispozicion, pastaj në tabelën që e kemi të cekur shpenzimet fondeve sipas kategorive ekonomike, na dele se niveli i realizimit 91.5% më tepër është e kapshme për paga ku janë shfrytëzuar 99%, pastaj shërbimet komunale 99%, kurse ajo që ne e vlerësojmë më tepër që do të duhej e shpenzuar p.sh mallrat dhe shërbime janë shpenzuar vetëm 62%, kurse për investime kapitale vetëm 55%. Kemi një pasqyrë financiare dhe shpenzimet buxhetore janë jo të kënaqshme, kurse ne e dimë se këto dy momente si pasqyrat financiare dhe shpenzimet buxhetore janë dy indikator shumë të rëndësishëm pas të cilëve bohet edhe vlerësimi i performacës së komunës, madje edhe për thithjen e donacioneve qofshin ato vendore ose të jashtme. Për fund tek realizimi i këtyre rekomandimeve po del se për vitin 2018 nga 7 rekomandime nuk janë zbatuar mbeten me që të zbatohen, kurse gjithsej për vitin 2019 janë gjithsej 21 rekomandime, dhe në mesin e tyre ka mjaftë që përsëriten dhe flasin për një performancë jo mjaftë të mirë të qeverisjes lokale, dhe ne do të donim që kjo të mos përsëritet. Ka edhe shumë çështje të tjera që i ka përfshi ZKA-ja në këtë raport, por besoj se edhe kuvendarët tjerë do të marrin fjalën ku do të diskutojnë sa i përket këtij raporti.

Dervish Çadraku – Me vëmendje e dëgjova drejtorin, dhe sipas ti po dele që ne jemi shumë të kënaqur dhe puna është duke ecur shumë mirë në komunë, por siç po shihet auditor i jashtëm nuk na i ka sjellë këto

parashikime që na i tha edhe drejtori. Ne e dimë që auditimi i brendshëm është një lloj përshkrimi i gjendjes faktike të një veprimtarie ekonomike në bazë të së cilës, menaxheri merë veprimet e nevojshme për stabilitet financiar. Nëse shkojmë kështu atëherë rekomandimet që i kemi nga auditori i brendshëm na dele që menaxhmenti i komunës nuk i ka përfillë aq sa duhet, sepse i kemi rreth 57 raste që i ka gjet auditimi i jashtëm, dhe nga ta 32 raste janë të zbatuara, kurse edhe 25 raste thuhet se janë në proces, por në fakte ato mes siguri nuk janë në procedurë të përmirësimit të veprimeve të paligjshme. Në bazë të këtij auditimi unë i nxjerri dy përfundime, e para: Pse menaxhmenti i komunës nuk i përfill rekomandimet e auditorit të brendshëm, ai është një mbrojtës i keq menaxhimit dhe keq përdorimit të menaxhmentit të komunës, kurse në fakt ata nuk e kanë përfillur, pastaj plotë gabime ose plotë vërejtje ka të cilat komunën po e përcjellin kohë pas kohe dhe nuk po mundet assesi që këto gabime të i përmirësoj. Në radhë të parë ne në bazë të këtij auditori kemi një performancë të dobët, sepse nga buxheti final i kemi rreth 14,284,134.00 € ku janë shpenzuar rreth 89% e këtij buxheti. Por nëse i heqim borxhet e viteve të kaluara që janë me vlerën prej 1,681,513.00 €, na dele që nga këto se vetëm 2,761,000.00 € janë përdorur këtë vit, pra në bazë të përqindjes për vitin 2018 na dele që na mbetin 55% të shpenzimit të buxhetit. Edhe më keq është kur e kemi parasysh që, prej 86 kontratave 42 janë në lëshuar në muajt e fundit të viti 2018, ku na dele që nga 7,102,009.00 €, janë lënë për fund vit, që do të thotë se janë 4,157,938.00 €. Po ashtu kemi vërejtje edhe tek mallrat dhe shërbimet, këtu sipas auditorit buxheti është realizuar rreth 62%, ju mundeni të thoni se kjo ka ndodhur sepse po keni probleme me grumbullimin e mbeturinave, por kjo tregon se kemi një menaxhim jo të mirë të buxhetit sepse 42% të tije janë realizuar në 4 muajt e fundit. Përveç këtyre vërejtjeve ne do të kemi këtu edhe legalizimin e objekteve që janë planifikuar rreth 45,000.00 €, kurse janë grumbulluar zero euro të hyra, kjo është një e metë e madhe e menaxhmentit të komunës. Pastaj kemi gabim në kalkulimin e tatimit në pronë, në disa raste këtu ka nënvlerësim, diku kemi rreth 1,057.00 €, nëse shkohet kështu atëherë qytetarët do ta humbin besimin dhe nuk kjo do të ndikojë dobët në inkasim të mjeteve. Po ashtu si në të kaluarën edhe tani janë duke vazhduar dobësitë në inkasim të qirasë, ku i kemi të pa inkasuar rreth 48,283.00 €, këto janë në 5 raste, pastaj në ushtrimin e veprimtarisë i kemi rreth 10 raste me 35,812.00 €. E theksoi znj. Fahrije Lushi se ne kemi probleme edhe tek emergjenca, kjo është një praktik që ka vazhduar edhe në të kaluarën dhe është duke vazhduar edhe tani, dhe për këtë punëtorët e drejtorisë së emergjencës duhet të definohen se a do të paguhet nga buxheti i komunës apo nga buxheti i Ministrisë së Brendshme, sepse përpos pagave që i marrin e kanë edhe një shtesë prej 30.00 € ku në total na dele rreth 7,488.00 € i merret buxhetit të komunës. Dobësi ka edhe në shëndetësi si dhe në arsim, këto dy e përcjellin disa gabime ku si pasojë e këtyre pastaj ka pasoja në buxhet në performancë, prandaj mendoj se një herë e mirë duhet të mërimi me këto punë dhe të rregullohen këto probleme një herë e mirë, në mënyrë që mos të kemi më probleme. Ne këto drejtoi kemi mungesë të dosjeve, drejtori e ka për detyrë që ti plotësojë dosjet të cilat, pastaj përmes kësaj paguhet performanca. Nëse i shikojmë investimet kapitale po ashtu edhe këtu do të shohim se ka shkelje të ligjeve, zyra e prokurimit me veprimet e saja përcjellëse gjithmonë ka pas dhe do të vazhdojmë të kemi shkelje të ligjit, ka pagesa pa raport të pranimit, pastaj ka vazhdim të punimeve, pas afatit të kontratave, pas një marrëveshje të re ato janë paguar me shumën rreth 90,000.00 €, punohet përtej para masës dhe llogarisë, pra pa aneks kontratë, pastaj lidhen kontratat pa zotim të mjeteve, ka parallogaritje të gabuara të kontratave. Këtu unë mundem të dyshoj se komisioni kur e bënë para llogaritjen, atë që e favorizon kinse nuk e ka llogaritë mirë dhe ai pastaj dele i pari me çmim dhe në listë, kurse të tjerët dalin nga kombinimi. Pastaj këtu ceket se punohet edhe pa projekt, komuna ka paguar rreth 105,933.00 € me përmbaues, dhe ndër të tjera komuna ka humbur rreth 360.000 €, pse kjo duhet të ndodhë kështu. Pastaj thuhet se vazhdon mos regjistrimi i saktë i pasurisë financiare, ku ceket se në QKMF janë rreth 3000 litra që nuk i dinë se ku janë, kjo është shkelje ligji dhe për këtë dikush duhet të ndëshkohet. Pastaj nuk mbushen formularët e udhëtimit dhe destinacionet, atëherë unë mundem të dyshoj se ata ka mundësi që të shkon dhe të kryejnë punët e veta personale, në dasma apo diku tjetër. Duke i parë disa qytetar si duke edhe komuna ka filluar të jetë e pa përgjegjshme, sepse i kemi diku rreth 57 raste të faturave të pa paguara, që do të thotë se janë diku rreth 1,716,604.00 €, me ligj jemi të obliguar që këtë shumë brenda 30 ditëve të paguajmë, nëse

nuk i paguan atëherë menjëherë fillojnë sanksionet. Të gjitha këto që i thash janë disa nga vërejtjet e auditorit të jashtëm, ku në shumicën e rasteve i ka shprehur edhe auditori i brendshëm, këtu po shihet se ka zhargitje nga ana e drejtorëve për shqyrtimin e rekomandimeve,, prandaj vazhdojnë të paraqiten vazhdimisht dobësitë. Kur komuna e ka një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit, mendoj se ai duhet të funksionoj sepse me mos zbatimin e rekomandimeve dëmtohet buxheti i komunës dhe i taksapaguesve, pastaj dobësitë vazhdojnë të përsëriten kohë pas kohe.

Ali Zhunqi – Meqenëse u ceken shumica e atyre që kam dashur të i diskutoj nga z. Dervish çardaku, por mendoj se kishte me qenë mirë që të jetë prezent kryetari i komunës kur diskutohet një raport i auditimit të jashtëm 1 vjeçar. Pyetje ime është: Pse të gjitha këto probleme të cilat janë raportuar nga ana e auditimit kombëtar ku janë vërejtur disa probleme dhe shkelje ligjore, si në vonesa në arkëtimin e pagesave pas skadimit të kontratës në projektet e caktuara, nënshkrim të kontratës pa zotim të mjeteve të mjaftueshme, menaxhim jo adekuat i autoparkut ose furnizim me karburant i veturave zyrtare nga personeli në drejtorin e administratës, DKA-së dhe QKMF-së, pra formularët nuk janë nënshkruar nga ana e zyrtarit kompetent. Pagesat sipas vendimeve gjyqësore në favor të operatorëve, ku kanë rezultuar me shpenzime shtesë për komunën në shumën prej 4,366.00 €, pra në dëme të komunës, funksionim jo efikas i NJAB-it, ku përfshihen mos dokumentimi i fakteve dhe dëshmive të nevojshme të cilat e dëmtojnë efektivitetin e punës së NJAB-it, pastaj dobësinë e kontroleve menaxheriale dhe menaxhimi i rrezikut të gjithë sistemeve financiare, flasë gjithmonë duke ju referuar raporteve të zyrës së auditimit kombëtar. Në mbledhjen e kaluar a kam bërë pyetje kryetarit dhe mendoj se kishte me qenë mirë që të jetë edhe sot këtu ku përsëri ja kisha bërë pyetjen, pse nuk na vinë raportet në baza 6 mujore nga drejtorit përkatëse. Mendoj se raportimi në baza 6 mujore të drejtorive përkatëse kishte me ritë efikasitetin e punës së drejtorive të caktuara, dhe në raport me llogaridhënien e drejtorive përkatëse sot sigurisht se do të kishim një raport më të mirë të auditimit kombëtar. I rekomandoj nënkryetarit që të ja përcjellë kryetarit të komunës që kishte me qenë mirë që drejtorët e të gjitha fushave të na sjellin neve në kuvend raporte në baza 6 mujore.

Qazim Qeska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam mare fjalën me qëllim që të kontribuojë në diskursin tim, por duke mare parasysh që shumica nga kolegët e mijë e kanë dhënë kontributin e vetë të çmuar në shqyrtimin e raportit të auditorit të brendshëm. Me bindje të plotë e them të nderuar se diskutimi imë i mëtutjeshëm nuk do të ishte më kontribut dhënës, andaj unë tërhiqem nga diskutimi imë.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, meqenëse të gjitha çështjet u përmenden nga parafolësit edhe unë nuk do të lëshohem shumë në diskutime, por kisha kërkuar nga kryetari i komunës dhe nga drejtorët e drejtorive që të merren parasysh rekomandimet e auditorit të përgjithshëm, dhe të mos përsëriten nga viti në vit. Konsideroj se janë rekomandime lehtë të arritura, me një qasje pak më serioze besoj se të gjitha do të realizohen, po ashtu besoj se në vitin e ardhëm do të dele një raport edhe më i mirë edhe pse edhe këtë vite nuk është se ka dalë keq.

Afërdita Thaqi – Unë kam një pyetje konkrete për drejtorin e financave, i nderuar a janë rritur rekomandimet apo janë ulur nga viti 2017 në vitin 2018, nëse janë rritur në vitin 2018, pyetja ime është: Pse ka dalë raporti mirë, kurse nëse në vitin 2017 ka pasur ma pak rekomandime pse ka dal keq raporti.

Rukije Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, raporti financiar ka rezultuar pozitiv nga auditori kombëtar, dua të besoj vetë këtij raporti por edhe fjalës së drejtorit, sepse është njeri kompetent dhe ekspert i kësaj fushe. Një punë e mundimshme dhe me përkushtim dhe me një menaxhim i drejtë i financave sjellë përparim progres,, por parregullsitë eventuale të vogla të cilat ishin në dukje, mendoj se me një punë dhe angazhim të shtuar ato parregullsi do të menaxhohen. Nuk pash diçka që i diskutua nga parafolësit që ceken ndonjë shkelje të rënd, kjo e tregon edhe performanca të cilën e kemi fituar, ku në nivel vendi ishim ndër komunat me një performanc më të mirë, dhe kjo tregon se rezultatet pozitive duhet të i adresohen vetë kryetarit dhe qeverisë së tij që e bëjnë një punë të mrekullueshme gjatë këtij mandati.

Isak Hoti – Të nderuar me drejtorin u dakorduar që vetëm për çështjet e kontratave për shërbime të veçanta të dalë unë të ju japë përgjigje, pastaj pjesën tjetër do të dele drejtori. Të nderuar i kemi dy kategori të punësimit, tek neni 12 pika 4 tek kontratat për shërbime të veçanta, realisht për këto 9 kontrata që flitet,

sugjerimet nga zyra ligjore kanë qenë që të ndiqet procedura sipas ligjit për shërbimin civil, këto janë kontrata që lidhen deri në 6 muaj, ke mundësi edhe më pak se 6 muaj. Të nderuar kur i kanë shtypur kontratat zyra e personelit i ka shtypur gabimisht sepse ata janë bazuar në ligjin e punës, kjo është krejt një gabim teknik. Tek ligji i punës ceken kontratat për punë dhe detyrë specifike, maksimumi është 120 ditë, që i bijnë 4 muaj e jo 6 muaj, pra gabimi ka qenë vetëm tek këto 9 kontrata, të nderuar as këto kontrata nuk janë lidhur pa konkurs, pra pa transparencë, pra ky është sqarimi imë rreth këtyre kontratave.

Afrim Limani – Ju faleminderit për pyetjet e parashtruara – të nderuar disa pyetje janë parashtruar të njëjta, prandaj gjatë përgjigjeve që do bëjë për njërin besoj se do të kuptoni që edhe ju e keni marr atë përgjigje. I nderuari z. Masar Popaj, është shumë e vërtetë që kemi keq klasifikim, por keq klasifikimi i vitit të kaluar ka qenë me një masë pak më të madhe, dhe kriteri kryesor ka qenë që pasqyrat financiare janë dalë negative. e thash në fillim se ka qenë një limit që unë nuk e kam ditë, por gjatë viti 2018 e kam mësuar që qenka ai limit, pra nëse vlera rinë diku mbi 150,000.00 €, atëherë automatikisht pasqyrat dalin me opinion të keq. Pastaj ishte një pyetje se a kemi ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e këtyre rekomandimeve, të nderuar ne e kemi mbajtur një takim në kuadër të Ministrisë së Financave, ku ka dalë një udhëzim i ri administrativ, ku thotë se duhet të formohet një komision, ku pastaj çdo tre muaj duhet të shikohet se ku kanë ecur rekomandimet, sa janë zbatuar sa nuk janë zbatuar. E nderuara znj. Fahrije Lushi, është shumë e vërtetë që dosjet e personelit i ka Ministria e Punëve të Brendshme, pagat paguhen nga buxheti i komunës, ky nuk është problem vetëm i komunës sonë, ky problem është në nivel të Kosovës. Ne kemi mbajtur disa takime dhe nga viti i ardhshëm menaxhimi i zjarrfikësve do të kalojë në kuadër të Ministrisë së Brendshme, po ashtu edhe punëtorët e pylltarisë dhe inspektorët e tregut. Është e vërtetë që kanë munguar disa dosje në kuadër të drejtorisë për arsim. I nderuari z. Fahmi Cena i bëri disa pyetje dhe disa shqetësime, i nderuar besoj se në fillim unë ju dhashë sqarime kur ju thash se janë tre çështje kryesore që i ka gjetur auditori, të gjeturën e parë e arsyetove me mos harmonizim të llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë, pastaj çështja e dytë ishte tek obligimet e borxheve apo obligimet të cilat i kemi bartë, rastësisht na ka ikur kjo shumë dhe nuk e kemi vërejtur, por auditori e ka vërejtur. Kurse sa i përket keq klasifikimit kjo ka dalë si rezultat i planifikimit të buxhetit për mallra dhe shërbime e cila ka qenë sasia e buxhetit e limituar, pastaj jemi detyruar që këtë kontratë ose këto shpenzime të i fusim në kuadër të investimeve kapitale, dhe detyrimisht ne nuk kemi mundur të i ikim kësaj. Sa i përket obligimeve gjyqësore është e vërtetë sepse ne kemi lëndë që kanë ardhur para 10 viteve për ekzekutim dhe ne nuk kemi pasur njohuri fare, por nga ana juridike operatori ka pasur të drejtë dhe e ka fituar lëndën. Është interesante se kur vije puna tek ekzekutimi përmbaruesi dhe thesari nuk vetë ku të i merë mjetet por ata ku gjënë mjete aty edhe i merë. Sa i përket detyrimeve kontingjente, në vitin 2017/2018 ne në një periudhë ne si komunë nuk kemi pasur avokat të komunës, dhe neve na ka munguar një raport i tillë, kurse në fillim të vitit 2018 ne kemi pasur avokat të komunës dhe pastaj në fund të vitit 2018 është dorëzuar raporti që i ka bartur edhe këto borxhe, pra detyrimet kontingjente nga viti 2017. Sa i përket shpenzimit të buxhetit në masë të vogël, të nderuar, e kam cekur edhe në KPF se ne raportin financiar vjetor kur e kemi dorëzuar, i kemi marr parametrat e buxhetit fillestar dhe buxhetit përfundimtar, pra sa ka qenë buxheti i planifikuar e kemi llogaritur në përqindje. Ju të nderuar në faqe nr. 12 keni mundësi të shihni më mirë, auditori e merë për bazë buxhetin përfundimtar, në gjatë viti fiskal 2018, kemi pasur prurje buxhetore në vlerë prej 585,000.00 €, nëse e krahasojmë në përqindje raportin e buxhetit përfundimtar në raport me buxhetin fillestar atëherë 96,7% që e kemi shpenzuar buxhetin, nëse i fusim edhe këto pronat e tjera atëherë realizimi i buxhetit përfundimtar me realizim të buxhetit dele diku 91%. Pyetje tjetër ishte, pse kaq pak shpenzim të buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Ne e kemi diskutuar edhe në takime tjera sepse pikërisht është pjesa e pamundur vetanake të cilën nuk kemi pas mundësi me e realizu, diku planifikimi i të hyrave vetanake ka qenë 1,650,000.00 €, kurse ne i kemi realizuar vetëm 1,160,000.00 €, pikërisht kjo diferencë e paraqet përqindjen e mos realizimit të buxhetit. I nderuari z. Dervish Çadraku, auditori nuk e shkruan punën e mirë, auditori i gjen dhe i raporton vetëm gjërat negative ose keq çka kemi bërë, ky është dallimi, sikurse të kishte shkruar edhe punët e mira që janë bërë, atëherë mendoj se kishim pas me dalë shumë më mirë, megjithëse unë

pajtohem me të gjitha ato që janë thënë, por të gjitha këto të gjetura janë të vogla, me një angazhim pak më serioz ne do të i kryejmë edhe këto. Sa i përket pyetjes për investime kapitale, realizimi i buxhetit për investime kapitale ka shkuar në masën prej 98%, por me prurjet që janë ardhur thuaja 100% është shpenzuar, auditori këtu e ka shmangur pjesën e obligimeve që i kemi bartur nga viti 201, kurse e ka cekur se ne e kemi paguar vetëm për pjesën e borxheve. E falënderoj z. Ali Zhuniqi për sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna, po ashtu edhe z. Ali Morinë. E nderuar znj. Afërdita Thaqi, në vitin 2017 i kemi pasur 13 rekomandime, kurse në vitin 2018 i kemi 21 rekomandime, e nderuar numri i rekomandimeve nuk qon peshë, peshë qon se qfar rekomandime ju janë dhënë. P.sh pe marrim regjistrimin e pasurisë ose asetëve komunale, vazhdimisht komuna e Rahovecit e ka pas këtë problem, ky rekomandim qon shumë peshë, ne këtë pikë e kemi përmbush dhe më nuk kemi rekomandim për këtë, ky rekomandim është sa 10 rekomandime tjera që na janë dhënë këtë vit. E falënderoj znj. Rukije Krasniqi për lëvdatat, por mendoj se nuk kam nevojë për aso epitete, nuk jam ekspert por mundohem që ta kryej punën sa më mirë që mundem.

Ali Zhuniqi – Tek çështja e angazhimit të stafit për shërbime të veçanta, konkretisht thuhet: Është lidhur marrëveshja me shërbimet e veçanta për 9 punonjës, pastaj thotë komuna fillimisht kishte përdorur bazën e gabuar ligjore, duke lidhë kontrata për punët e tyre specifike në kohëzgjatje prej 120 ditë sipas ligjit të punës. Pastaj pas përfundimit të këtyre kontratave komuna ka vazhduar edhe për 6 muaj tjerë me marrëveshje për shërbime të veçanta me ligjin e shërbyesve civil. Një dukuri e tillë sipas jush është për arsye se të interpretimit të gabuar të ligjit nga zyrtari i personelit, a ka të drejtë menjëherë pas 120 ditëve të vazhdohet kontrata me shërbime të veçanta, bazuar në shërbimin e ligjit civil, nëse jo a është mare hapë konkret nga ana e kryetarit të komunës për menaxherin e personelit, i cili e ka bërë këtë gabim ligjor, nëse jo ne si LVV kërkojmë që të merren hapa konkret dhe ky menaxher i personelit të ndëshkohet.

Kryesuesi – I nderuar sa i përket pyetjes së raporteve të drejtorive, të gjitha i keni në veb faqe të komunës.

Isak Hoti – I nderuar z. Zhuniqi, kontratat për shërbime të veçanta janë të lejuar me ligj, a vije ky në pushtet apo dikush tjetër, kjo do të përcillet deri me 1 nëntor, pas kësaj date më nuk ka këso kontrata, por nuk do të thotë se nuk do të kemi zgjidhje për këso kontrata të ngjashme, sepse do të ketë ndonjë model tjetër. Sa i përket çështjeve ligjore të këtij ligji a ka të drejtë apo jo, bëhet një dallim, kontrata për punë dhe detyrë specifike është diçka tjetër, kjo nuk lidhet me kontrata për shërbime të veçanta që i përcakton krejt një ligj tjetër. Kurse sa i përket gabimit që e ka bërë shefi i personelit, ne për një gabim teknik nuk mundmi ta pushkatojmë njeriun, e ka pranuar gabimin dhe më nuk do të përsëritet më.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e bërë sa i përket pikës së tretë, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale.

Afrim Oruçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar anëtar të kuvendit para jush propozoi vendimin e Kryetarit të Komunës në bazë të ligjit të Këmbimit të Pronës, kjo pronë gjendet në zonën kadastrale në Rahovec, bëhet fjalë për 60 ari, pronë e cila është në shfrytëzim të Agjencionit Pyjor andaj propozoi para juve që të këmbejmë me pronë komunale të Komunës së Rahovecit me të njëjtën sipërfaqe prej 60 ari e cila gjendet në zonën kadastrale në Koznik. Qëllimi i këmbimit të pronës komunale me ekonomik e pyjeve është që të ndërtohet kulla e gurit për heronjtë e Kosovës, Selajdin Mullabazi-Mici dhe Xhelal Hjada-Toni si dhe për dëshmorët Bektesh Haliti, Nezir Ymeri dhe Hamdi Hajrizi. Ftoi kuvendarët që pas shqyrtimit të propozim-vendimit për këmbim të votojnë vendimin për këmbimin e pronës komunale me pronë që është në shfrytëzim të Agjencionit Pyjor.

Kryesuesi – Të nderuar nëse nuk keni askush të shtoni diçka sa i përket pikës së katërt të rednit të ditë, atëherë e qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër për raste të veçanta.

Afrim Oruçi – Të nderuar Me kënaqësi paraqesë para jush me kërkesë të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës Komunale në raste të veçanta, bëhet fjalë për Ushtrinë e Republikës së Kosovës e cila na është drejtuar me kërkesë dhe po kërkon prej neve në shfrytëzim afatshkurtër të përcaktuar me dhjetë (10) vite. Këto dy prona gjinden në zonën kadastrale në Rahovec ashtu siç e keni të paraqitur në projektor bëhet fjalë për prona shtetërore të Komunës së Rahovecit, njëra prej parcelave është prej 68 ari e 6 metra², këto parcela gjinden mbi poligonin të cilin e ka pas për një kohë të gjatë KFORI, ndërsa parcela tjetër është afër kësaj. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është ruajtja dhe ngritja e niveleve të trajnimeve dhe profesionalizmit të Batalionit-Brigadës për Reagime të Shpejta duke u bazuar në misionit e Ushtrisë së Republikës së Kosovës. Afati kohor i dhënies në shfrytëzim të kësaj prone është 10 vite andaj Komuna e Rahovecit do të kujdeset që të realizojë interesin publik. Ftoi kuvendarët që pas shqyrtimit të votojnë propozim vendimin e Kryetarit për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone për dhjetë (10) vjet.

Fehmi Cena – Të nderuar Ne këto pikat i kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e KPF-së, këtu ka qenë dilema se shkruante në atë dokumentin se është pjesa që KFORI më herët e ka shfrytëzuar për manovra të veta, mirëpo është sqaruar nga drejtori që është një parcelë tjetër, ashtu që jemi dakorduar dhe mendoj që kjo duhet të kalojë.

Kryesuesi – Të nderuar nëse nuk kemi dikë tjetër të lajmëruar, atëherë e qesim në votim Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër për raste të veçanta. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pikë e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 42099 m² në Rahovec.

Afrim Oruçi - Të nderuar kuvendar para jush e keni vendimin për shpallje në interes të përgjithshëm të parcelës P7-15-10057-02240-1 në sipërfaqe prej 110 mijë m² në Rahovec, kjo parcelë gjendet në zonën kadastrale në Rahovec, saktësisht përmbi dhe përfund rrugës transit që e lidh Rahovecin me Therandën dhe pjesë tjera. Qëllimi i shpalljes të kësaj sipërfaqe të parcelës, bëhet fjalë për 1 hektar e 10 ari, qëllimi i kësaj është të ruhet vlera e pronës komunale, andaj ftoi kuvendarët pas shqyrtimi propozimit të votojnë vendimin që të shpallet me interes të përgjithshëm.

Fehmi Hoxha – Të nderuar propozoj që kjo pikë të tërhiqet menjëherë, pasi që jemi në kundërshtim me një vendim që kuvendi komunal, vendimmarrja e kaluar me datën 14 .07.2016 e ka marr vendim për iniciimin e procedurës për zgjerimin zonës ndërtimore rreth rrugës transit në Rahovec. Komplet kjo është bërë me të vetmin qëllim që me mujtë që kjo parcelë të inkorporohet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit, andaj nuk kemi të drejtë shkojmë kur e kemi një vendim i cili është 113 hektar. Ju lus që kjo të mos të procedohet dhe të shtyhet edhe pas miratimit të PZHK -së të bëhet një parcializim prej anës së qeverisë komunale dhe më pas të fillohet procedura dhe të kërkohet nga Agjencioni Pyjor i Kosovës që t'i kthehet prona.

Afrim Oruçi - Falënderoj kuvendarin në fjalë lidhur me shqetësimin e tij personal lidhur me këtë propozim-vendim, sa për informatë dhe shpjegim për anëtarët e tjerë të kuvendit bëhet fjalë për 1 hektar e 10 ari, është mirë që Kuvendi i Komunës snë atë kohë ka marr një vendim për inkorporim të kësaj parcele për 113 hektar, sot bëhet fjalë për 1 hektar e 10 ari, ne po propozojmë me shpallë këtë parcelë me interes të përgjithshëm. Ftoj edhe njëherë kuvendarët që të votojnë propozim-vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm të kësaj sipërfaqe, se nuk besoj që bëjmë ndonjë shkelje ligjore se hala nuk ka kaluar Plani Zhvillimor Komunal.

Rexhep Oruçi – Të nderuar anëtar të kuvendit e mora fjalën sa për sqarime juridike, nëse e kemi një vendim në fuqi pa marrë parasysh sa hektarë është, atëherë duhet të korrigjohet vendimi paraprakë nëse

njëherë është shpallë, ose duhet të bëhet plotësim ndryshimi i vendimit përndryshe nuk ka kurrfarë kuptimi juridik.

Isak Hoti – Të nderuar e para ne nuk e shkelim ligjin me këtë, vendimi që është nxjerr në 2016 është nxjerr vendim për zgjerimin e zonës ndërtimore, asgjë tjetër. Nuk bëjmë shkelje sepse realisht është bërë propozim deri në marrjen e vendimit të PZHK-ës, e cila është në përpunim e sipër (PZHK-ja), nuk ka përfunduar dhe nuk do të thotë që ne duhet t'i ndërprejmë procedurat.

Munib Durguti – Shefi i zyrës ligjore e dha sqarimin e nevojshëm, unë kisha propozuar që në kuadër të këtij vendimi patjetër të ceket vendimi i viti 2016, pra të mos kemi dy vendime paralele për një çështje, aty kuvendi duhet me vendos natyrën për çka, mirëpo ne tash po kërkojmë me nda një hapësirë të vogël brenda asaj prone.

Isak Hoti – Të nderuar në këtë rast akoma nuk është fuqizuar ai vendim komplet se nuk është miratuar ende PZHK-ja.

Qazim Qeska – Të nderuar kuvendar Janë dy opinione këtu dhe nuk besoj që jemi kundër interesit të përgjithshëm shoqëror apo të komunës por sidoqoftë Isaku dha një arsyetim, ky vendim i vitit 2016 që është mos është ndesh me projektin që ju e planifikoni me këtë interes të përgjithshëm. Zona ndërtimore është shumë më me peshë se sa çdo projekt që është kundër zonës.

Sali Sallteku – Të nderuar anëtar të kuvendit ne biseduam deri tash për interes të përgjithshëm, andaj unë konsideroj së interes i përgjithshëm i të gjithë qytetarëve të Komunës së Rahovecit është që kjo pronë të shfrytëzohet për interes të qytetarëve të komunës së Rahovecit.

Fehmi Cena – I nderuar drejtor kjo parcela a është mbi rrugën transit apo nën transit sepse prezenca në këtë skicë nuk na e sqaron plotësisht, edhe pse në mbledhjen e KPF-ës kemi kërkuar që të prezantohet në ortofoto. Ndërsa po të pyetesh unë ndërtimet mbi rrugën transit nuk do të kisha lejuar. Po ashtu numrat që e keni cekur në vendim rreth kësaj parcele duhet të përmirësohen sepse nuk përputhen me atë që e propozuat dhe kjo që është në dokumentet të cilat i keni paraqitur. Po ashtu kjo pjesë-parcelë a do të jetë e përfshirë në PZHK apo jo.

Afrim Oruçi - Fillimisht më lidhje me sqarimin e ngritur nga z. Cena, bëhet fjalë për 70 ari mbi rrugën transit edhe për 40 ari tjera përfund rrugës transit, ne jemi veç fazën e parë sipas ligjit ndërsa pas kësaj faze ne prapë do të vijmë tek ju që të kërkojmë pëlqim për këmbim dhe nëse ju na e jepni pëlqimin për këmbim ne e bëjmë këtë pronë shtetërore të Kosovës. Në po e bëjmë atë pjesë vetëm për 1 hektar e 10 ari në mënyrë që të vazhdoj procesi përpara, mirëpo ju jeni ata që vendosni.

Afrim Dina – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e bërë, e qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 42099 m² në Rahovec. Konstatojë se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 42099 m² në Rahovec.

Afrim Oruçi - Të nderuar kuvendar para jush e keni vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm të parcelës 2240P1, bëhet fjalë për sipërfaqe për zonë kadastrale në Rahovec, bëhet fjalë për 4 hektar e 20 ari e 99 m², tash jemi në mes të rrugës të Epopeja e UÇK-ës te maja e Shkodranit, qëllimi i kësaj parcele me interes të përgjithshëm është që po dëshirojmë me ruajt pjesën që është shumë afër majës së Shkodranit, andaj ftoj kuvendarët që të votojnë propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të sipërfaqes së 4 hektar 20 ari e 99m².

Kryesuesi – Nëse nuk ka askush të shtoj diçka sa i përket kësaj pika, e qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit të komunës për Shpalljen me interes të përgjithshëm pjesa e parcelës P-71510057-02240-1, në sipërfaqe prej 42099 m² në Rahovec: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e shtatë (7) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

8. Informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për objektet e trashëgimisë kulturore – historike të Komunës së Rahovecit.

Bjondina Kleqka – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, gjatë mbledhjeve të kaluara është kërkuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që të përgatitet një informatë lidhur me listën që e kemi ne si drejtori rreth objekteve të vjetra dhe trashëgimisë së Rahovecit. Në bazë të analizës që është bërë nga viti 2000 deri në vitin 2019, nga trashëgimia pakufi, është përpiluar kjo listë të cilën ju kemi dërguar në kopje fizike dhe është listuar në bazë të vjetërsisë së tyre. Disa nga objektet e trashëgimisë kulturore të përmendura në këtë listë janë rrënuar dhe ka mungesë të përpunimit të aseteve dhe për të ndryshuar listën ne do të formojmë një komision me njohës të kësaj fushe dhe listën me propozime t’ia dërgojmë Këshillit të formuar nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport pasi që është në kompetencë të tyre për caktim të objekteve në listën e mbrojtjes nga shteti.

Fehmi Cena - Fillimisht e falënderoj drejtoreshën për këtë informatë të cilën e kemi kërkuar në mbledhjet e kaluar, ne e kemi ngritur këtë çështje për arsye se Rahoveci si qytet ka objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike. Kjo listë mendoj që është hapi i parë në këtë drejtim edhe pse këtu ka objekte edhe pse janë në listë mirëpo kështu nuk ekzistojnë si objekte. Prandaj duhet të përpilohet një listë me objekte të vërteta që ekzistojnë. Kishte me qenë mirë që në mbledhjen e ardhshme drejtoresha të del me propozim për formimin e komisionit.

Ali Zhuniqi – Të nderuar ajo që mua më intereson më së shumti është a i keni identifikuar të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore që janë në komunën e Rahovecit apo ende jeni në procedurë duke pritur formimin e komisionit.

Kryesuesi – Nëse nuk ka askush të shtoj diçka sa i përket pikës së tetë të rendit të ditës, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit.

Isak Hoti - Pas kërkesave të shumta dhe ankesave që janë bërë në Komunë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve, kryetari e ka pa të arsyeshme që të formoj edhe dy komisione, një është për emërtimin e rrugëve aty ku nuk e kemi përfunduar komplet dhe tjetri është për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve të komunës së rahovecit, përkatësisht në Drejtorinë e Urbanizmit. Në këto komisione duhet të jenë pesë (5) anëtar për komisionin për ankesa dhe pesë anëtar (5) për komisionin emërtimin e rrugëve, tre anëtar janë nga kuvendi e dy nga ekzekutivi.

Fehmi Hoxha – Të nderuar ne e kemi pas komisionin e parë, në kohën kur e ka marr mandatin e parë kryetari aktual, Smajl Latifi, është vendosur në këtë kuvend, unë kam qenë edhe atëherë anëtar i kuvendit edhe është formuar komisioni procedurat kanë përfunduar të gjitha. Është votuar lista komplet, janë 28-29 rrugë emrat që janë lënë rezervë sipas ligjit për emërtimin e rrugëve, ku mbikëqyrës dhe implementues ka qenë Agjencioni Kadastral i Kosovës.

Florida Krasniqi - Lidhur me komisionin e emërtimit të rrugëve dhe shesheve, ka pasur familje të cilët kanë pasur vërejtje në emërtimin e rrugëve dhe shesheve të qytetit apo fshatrave, ku janë bërë gabime që duhet të përmirësohen, sepse kanë vendosur emra të njëjtë të dëshmorëve.

Qazim Qeska - Një sqarim se po shkaktohet konfuzion, po bëhet njëherë një komision për ankesa, mandej komisionin për emërtimin, cili është më i vjetër? Nëse doni të punoni me komisionin për ankesa me emërtime të vjetra është diçka tjetër, mirëpo njëherë duhet të formohet komisioni për emërtimin e rrugëve dhe shesheve, pastaj komisioni për ankesa, flas gjithmonë sipas bindjes sime.

Fehmi Hoxha – I nderuar kryesues sinqerisht kërkoj falje që po ndërhy, ky komision për emërtimin e rrugëve çka ka më bërë? A kemi më emërtu rrugë të reja apo ka mu marr me listën rezervë që është 28-29 me ligj.

Isak Hoti - Është e drejtë ekskluzive e kuvendit, e secilit kuvend brenda kufijve administrativ që të vendos për rrugë të komunës, pa marr parasysh se cilës listë.

Florida Krasniqi – Të nderuar anëtar të kuvendit pse mos të bëjmë ndryshime nëse ka pasur gabime në emërtimin listave të bërë nga komisioni i parë.

Kryesuesi – Të nderuar anëtar të kuvendit ja fillojmë me propozime të emrave për komisionin për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve të komunës së Rahovecit.

Ali Morina – Ne grupi i AAK-së propozojmë znj. Besmire Bytyqi.

Qazim Qeska – Ne grupi i PDK-së propozojmë znj. Afërdita Thaqi.

Fehmi Cena – Ne grupi i LDK-së propozojmë z. Vahid Krasniqi.

Kryesuesi – Ju faleminderit pra emrat e anëtarëve të komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve të komunës së Rahovecit janë: AAK- znj. Besmire Bytyqi, PDK- znj. Afërdita Thaqi, LDK- z. Vahid Krasniqi, kurse dy emrat e ekzekutivit janë: z. Rumir Zhuniqi dhe znj. Bjondina Kleqka.

Ali Zhuniqi – Të nderuar e di që ka shumë rëndësi formimi i këtyre komisioneve dhe e di që ka pas probleme para se me qenë asamblist nga mandati i kaluar, ato probleme i ceki edhe z.Hoxha, problemi është jashtëzakonisht i ndjeshëm. Atëherë unë mendojë që në kuadër të këtij komisioni të përfshihen edhe subjekte që janë më të vogla për arsye se edhe ne mund të japim kontribut në këtë fushë.

Isak Hoti - Në bazë të Udhëzimit Administrativ, është pak keq për partitë e vogla mirëpo ministritë e kanë bërë këtë. Neni 5 i këtij neni përbërja e komuniteteve, në rast thotë se në përbërjen e kuvendit të komunës janë të përfaqësuar më shumë etnitete politike me çka bën të pamundur përfshirjen e të gjithë etniteteve në komisioni dhe komitete për politikë, atëherë përfaqësuesit do të bëhen në bazë të përqindjes së përfaqësuar në kuvendin e komunës.

Kryesuesi - E qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Rahovecit, me këto emra të propozuar: AAK – znj. Besmire Bytyqi, PDK- znj. Afërdita Thaqi, LDK- z. Vahid Krasniqi, dhe nga ekzekutivi, z. Rumir Zhuniqi dhe znj. Bjondina Kleqka. Konstatohet se me 2 abstenime dhe të tjerët pro është aprovuar pika e nëntë (9) e rendit të ditës, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendar Gjithashtu edhe në këtë komision duhet të jenë tre anëtar nga kuvendi dhe dy nga ekzekutivi, po fillojmë me propozimet.

Ali Morina – Ne grupi i AAK-së propozojmë Rukije Krasniqi

Qazim Qeska – Ne grupi i PDK-së propozojmë z. Munib Durguti.

Fehmi Cena – Ne grupi i LDK-së propozojmë z. Faton Ramadani.

Kryesuesi – I nderuar z. Cena nëse ka mundësi të propozoni një emër të gjinisë femërore për shkak të kuotës, sepse nëse shkojmë kështu atëherë MAPL-ja do na kthejë vendimin për rishqyrtim.

Fehmi Cena - I nderuar kryesues nëse duam parlamentarizëm pak më shumë, AAK-ja duhet të tërhiqë pak më shumë nga këto komisione se edhe ashtu prej pesë (5) anëtarëve, dy nga ekzekutivi i takojnë AAK-ës tash shumicën e kanë ata nëpër komisione dhe kjo po del jodemokratike.

Kryesuesi - Pra emrat e anëtarëve nga ana e kuvendit për komisionin për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve janë: AAK – z. Rukije Krasniqi, PDK- z. Munib Durguti, LDK- z. Faton Ramadani, dhe nga ekzekutivi znj. Saranda Sallteku dhe z. Hasan Përboqi. E qes në votim Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit, me këto emra që i ceka më parë: Konstatohet se me 4 abstenime dhe të tjerët pro është aprovuar pika e dhjetë (10). Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

11. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit për vitin 2019.

Bjondina Ramaj - Përsëritet për të gjithë të pranishmit edhe pse kemi pas shumë pika e kjo është pika e fundit, të gjithë e keni raportin përballë, unë dua të flas në pika të shkurtra kush ka ndonjë pyetje jemi këtu me ju dhënë përgjigje por do të fillojmë me raportin për gjendjen e mbeturinave. Vështirësitë dhe problemet në sektorin e mbeturinave janë evidente në menaxhim, si në ndarjen, riciklim, trajtim dhe deponim andaj besoj fuqishëm se në koordinim me komunën Rahovecit dhe me drejtorinë e Shërbimeve Publike mund të arrijmë që të kemi një sistem funksional dhe ekologjik për menaxhimin e mbeturinave. Sfidat kryesore janë

jo vetëm në komunën tonë por janë pothuajse në gjithë Kosovën, ne jemi munduar pak a shumë që të ballafaqohemi dhe të bëjmë një pastrim apo angazhim të mirëfilltë në gjithë komunën tonë. Operatorët e menaxhimit të mbeturinave qysh në vitin 2011, komuna e Rahovecit ka gjithsej 56 mijë e 208 banor, shtrirja e popullatës në komunë është më shumë në zonën rurale se urbane. Ndërmartjet publike që funksionojnë në komunën tonë është ‘‘Ekoregjioni’’ kurse ndërmarrja private është ‘‘Ekodrinia’’. Ne kemi bërë pastrim nga tërë muajit edhe jemi duke i larguar të gjitha pikat evidente, pra i keni të gjitha në raport.

Afrim Dina - Faleminderit znj. Bjondina Ramaj, a ka ndokush ndonjë gjë për të diskutuar, nëse jo atëherë vazhdojmë me pikat e radhës të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës Për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, afatshkurtër dhe afatgjatë.

Isak Hoti - Atëherë siç e thamë në fillim të seancës që me 3 Prill 2019 është shfuqizuar ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale dhe është hy në fuqi ligji i ri i cili na obligon ti ndërrojmë edhe komisionet, tani ligji e ka përcaktuar që të jenë pesë (5) anëtar. Kryetari i Komunës i propozon dy anëtar nga ekzekutivi i Komunës, kuvendi i komunës i propozon dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës, ndërsa një (1) anëtarë nga sektori joqeveritar i cili propozohet nga sektori joqeveritar lokal, çka do të thotë që ne do t'i ftojme organizatat joqeveritare-sekretaria do ta sjell një emër. Me 16.02.2018 është marr vendim me numër 595 për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim në afatshkurtër dhe afatgjatë. Vendimi i cili duhet të rishqyrtohet ose përmirësohet janë këto emra 1, Refki Kryeziu-PDK, Artan Zenuni –AAK, Masar Popaj-LDK, Afrim Limani-Ekzekutiv, Afrim Oruqi-Ekzekutiv, Saranda Sallteku-Ekzekutiv dhe Feriz Thaqi- Përfaqësues nga OVL-ja. Ndërsa të komisioni i ankesave kanë qenë tre (3) tash duhet të jenë pesë (5).

Dervish Çadraku – Të nderuar a duhet tani ne të japim propozimet e reja apo vetëm duhet të i heqim nga vendimi i vjetër dy emra.

Isak Hoti – Të nderuar vendimi i vjetër shfuqizohet në momentin që ne e aprovojmë vendimin e ri.

Masar Popaj – Të nderuar kuvendar në këtë komision jam edhe unë, mirëpo mesa e di unë shtatë takime i kemi pas dhe në shtatë takime nuk kam munguar asnjëherë, kurse ka pas raste që disa kolegë nuk kanë qenë të rregullt kanë munguar.

Kryesuesi – Të nderuar tani ju kisha lutur që të na jepni emrat e anëtareve të juaj.

Ali Morina – Ne grupi i AAK-së z. Artan Zenuni.

Qazim Qeska – Ne grupi i PDK-së Refki Kryeziu.

Fehmi Cena - Në fakt z. Masar Popaj ka qenë anëtar i gjertanishëm dhe ai tha diçka, tash udhëheqës i komisionit ka qenë drejtori Afrim Limani, natyrisht që ne propozojmë që Masar Popaj me qenë përsëri se ashtu ka qenë aktiv dhe nuk ka munguar asnjëherë.

Kryesuesi – Të nderuar anëtar të kuvendit veç edhe një sqarim të vogël sipas Udhëzimit Administrativ të ri, kuvendi i ka dy anëtar jo tre, dhe nga ekzekutivi dy, po ashtu duhet të respektohet kuota gjinore.

Ali Morina - Unë kisha propozuar që pasi që jemi grupi më i madh që në këtë komision të mbeten emrat që i propozuam, ndërsa tek komisioni i ankesave ne tërhiqemi nuk e delegojmë asnjë emër i lejmë radhën LDK-ës që të propozojnë ose partive tjera.

Fehmi Cena – Ju lutem tani ku po mbetet performanca, përfaqësuesi i LDK-ës asnjëherë nuk ka munguar ndërsa përfaqësuesi i AAK-ës ka munguar çdoherë, ne çdo herë kur diskutojmë çoftë për mbledhje, plane, raport e kërkojmë performancën, AAK-ja i ka dy përfaqësues tregohuni pak parlamentar.

Ali Zhuniqi – Pasi që kemi ardhur deri në këtë pikë që asnjëri prej subjekteve mos të lëshojmë pe edhe për plotësimin e kuotave gjinore ne kërkojmë që së paku parimet në bazë të ligjit të respektohet andaj propozojmë që votimi të bëhet fshehtas.

Isak Hoti – Të nderuar në bazë të praktikave ka dy lloje të votimeve, votim të fshehtë dhe votim të hapur, në këtë rast keni të drejtë të votoni sipas propozimit, propozon i pari votohet i pari, kush është për, vjen te i dytë kush është për e kështu më radhë, pastaj cili merr vota më shumë, dy të parët shkojnë i tretë mbet.

Faton ramadani – Z. Isaku e tha ashtu qysh mendoj ai, por unë mendoj ndryshe, por që po lypen dy kam të drejt dy, kurse z. Isaku po na mohon po thotë vetëm për një kandidat kemi të drejtë të votojmë.

Isak Hoti – I nderuar neni pesë (5) pika 2 në rast së përbërja e kuvendit të komunës janë të përfaqësuar me shumë etnitete politike me çka bën të pamundur përfshirjen e të gjithë etnitetëve të komiteteve dhe komisioneve, atëherë përfaqësimi do të bëhet në bazë të përqindjes së përfaqësuar në kuvendin e komunës. Ai që e ka përqindjen më të madhe, propozon i pari, i dyti nëse i ka më shumë se dy, atëherë propozohen dy, tre, katër e pesë.

Rukije Krasniqi - Propozime të tilla nëpër komisione nuk është vetëm që në këtë mandat kemi pas, kemi pas edhe në mandate tjera, a ju kujtohet se sa herë keni thënë ju po n'a mbi votoni, nëse ka qenë dy anëtar atëherë veç dy anëtar të propozohen. Ne si Aleancë kemi qenë me shtatë vota dhe kurrë s'kemi qenë në komisione, anëtarët e partive politikë që kanë pas numrin e pjesëmarrjes të anëtarëve të kuvendit me numër më të madh, ata janë propozuar dhe ata kanë shkuar askush nuk na ka pyet neve.

Sali Sallteku – Të nderuar Atëherë kemi qenë 18, tash nëntë jeni ju nëntë jemi ne, unë po them kështu kryesues krye në bazë të rregullores mos të maltretohemi më gjatë.

Fehmi Cena - Nëse ekziston mundësia me kalu me vota, qite në votim, nëse në hapin e dytë mund të hyn në vota, po hymë në vota kush ka më shumë le të kalojë nuk jemi kundër, nëse është kundër procedurale shkoni ashtu, por neve do të na keni kundër për dy arsye: Që në vota nuk po doni me i fut dhe nuk ka logjikë juridike për mendimin tim, dhe e dyta nuk jemi që me largu kandidatin, jo pse është i yni por se ka treguar performancë më të mirë në komision.

Besmire Bytyqi – Përsëendetje për të gjithë, Përsëendetje Kryesues, kështu, ne nuk të shkojmë në votim përderisa i kemi dy të gjinisë mashkullore. Ne duhet t'i kemi emrat paraprakisht se kush do të jetë nga ekzekutivi.

Kryesuesi - Të nderuar atëherë po shkojmë ashtu si e përcakton udhëzimi administrativ, emrat e propozuar për komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, afatshkurtër dhe afatgjatë janë: Nga kuvendi AAK – z. Refki Kryeziu , PDK – z. Refki Kryeziu, nga ekzekutivi: Saranda Sallteku dhe z. Artan asllani, kurse nga shoqëria civile Sihena Duraku. E qes në votim pikën e dymbëdhjetë (12): Konstatoj se me 15 për, 8 kundër dhe 2 abstenime është aprovuar pika e dymbëdhjetë (12) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës Për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave.

Kryesuesi – Ju lutem të fillojmë me propozimet e emrave edhe për këtë komisione.

Afërdita Thaqi – Ne nga grupi i PDK-së propozojmë z. Fehmi Hoxha.

Ali Morina – Ne grupi i AAK-së tërhiqemi nga ky komision, ja lëmë radhën kësaj herë LDK-së dhe VV-së.

Fehmi Cena – I nderuari kryesues ne nuk kemi emër për këtë komision.

Ali Zhuniqi – Edhe ne i nderuari kryesues nuk kemi emër për këtë komision.

Ali Morina – Atëherë pasi këta nuk dëshirojnë të jenë pjesë e këtij komisioni, ne e propozojmë znj. Besmire Bytyqi.

Kryesuesi – Atëherë emrat propozuar për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave janë: Nga kuvendi AAK- z. Besmire Bytyqi, nga PDK- Fehmi Hoxha, kurse nga ekzekutivi janë: z. Afrim Oruçi dhe z. Besnik Hoti, kurse nga shoqëria civile do sillni emrin në sekretari të kuvendit që të plotësohet në vendim. E qes në votim pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: Konstatoj se me 15 vota për, asnjë kundër dhe 9 abstenime është aprovuar edhe pika e trembëdhjetë e rendit të ditës. Kalojë në pikën e radhës të rendit të ditës:

14. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës për dhënien e Lloptopave anë anëtarëve të kuvendit.

Kryesues – Tani e qes në votim propozimin e kryetarit që e dha në fillim të mbledhjes sa i përket mos kthimit të lloptopave pas përfundimit të mandatit. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërbëdhjetë (14) e rendit të ditës.

Kryesuesi – Kuvendar të nderuar ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 15:40


01 Nr. _____
Rahovec, 28.06.2019

Procesmbajtësi

Skender Hamza

KRYESUESI

Afrim Dina



KOMUNA
RAHOVEC




RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

JANAR- QERSHOR 2019



Në këtë raport gjashtë mujor janë pasqyruar aktivitetet, punët dhe angazhimet tona të cilat i kemi realizuar gjatë periudhës (Janar- Qershor)

2019



PËRMBAJTJA

KRYETARI I KOMUNËS	2
Zyra Ligjore	5
Njësia e Auditimit të Brendshëm	6
Zyra për Informim	7
Zyra për Komunitete dhe Kthim - ZKK.....	8
Njësia e Personelit.....	9
Zyra për Përfaqësim Ligjor	12
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË	15
Sektori i gjendjes civile	15
Sektori i teknologjisë informative	15
Sektori për punë të Kuvendit dhe komiteteve	16
Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve.....	16
Njësia komunale për të drejtat e njeriut.....	16
Zyra për integritet evropiane.....	17
Barazia gjinore.....	18
DREJTORIA PËR FINANCË DHE BUXHET.....	18
Sektori i Buxhetit dhe Financave.....	18
Të hyrat vetanake.....	20
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE	20
DREJTORIA PËR ARSIM	22
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM.....	24
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	25
Sektori i urbanizmit dhe planifikimit.....	26
Sektori i Mjedisit	27
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	27
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	28
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	30
DREJTORIA PËR INSPEKTIM	33
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	35
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM.....	40
PËRFUNDIM.....	41

KRYETARI I KOMUNËS

Parathënie

Qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dates 29.03.2017, dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2019, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin gjashtëmuor për punët, angazhimet dhe arritjet e komunës së Rahovecit për periudhën Janar - Qershor 2019.

Pavarësisht se raporti është i zgjeruar, sepse secila drejtori dhe njësi apo zyre është subjekt i raportimit, megjithatë, mund të kemi harruar edhe diçka që është dashur të përfshihet.

Sidoqoftë, jemi të hapur për këshilla, vërejtje e plotësime, të cilat do të ndikonin që të përmirësohet raportimi si element i rëndësishëm i transparencës, për më tepër, të përmirësohet nga dita në ditë puna jonë në shërbim të qytetarëve tanë.

Vizioni

Vizioni ynë i përbashkët për Rahovecin është: **“Përmirësimi i mirëqenies së të gjithë qytetarëve, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve publike, që janë të qasshme në nivel lokal, krijimi i kushteve më të mira për investime në ekonomi, kthimi i hapësirave nga menaxhimi i APK (Agjencioni Pyjor i Kosovës) në menaxhim nga Komuna, bujqësi e zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale, edukim, arsimim dhe shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët tanë”**

Synime për vitin 2019

- Përmbyllja e ciklit të investimeve në ujësjellës dhe investime në trajtimin e ujërave të zeza
- Investime më të mëdha në bujqësi, në kullimin e tokave bujqësore dhe rritja e përkrahjes direkte për fermerët
- Rrugët fushore
- Funksionalitet më i madh i rrjetit të shërbimeve shëndetësore dhe kohëzgjatje e shërbimeve
- Investime në projekte që nxisin zhvillimin e turizmit
- Shtimi i hapësirave të gjelbëruara dhe mirëmbajtja e tyre
- Investime më të mëdha në arsim, kulturë, rini dhe në sport
- Ndërtimi i çerdheve për fëmijë
- Mbrojtje sistematike e mjedisit
- Ndërtimi i parkingjeve të reja, rrugëve, trotuareve, shesheve etj.
- Sinjalizim më i mirë i rrugëve dhe projekte për ndriçimin publik
- Investime në përgatitjen dhe aftësimin e Zonës Ekonomike
- Investime në trashëgimi kulturore dhe historike, restaurime, ndërtimi i muzeve etj.
- Investime në trajtimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe përrrenjve
- Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe lirimi i trotuareve, pronave e objekteve komunale të uzurpuara
- Plani i veprimit për rritjen e të hyrave komunale
- Plani i veprimit për inkasimin e tatimit në tokë
- Plani i veprimit të KKS-së
- Plani i punës së Kuvendit Komunal
- Plani për transparencë komunale
- Plani i veprimit antikorrupsion
- Plani i prokurimit

- Plani i auditimit të brendshëm
- Plani për menaxhim të mbeturinave dhe për heqjen e deponive ilegale
- Subvencionim më i madh i OJQ-ve, kategorive të caktuara të shoqërisë dhe i veprimtarive të ndryshme komunale
- Vlerësimi strategjik mjedisor, një plan që duhet të aprovohet për Zonën Ekonomike

Prioritetet tona kryesore për Rahovecin vazhdojnë të jenë:

- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë
- Organizim më i mirë i punës dhe efikasitet i plotë i administratës komunale
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit
- Realizim i planit të të hyrave komunale
- Rritje të përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët
- Këshillime me fermerë dhe hartim të projekteve për aplikime të suksesshme
- Përmirësimi i gjendjes së ujërave të zeza dhe trajtimi i problemeve me ujërat atmosferikë
- Furnizim me ujë të pijshëm
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese
- Mirëmbajtje e hapësirave publike, krijimi i hapësirave të reja për parkingje, mirëmbajtja e rrugëve dhe ndërtimi shesheve dhe rrugicave
- Investime në ndriçimin publik
- Funkcionalizim më i madh, rritje e cilësisë dhe kohëzgjatje e shërbimeve nga ana e QKMF-së
- Vizita sistematike shëndetësore nëpër të gjitha shkollat
- Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm
- Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë e biciklistë
- Projekte për kullimin e tokave bujqësore
- Rritje e cilësisë dhe investime në arsim
- Bursa për studentë
- Investime në nyjat sanitare dhe meremetim të shkollave
- Ndërtimi i shkollave të reja
- Eficienca e energjisë në objektet shkollore dhe në objektet e tjera publike
- Hartimi i PZHK-së dhe Hartës Zonale
- Trajtimi i shtretërve të lumenjve dhe përrenjve
- Mirëmbajtja e hapësirave ekzistuese të gjelbëruara dhe krijimi i hapësirave të reja të gjelbëruara
- Rritja e rolit dhe shtimi i aktiviteteve të inspektoratit
- Terrene të reja sportive dhe përkrahje sportit
- Aktivitete të planifikuara me të rinjtë
- Përkrahje nismave për më shumë aktivitete kulturore
- Investime në trashëgimi kulturore, si dhe përkrahje aktiviteteve e përkujdesje ndaj figurave kombëtare, objekteve dhe të pozicioneve që kanë të bëjnë me ngjarjet e rëndësishme historike
- Përballje serioze dhe me efikasitet të lartë me çfarëdo situatë që ka të bëjë me emergjencat
- Të krijohen kushte të përshtatshme për investime të drejtpërdrejta për të mirën e qytetarëve përmes krijimit të vendeve të përhershme të punës si dhe zhvillimit ekonomik
- Rregulli dhe disiplina në institucione
- Mbarëvajtja e punëve dhe rritja e efikasitetit të punonjësve
- Fuqizimi i marrëdhënieve mes qeverisjes lokale dhe qytetarëve është prioritet për qeverisje të mirë dhe demokratike

- Përfshirja e qytetarëve në politikbërje i mundëson qeverisjes lokale të krijojë burime të reja të ideve, informatave dhe resursve në marrjen e vendimeve
- Respektim i parimeve të procesit të vendimmarrjes: Transparenca, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja
- Shërbim për nevojat, kërkesat e të gjithë qytetarëve pa dallim, ofrim i shërbimeve publike në kohë, përgjigje pa vonesa ndaj shkresave dhe adresimeve të ndryshme që i vijnë komunës
- Zbatim i objektivave të premtuara dhe përdorim më i mirë i mundshëm i kapacitetit njerëzor, burimeve dhe kohës në dispozicion për të siguruar rezultatet më të mira të mundshme për qytetarët
- Kontakt i rregullt dhe komunikim i hapur me qytetarët e të gjitha shtresave
- Ide dhe projekte të reja në të gjithë sektorët komunal
- Mirëmbajtja e mjedisit dhe hapësirave publike
- Përgatitje me kohë e planeve vepruese për funksionim më të mirë dhe për arritje të komunës si rezultat i qeverisjes

Aktivitetet të rëndësishme

- Takimet e rregullta me kryetarë të këshillave të lagjeve të qytetit dhe të fshatrave;
- Përballja me sezonin e dimrit dhe ndërhyrjet e shumta në pastrimin e rrugëve nga bora, krahas kësaj, edhe trajtimin emergjent të problemeve evidente në infrastrukturën rrugore dhe të ujërave të zeza, ndërhyrje që kanë vazhduar edhe në pranverë;
- Hartimi i planit vjetor të prokurimit dhe aprovimi i tij;
- Hartimi i planit vjetor të punës së Kryetarit dhe qeverisë komunale;
- Nxjerrje e urdhërave, vendimeve dhe akteve të shumta në interes të komunës dhe të qytetarëve tanë;
- Adresimi i shkresave në Qeverinë e Kosovës për përkrahjen e komunës së Rahovecit;
- Rritja e bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës
- Palestra e Sporteve, “Mizahir Isma”, në qytetin e Rahovecit, si një projekt i tejzgjatur me vite të tëra, për më shumë se një dekadë, është jetësuar (finalizuar) më datë: 27 shkurt 2019;
- Përkrahje klubeve sportive, OJQ-ve dhe kërkesave për subvencione të DKRS-së, sipas kriterëve që përmbante thirrja për aplikim, në vitin 2019 është ndarë shuma rekorde 101,100€ për Kulturë, Rini dhe Sport, poashtu, në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë ndarë gjithsej 13,800€ për vitin 2019;
- Lidhur me pranimin e aplikacioneve për pagesa direkte (subvencioneve), për herë të parë kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu, kemi marrë leje të veçant nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxjerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra. E gjithë kjo me të vetmin qëllim, për të ju lehtësuar aplikimin fermerëve të komunës sonë;
- Duke e parë që fermerët e komunës sonë gjatë viteve të kaluara kanë hasur në vështirësi në kompletim të dokumenteve dhe hartim të projekteve, ne kemi marr përsipër që të ju dalim në ndihmë fermerëve duke asistuar dhe këshilluar fermerët për mënyrën e aplikimit, kompletim të dokumenteve dhe hartimin e projekteve pa pagesë;
- Me përmirësimin e kushteve klimatike ka rifilluar nërtimi i serrave nga Operatori Ekonomik që ka kontratë me komunën e Rahovecit. Në qershor ky projekt ka përfunduar dhe janë ndërtuar, gjithsej 117 serra. Është dyfishuar sipërfaqja me serra nga 1, 5 ari, 3 ari dhe 5 ari;
- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për dëmshpërblim të fermerëve dhe ndarja e mjeteve prej 1 milion Euro ka aktualizuar temën e dëmeve të shkaktuara gjatë vitit 2018. Përpilimi i listave pranimi i dokumenteve dhe dërgimi i tyre në Ministri të Financave ka karakterizuar tremujorin e dytë të këtij viti. Deri më tani janë kompenzuar 1,224 fermerë, poashtu janë trajtuar mbi 100 raste të ankesave të cilat janë verifikuar dhe shqyrtuar nga komisioni;

- Gjatë kësaj periudhe janë ndarë gjithsej 95 bursa për studentë të Komunës së Rahovecit që studiojnë në universitetet publike në vend, kështu në krahasim me vitin e kaluar ne kemi rritur dukshëm numrin e studentëve përfitues të bursave komunale;
- Drejtoria Komunale për Arsim në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kanë realizuar vizita sistematike mjekësore te nxënësit e të gjitha shkollave të Komunës sonë;
- Përveç çerdhes në qytet, e cila është në përfundim të ndërtimit, Komuna e Rahovecit është duke e ndërtuar edhe çerdhen për fëmijë në fshatin Ratkoc, poashtu, për këtë vit, gjatë muajit korrik 2019 do të fillojnë procedurat e prokurimit për ndërtimin e 2 çerdheve të reja, 1 çerdhe në fshatin Krushë e Madhe dhe 1 çerdhe në fshatin Xërxë;
- Me vendim të Qeverisë së Kosovës është krijuar Zona Ekonomike me një hapësirë prej 35,84 ha, ka mbetur të bëhet vetëm licencimi i zonës industriale nga ana e MTI dhe fillimi i investimeve direkte në zonë, ndërsa, në zonën turistike kemi bërë shtigje te reja të ecjes, e në këtë vit pritet të bëhet edhe asfaltimi i rrugës prej Epopesë së UÇK-së deri te Maja e Shkodranit;
- Me vendim të Kryetarit është themeluar zyra për këshillim, punësim dhe mbështetje në karrierë;
- Kemi pranuar dy stomatologë të ri në dy QMF-të, një në Drenoc dhe një në Fortesë, ndërsa për dy QMF-të tjera jemi në procedurë tenderuese për ndërtimin e objektit të ri të QMF-së, në Çifllak. Presim që brenda vitit të përfundojë objekti dhe të punësojmë stomatologët, ndërsa për QMF-në në Opterushë jemi në procedurë prokurimi për blerje të një karrigeje stomatologjike;
- Ka vazhduar ofrimi i shërbimeve nga QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc me dy ndërrime, shërbime të cilat tashmë janë të përhershme;
- Jemi në angazhim të gjithmbarshëm si komunë, për eliminimin e të gjitha deponive. Kanë mbetur edhe disa të cilat së shpejti të eliminohen;
- Komuna e Rahovecit është duke vazhduar investimet çdo ditë në ndriçim publik, si në: Rahovec, Xërxë, ndërsa në fshatin Dejnë tashmë ka përfunduar ndriçimi publik. Projekti do të vazhdojë edhe në disa vendbanime të komunës sonë;
- Në mungesë të pronave komunale për të ndërtuar terrene sportive në secilën lagje, komuna ka planifikuar ndërtimin e disa fushave sportive në qytet dhe fshatra. Një në qytet në Lagjen e Epërme, poashtu, në Opterushë, Kramovik dhe Dejnë, investime që kapin vlerën e rreth 81,000 €.
- Në bazë të rregullores: 01.nr.576. dt 28.02.2017 janë liruar 63% të bizneseve që merren me veprimtari prodhuese, kafiteritë, bizneset e tekstilit dhe të gjitha bodrumet e prodhimit të verërave (familjare) etj. Poashtu, jemi në përpilim të një liste të bizneseve që nuk janë aktive dhe që kanë obligime financiare ndaj komunës, t'iu falen borxhet me ndryshim-plotësim te rregullores për taksa dhe tarifa komunale, veprim që do të ndodhë gjatë këtij viti;
- Në muajin maj 2019, është lidhur një marrëveshje mirëkuptimi në mes MIT-së dhe Komunës së Rahovecit për projektin më të madh I infrastrukture rrugore: "Rruga 4 korsi Rahovec- Xërxë",
- Komuna e Rahovecit ka pranuar çmimin për performancën më të mirë komunale për vitin 2018 (është renditur e katërta), me ç'rast kemi nënshkruar dy marrëveshje mirëkuptimi për financimin e dy projekteve: "Zgjerimi i ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit" dhe "Trajtimi i kanalizimeve fekale", ku vlera e financimit e këtyre projekteve është 60.000€;
- Riorganizimi i administratës dhe hapja e sportelit të veçantë për mërgimtarët;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në të gjithë sektorët;
- Disiplina dhe rregulli në të gjithë sektorët;
- Vizita sistematike në terren dhe përballje me shqetësimet e qytetarëve.

Zyra Ligjore

Zyra ligjore, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësi, autorizimeve si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, për periudhën gjashtë (6) mujore është përpjekur të ofrojë ndihmë juridike, shërbime, këshillime dhe ka kryer harmonizimin, plotësimin, ndryshimin dhe hartimin e akteve nënligjore,

që janë propozuar nga Kryetari i Komunës, Kuvendi dhe Drejtoritë në Komunën e Rahovecit dhe për periudhën gjashtë (6) mujore Zyra Ligjore paraqitet me këto aktivitete:

- Udhëheqja me procedurë administrative sipas lëndëve.
- Aktivitetet - ofrimi i këshillave dhe opinioneve ligjore për Kryetarin e Komunës, Kuvendin, drejtoritë komunale, sektorëve dhe njësive në Komunën e Rahovecit.
- Hartimi dhe harmonizimi i rregulloreve - hartimi dhe harmonizimi i akteve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi, hartimi i vendimeve, urdhëresave, marrëveshjeve dhe shkresave të ndryshme përcjellëse për Kryetarin e Komunës, Kuvendin dhe drejtorët e drejtorive në Komunën e Rahovecit.
- Veprimet kanë qenë permanente.
- Arkivimi dhe sistemimi i dokumenteve të zyrës ligjore si dhe përcjellja e vazhdueshme e ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve që dalin nga institucionet qendrore.
- Objektivat e planifikuara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, të realizuara.

Objektivat e arritura

Zyra ligjore për vitin 2019, kontributin e saj e ka dhënë edhe në fushën e dhënies së opinioneve ligjore për të gjitha nevojat e administratës në Komunë, përfshirë edhe Kuvendin Komunal.

Në vijim ju paraqesim aktet e hartuara nga Sektori Ligjor:

Hartimi i Rregulloreve	3
Ndysim dhe plotësim të rregullores	1
Vendime të Kryetarit	250
Vendime të Kuvendit	34
Thirrje për aplikim në subvencione	3
Përgaditje të konkurseve	3
Urdhëresa	44
Autorizime	21
Njoftime	12
Kërkesa	17
Opinione ligjore	5
Marrëveshje	7
Propozime	20
Akte përcjellëse	24
Përgjigje në kërkesë	12
Kontrata	32
Puna në komisione	14
Konsultime	permanente
Kodi Komunal i Etikës	1
Totali i akteve të hartuara për gjashtëmujorin e parë nga zyra ligjore është:	503

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Në kuadër të këtij gjashtëmujori, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të Punës për vitin 2019, i cili plan ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për vitin 2019 janë të planifikuara 10 auditime.

Prej tyre në periudhën e gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, një auditim është kryer sipas planit vjetor kurse dy auditime janë kryer sipas kërkesave të Kryetarit të Komunës.

Në tabelën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet e planifikuara dhe të kryera për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, sipas planit vjetor dhe sipas shkallës së rrezikshmërisë.

Nr.	Drejtoritë e synuara të auditimit të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2019	Shkalla e rrezikshmërisë sipas Planifikimit
1	Auditimi i Brendshëm Ad-Hoc në drejtoritë: Financa dhe Buxhet, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë. Realizimi i të hyrave vetanake Dhënia e vërtetimeve	Rrezik i Lartë
2	Auditimi i Brendshëm Ad-Hoc për përdorimin e automjeteve zyrtare	Rrezik i Lartë
3	Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë Komunale të Arsimit. Realizimi i të Hyrave dhe Shpenzimet	Rrezik i mesëm
4	Auditimi i Brendshëm Ad-Hoc në drejtoritë: Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Administratës së Përgjithshme Realizimi i të hyrave vetanake Dhënia e vërtetimeve	Rrezik i Lartë
5	Auditimi i brendshëm në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Realizimi i të Hyrave dhe Shpenzimet	Rrezik i mesëm
6	Auditimi i brendshëm në zyrën e Personelit, mirëmbajtja e dosjeve të personelit	Rrezik i mesëm
7	Është duke u audituar Drejtoria për Shërbime Publike, Komunale. Menaxhimi i projekteve Inkasimi dhe realizimi i të hyrave vetanake	Rrezik i mesëm

Vlerësimi përmbyllës:

Në këtë periudhë të gjashtëmujorit të vitit 2019, NJAB-ja ka arritur objektivat e planifikuara me Planin Vjetor, dhe ka arritur t'i kryej tre (3) auditime, një (1) është duke u audituar dhe kryhet në qershor, e që përfshihet në planin e gjashtëmujorit dhe tre (3) auditime ad-hoc (me kërkesë të Kryetarit) të cilat kanë pasur një fushëveprim mjaftë të gjerë dhe kompleks.

Në secilin auditim të kryer, pos të gjeturave menaxhmentit të drejtorisë së audituar i janë dhënë rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe sistemeve, duke u bërë në vazhdimësi përcjellja e zbatueshmërisë së atyre rekomandimeve. Pra, është arritur të krijohet një bashkëpunim produktiv në mes NJAB-së dhe menaxhmentit komunal.

Zyra për Informim

Gjatë kësaj periudhe, Zyra për Informim në komunën e Rahovecit, është angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të institucioneve komunale.

- Gjatë kësaj periudhe, Zyra për Informim, së bashku me zyrën ligjore dhe zyrtarë të tjerë ka përgatitur Planin Komunal të Veprimit për Transparencë (2019-2023), në përfundim të procedurave është edhe

Rregullorja Komunale për Transparencë dhe Strategjia Avokuese për komunikim që është duke u përgatitur me OJQ “Syri i Vizionit”.

- Zyra për Informim, ka njoftuar opinionin e gjerë më zhvillimet aktuale përmes Webfaqes zyrtare <https://kk.rks-gov.net/rahovec/> në të cilën janë postuar lajmet ditore, ndërsa njoftimet, shpalljet e konkurset e ndryshme të institucioneve komunale të Rahovecit, janë bërë publike në bashkëpunim me zyrtarin e IT-së.
- Zyra për Informim është kujdesur për shkrimet e botuara në gazeta dhe agjensitë e lajmeve të cilat kanë pasur të bënin me komunën e Rahovecit.
- Zyra për Informim, ka përcjell gjashtë mbledhje të Kuvendit Komunal dhe KPF-së, njoftimet dhe lajmet u janë përcjellë me kohë gazetarëve.
- Zyra për informim ka përcjellë edhe 4 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe 3 mbledhje të Komitetit për Komunitete, njoftimet dhe lajmet u janë përcjellë me kohë gazetarëve.
- Është bërë plotësimi i dokumenteve dhe dhënia e komenteve, në dokumentet e pranuar nga OJQ-të të ndryshme të cilat kohë pas kohe, kanë publikuar raporte lidhur me transparencën e llogaridhënie për komunën e Rahovecit.
- Gjatë kësaj periudhe janë publikuar 162 lajme, 74 njoftime - ftesa, 164 vendime të nënshkruara nga kryetari të gjitha këto vendime në fund të çdo muaji janë dërguar te zyrtari përkatës për pranimin e vendimeve në MAPL.
- Gjatë gjithë kohës në Webfaqen zyrtare të komunës, janë publikuar dokumente që kanë për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies komunale siç janë: Raporti i Zyres Kombëtare të Auditimit, raporti financiar për vitin 2018 dhe raporti 3 mujor financiar për vitin 2019.
- Janë publikuar edhe publikimet e OJQ-ve të ndryshme që kanë të bëjnë me transparencë dhe llogaridhënie, është bërë edhe publikimi i Memorandumeve të Bashkëpunimit të nënshkruara nga kryetari me Ministri apo edhe me OJQ të ndryshme, poashtu, janë publikuar edhe kontratat e nënshkruara nga kryetari për mbështetje të OJQ-ve që veprojnë në komunën e Rahovecit.

Zyra për Komunitete dhe Kthim - ZKK

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, ZKK ka kryer rregullisht punët e saj në fushëveprimin që i takon:

- Të drejtat e komuniteteve dhe qasja e shërbimeve.
- Kthimi i personave të zhvendosur.
- Regjistrimi i personave të riatdhesuar.
- Aktivitete të ndryshme.

Aktivitete

- Në periudhën 3 mujore (Janar –Mars 2019) janë realizuar 10 takime me Kryetarin e Komunës, me qëllim të koordinimit , informimit , raportimit dhe bashkëpunimit konstruktiv mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë në komunën e Rahovecit .
- Është themeluar Komisioni Komunal për Kthim (për personat e zhvendosur nga rajoni dhe brenda teritorit të Kosovës).
- Është themeluar Komisioni Komunal Veprues për draftimin dhe implementimin e Planit të Veprimit për komunitetin Rom dhe Ashkali, bazuar në Strategjinë për përfshirjen e tyre, 2017-2021.
- Me qëllim të integritetit dhe bashkëpunimit më të mirë në mes të zyrtarëve të zyrës për komunitete dhe kthim nga fshati Hoçë e Madhe, zyrtarët e kësaj zyreje janë transferuar në ndërtesën e Komunës në Rahovec, 2 herë në javë.
- Janë hartuar mbi 12 kërkesa për ndërtim të shtëpive, ndihma emergjente, ndihma ushqimore, ndihma në medikamente dhe pajisje shëndetësore etj.

- Në kuadër të Programit RRK5 të mbështetur nga BE-ja, bazuar në kriteret sipas rregullores, janë procesuar 4 raste në komisionin për kthim për familjet serbe, për ndërtimin e shtëpive në fshatin Hoçë e Madhe.
- Është verifikuar gjendja që ka të bëjë me infrastrukturën në fshatin Xërxë (kubëzimi i rrugës), fshati Krushë e Madhe (ndriçimi publik, përkufizimi i parcelës së varrezave dhe rrethimi i tyre), Lagjja e Epërme në Rahovec (ndriçimi publik).
- ZKKK si partner kryesor i IOM-it, ka pranuar 8 aplikacione për mbështetje me pajisje (vegla & gjësende pune), me vlerë prej 4000.00€ për Start UP dhe zgjerimin e bizneseve aktuale, që nxisin punësimin e komuniteteve jo shumicë.
- Janë aprovuar 5 raste për kthim serbëve në komisionin për kthim të qëndrueshëm, në nivel Lokal dhe Qendror, si dhe janë nënshkruar kontratat për ndërtim të shtëpive.
- Janë asistuar në hartim 20 kërkesa për çështje sociale, asistencë sociale dhe ndërtim të shtëpive për pjesëtarët serbë, boshnjakë, romë, ashkali dhe egjiptianë.
- Janë procesuar 2 kërkesa në Ministri për Komunitete dhe Kthim dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për asfaltimin e rrugës që shpie në Manastirin e Zoqishtit dhe vendosjen e kamerave të sigurisë në shkollën fillore të fshatit Hoçë e Madhe.
- Në bashkëpunim me UNHCR, është duke u punuar në Draftimin e Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme.

Njësia e Personelit

Ju prezantojmë raportin gjashtëmuor të punës për periudhën Janar – Qershor të vitit 2019 të Njesisë së Personelit.

Rekrutimet

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur shtatëmbëdhjetë (17) konkurse publike. Në shërbimin civil 9 konkurse–rekrutime të personelit dhe 8 konkurse publike për angazhim të stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, si në vijim:

Rekrutimet në shërbimin civil:

- Është shpallur konkurs publik i brendshëm - Avancim, më datë 20.02.2019 për pozitën: Udhëheqës i sektorit për arsim pranë Drejtorisë për Arsim
- Është shpallur konkurs publik i jashtëm më datë 8.03.2019 (për herë të parë) për pozitën: Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët pranë Drejtorisë për Arsim, i cili ka dështuar ngase nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të aplikacioneve.
- Është shpallur konkurs publik i jashtëm më datë 3.04.2019 (për herë të dytë) për pozitën: Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët pranë Drejtorisë për Arsim.
- Është shpallur konkurs publik i jashtëm më datë 7.03.2019 për pozitën: Arkëtar pranë drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- Është shpallur konkurs publik i jashtëm më datë 23.05.2019 (për herën e parë) për pozitën: Zyrtar për Lektorim pranë Zyrës së Kryetarit të komunës, i cili ka dështuar ngase nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të aplikacioneve.
- Është shpallur konkurs publik i jashtëm më datë 15.05.2019 për pozitën: Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë pranë Drejtorisë për Arsim, i cili ka dështuar ngase nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të aplikacioneve.
- Është shpallur konkurs i jashtëm më datë 15.05.2019 për pozitën: Zyrtar për mirëqenie sociale
- (4) pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, i cili ka dështuar ngase nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të aplikacioneve.

- Është shpallur konkursi publik i jashtëm (për herë të dytë) më datë 14.06.2019 për pozitën: Zyrtar për Lektorim pranë Zyrës së Kryetarit të komunës.
- Është shpallur konkurs i jashtëm më datë 14.06.2019 për pozitën: Asistent administrativ 3 pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës.

Konkurset publike me marrëveshje për shërbimet e veçanta

Janë shpallur 8 konkurse publike për angazhimin e 10 punëtorëve me Marrëveshje për shërbimet e veçanta, si në vijim:

- Konkursi nr.56/2019 për Drejtorinë për Administratë-pastrues
- Konkursi nr.55/2019 për Drejtorinë për Administratë-roje
- Konkursi nr.56/2019 për Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale-roje
- Konkursi nr.57/2019 për Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale-pastrues
- Konkursi nr.43/2019 për DBPZHR-Zyrtar për pagesa direkte
- Konkursi nr.44/2019 për DBPZHR-Zyrtar për pagesa direkte
- Konkursi nr.1747/2019 për DBF-Zyrtar për buxhet dhe financa
- Konkursi nr.1887/2019 për 4 pozita.

Pushimet vjetore

Deri më datë 30.06.2019 janë shfrytëzuar ditët e mbetura të pushimit vjetor 2018 dhe punëtorët kanë filluar që t'i shfrytëzojnë ditët nga pushimi vjetor i vitit 2019.

Lëshimi i akteve administrative

Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 105 shkresa administrative si në vijim: vërtetime, vendime, draft-vendime, propozime, aktemërime, informata, kontrata pune, përgjigjet në ankesa, rekomandime, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera, si dhe ka dërguar mbi 100 e-maila zyrtar.

Tabelat statistikore

Të dhënat statistikore të personelit Njësia e Personelit tani i procedon drejtpërdrejtë në programin elektronik SIMBNJ sipas kërkesës së MAP/DASHC-së, që bëhet rregullisht.

Njësia e personelit, të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e këtyre dy sektorëve.

Administrata komunale ka gjithsej 160 pozita, pa sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, prej këtyre të plotësuara janë 148, ndërsa 12 pozita janë të lira (11 pozita janë të shërbyesve civil).

Vlerësimi i punës provuese

Gjatë kësaj periudhe kohore (Janar- Qershor 2019) nuk ka pasur vlerësim të punës provuese.

Vijueshmëria e punëtorëve në punë

Funksionon Sistemi i Mbikëqyrjes së Vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP, janë lëshuar kartela të reja të SMVP-së për të gjithë punëtorët.

Rekomandohet drejtorët e drejtorive që të kërkojnë nga punëtorët e tyre që të respektohen udhëzimet e përdorimit të SMVP-së në të ardhmen.

Transferimet e punëtorëve/Avancimet /Ndryshimet në pozitë

Gjatë kësaj periudhe ka pasur një transferim të brendshëm të një punëtori nga Drejtoria për Arsim në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Gjithashtu, ka pasur një avancim brenda Drejtorisë për Arsim, duke respektuar procedurat ligjore të shërbimit civil – avancimet ku një Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë është avancuar në pozitën: Udhëheqës i sektorit për arsim.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës

Gjatë kësaj periudhe pesë (5) punëtorëve i'u ka pushuar marrëdhënia e punës, (4 të pensionuar dhe 1 i vdekur).

Trajnimet e nëpunësve civil

Deri tash kanë ndjekur trajnim 8 nëpunës civil.

Është hartuar plani i trajnimit të nëpunësve civil të komunës për vitin 2019 dhe është dërguar në DASHC/MAP.

Vendimet nga KPMSHCK-së

Nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës nuk kemi asnjë vendim.

Të dhënat nga komisionet e shërbimit civil të administratës komunale

Komisioni Disiplinor

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur vetëm dy raste për ndjekje disiplinore.

Komisioni Disiplinor në një rast ka shqyrtuar lëndën disiplinore dhe ka konstatuar shkelje të rëndë disiplinore dhe ka shqiptuar masën disiplinore ndërprerje të marrëdhënies së punës, rasti tjetër është në shqyrtim.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur pesë ankesa.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka aprovuar pjesërisht dy (2) ankesa

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka refuzuar si të pabaza tri (3) ankesa

Njësia e personelit i kryen punët e sekretarisë për Komisionin Disiplinor dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke i lëshuar shkresat administrative, përveç vendimeve të cilat nuk ka të drejtë.

Menaxhimi i burimeve njerëzore sipas programit “ SIMBNJ”.

Është krijuar moduli i ri në programin SIMBNJ dhe nga ky fund vit do të krijohet në mënyrë elektronike Plani Individual i Personelit të institucionit punëdhënës-komunës së Rahovecit.

Në vazhdimësi njësia e personelit menaxhon me këtë program duke e populluar dhe freskuar me të dhëna këtë program sipas kërkesave që parashtrohet MAP-i.

Ky program është i dizajnuar për menaxhimin elektronik të burimeve njerëzore dhe ka hyrë si prioritet i reformës së administratës shtetërore të Qeverisë së Kosovës.

Plani individual i personelit

Njësia e personelit ka hartuar draftPlanin Individual të Personelit të komunës së Rahovecit për vitin 2019 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit SIMBNJ.

Pas miratimit të ligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2019 nga Kuvendi i Kosovës, draft Plani Individual i Personelit të komunës së Rahovecit do të azhurnohet me limitet e miratuar me ligjin e buxhetit të Kosovës dhe do të APROVOHET, përfundimisht.

Asnjë punësim në shërbimin civil nuk mund të realizohet nëse pozitat nuk janë të përfshira në Planin Individual të Personelit.

Administrimi i programeve elektronike

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si në vijim:

- Menaxhon me programin elektronik SIMBNJ që dmth. Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punët të punëtorëve, pra programin SMVP.
- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED që në nivel shtetëror është kompetent ASHI- Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.
- Monitoron me programin elektronik PYROLL, pra programit të listave, pagave dhe pagesave të komunës.

Zyra për Përfaqësim Ligjor

- Përfaqësimi i Komunës, drejtorive dhe entiteteve të tjera komunale pranë organeve gjyqësore, zyrave përmbarimore, ndërmjetësuese si dhe organeve administrative;
- Hartimi i parashtresave ligjore, marrëveshjeve dhe ndonjë dokumenti tjetër që kërkohet në lidhje me përfaqësimin gjyqësor që përfshinë Komunën e Rahovecit;
- Përfaqësimi i Komunës dhe organet e tjera që janë pjesë e Komunës së Rahovecit në ndërmjetësim si dhe procedura të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve alternative, brenda limitit të autoritetit të deleguar;
- Përgatitja e këshillave ligjore, udhëzimeve dhe opinioneve brenda fushëveprimit të Komunës;
- Përcjellja, shqyrtimi dhe analizimi i dispozitave ligjore në lidhje me përfaqësimin gjyqësor me qëllim të organizimit të mbarëvajtjes së procedurave në interes të autoriteteve komunale;
- Bashkëpunimi me të gjitha palët që janë subjekt në procedurë gjatë procesit të përfaqësimit gjyqësorë;
- Sigurimi i provave materiale dhe materialeve të tjera relevante për vendosje të çështjeve të ndryshme, nga drejtoritë dhe njësitë komunale;
- Kryen edhe punë të tjera sipas përshkrimit të vendit të punës të Përfaqësuesit Ligjor.

Zyra për Përfaqësim Ligjor mbanë gjashtë (6) regjistra në të cilat regjistrohen lëndë sipas procedurave që zhvillohen nëpër gjykata të ndryshme.

Lëndë në procedurën civile (Regjistri “C”)

Në këtë Regjister regjistrohen të gjitha lëndët e kontesteve civile në të cilat Komuna është paditëse apo e paditur. Lëndët nga ky Regjister janë shtylla kryesore e punës së Zyrës për Përfaqësim Ligjor, ndaj në vazhdim do të paraqesim të gjitha të dhënat në lidhje me këto lëndë.

Sipas regjistrimit të lëndëve civile, Komuna është paditëse në 13 lëndë, ndërsa Komuna është e paditur në 788 lëndë. Sipas regjistrimit C, lënda më e vjetër aktive është e datës 04.01.1982

Nr.	Llojet e padive/kontestet, regjistri "C"	Nr. i lëndëve	Vera Kontestuese
1	Kompensim demi	230	31,871,824.79 €
2	Vërtetim i pronësisë	323	419,386.74 €
3	Kompensim i pagave pas pensionimit	38	142,083.59 €
4	Kontest pune	19	60,836.70 €
5	Anulim i kontratës për falje	84	55,850.00 €
6	Kompensim i paluajtshmërisë	29	46,452.00 €
7	Anulim i kontratës për ndërrim	22	30,627.96 €
8	Pasurim i pabazë	8	30,396.74 €
9	Borxh	10	23,684.70 €
10	Kompensim dëmi në bazë të ndërtimit	1	20,000.00 €
11	Dorëzim i paluajtshmërisë	12	13,750.00 €
12	Vërtetim i pronësisë në bazë të ndërtimit	3	10,100.00 €
13	Vërtetim i pronësisë në bazë të parashkrimit fitues	2	8,400.00 €
14	Anulim i Aktvendimit	5	4,561.00 €
15	Anulim i kontratës për shitblerje	1	1,000.00 €
16	Zgjidhja e kontratës	1	1,000.00 €
17	Kthimi i mjeteve nga kontrate nule	1	820.00 €
18	Vërtetim i servitutit	2	500.00 €
19	Pengim posedimi	3	300.00 €
20	Uzurpim i paluajtshmërisë	3	200.00 €
21	Kthimi i pasurisë	1	100.00 €
22	Anulim i kontratës për banesë	2	50.00 €
23	Mos përmbushja e obligimit	1	- €
24	Lirimi i banesës	2	- €
25	Vërtetim i pronësisë në bazë të mbajtjes	1	- €
		804	32,741,924.22 €

Nga 212 lëndë për kompensimin e dëmit, të ngritura nga qytetarët serbë të Komunës së Rahovecit, vlera e përgjithshme e kontesteve arrin në 31,031,277.00 EUR. Në këto lëndë e paditur është 1. Komuna e Rahovecit, 2. Qeveria e Përkohshme e Kosovës, 3. UNMIK-u dhe 4. KFOR-i. Mbështetur në disa aktgjykime që ka pranuar Avokatura Komunale, pritet që të gjitha këto lëndë në shkallë të parë të refuzohen në tërësi si të pabazuara. Avokatura Komunale do të bëjë përpjekje në bashkëpunim me gjykatën kompetente për të pastruar regjistrin nga këto lëndë deri në fund të vitit 2019.

Paditë e kompensimit të pagave pas pensionimit me bazë ligjore "Marrëveshjet dhe Kontratat Kolektive", të paditësve-punëtorëve të pensionuar kanë ndikuar në shtimin e vlerës së përgjithshme të kontesteve civile.

Gjatë periudhës raportuese, në kontestet civile janë kryer gjithsej 19 lëndë, prej tyre: 7 (shtatë) padi të tërhequra (kryesisht për shkak të mosardhjes në seancë të paditësve); kontestet e fituara 3 (tre); kontestet e humbura 3 (tre); Marrëveshje gjyqësore 1 (një), etj.

Regjistrat:

- Regjistri për lëndë (procedure) civile "C";
- Regjistri për lëndë (procedurë) përmbartimore "P";
- Regjistri për lëndë (procedurë) administrative dhe konfliktet administrative "KA";
- Regjistri për lëndë (procedurë) të ndryshme "CN";
- Regjistri për lëndë (procedurë) at-hezionit "PA" dhe
- Regjistri për lëndë të brendshme administrative "ZPL".

Pasqyra tabelare (si më poshtë) për të gjithë Regjistrat, paraqet lëndë në punë, të pranuar, të kryera, të pakryera dhe lëndë të mbetura si dhe pasqyra për aktivitetet e ndërmarra.

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE - PERIUDHA RAPORTUESE									
	Sipas regjistrave të ZPL	Civile	Përmbartimore	Konflikte Administrative	CN Ndryshme	Proc.At_ hezionit	Gjohat Mandatore	Avokatura	Gjithsej punë të kryera:
1	Lëndë të pa zgjidhura-të bartura	796	41	5	27	9	0	4	882
2	Lëndë të pranuar	24	13	1	1	2	0	11	52
3	Të gjitha lëndë në punë	820	53	6	28	11	0	15	933
4	Lëndë të zgjidhura	19	2	0	0	5	0	5	31
5	Lëndë të mbetura	801	51	6	28	7	0	8	901

Lëndë në procedurën përmbartimore (Regjistri “P”)

Komuna në këtë regjister paraqitet kreditore në 16 lëndë, ndërsa debitorë në 22 lëndë. Vlera e borxhit në lëndë të cilat është debitorë, është rreth 165.053,74 €.

Lëndë në procedurën/konfliktet administrative (Regjistri “KA”)

Regjistrohen lëndë nga procedura gjyqësore pranë Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti Administrativ në bazë të padive për konfliktet administrative dhe çështjet e tjera administrative.]

Lëndë në procedurën jashtëkontestimore (Regjistri “CN”)

Regjistrohen Vendimet për bartje administrative, bartjen e të drejtës së shfrytëzimit, konstituimi i së drejtës së servitutit, etj.

Regjistri përmban lëndë të ndryshme jashtëkontestimore dhe atë: propozime për caktimin e kompensimit real për paluajtëshmëritë e ekspropriuara; fletëparaqitje për uzurpime arbitrare të pronës shoqërore; propozime për rregullimin e mexheve; propozime për arritjen e marrëveshjeve në procedurën jashtëkontestimore, etj.

Lëndë në procedurën e at-hezionit/penale (Regjistri “PA”)

Lëndë në të cilat Zyra për Përfaqësime Ligjore, për Komunën apo organet e saj, ushtron kërkesë pronëso- juridike në procedurën penale. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur kërkesa të kësaj procedure. Në periudhën raportuese janë referuar nga Gjykata Penale dy raste në të cilat Komuna paraqitet në cilësinë e palës së dëmtuar përmes kryerjes së veprës penale të të pandehurit.

Lëndë nga procedura e brendshme administrative (Regjistri “ZPL”)

Raportet, Planet dhe Programet e Punës, Mendime Juridike, Këshillat, Kërkesat për pajisje të zyres, material shpenzues etj., të gjitha ato lëndë që nuk kanë të bëjnë me procedurën gjyqësore.

Seancat e caktuara nga kontestet civile nga gjykatat për periudhën raportuese

Për të gjitha lëndë aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

Seancat gjatë vitit 2019	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Nr. i seancave të mbajtura	14	8	16	16	10	6							70

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, në bazë të kompetencave ka bërë ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet e tjera komunale dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Rahovecit, në kuadër të kompetencave të veta apo të deleguara ligjore të saj.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme ka arritur ta implementojë me sukses konceptin e vizionit dhe misionit të saj të menaxhimit, që nënkupton:

- Shërbimet t'ia ofrojë sa më afër qytetarit dhe
- Shërbimet të jenë cilësore e të shpejta

Brenda drejtorisë për Administratë të Përgjithshme funksionojnë këta sektorë:

- Sektori i Gjendjes Civile,
- Sektori për punë të përbashkëta
- Njësia për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe integritet evropiane.

Sektori i gjendjes civile

Sektori për gjendje civile në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 ka realizuar punët bazuar në ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative mbi dokumentet dhe lëshimin e dokumenteve zyrtare. SGJC ka bërë regjistrimet e ndryshme, përfshirë regjistrime të lindjeve, vdekjeve, martesave, etj

- Shërbimet e gjendjes civile, të cilat përshijnë rregullimin juridiko-ligjor të statusit personal dhe familjar të qytetarëve të komunës së Rahovecit, në kuadër të kompetencave të deleguara;
- Lëshimin e certifikatave që dëshmojnë statusin e gjendjes civile për qytetarët, duke përfshirë edhe certifikatat e vendbanimit dhe të ndërrimit të emrit personal si dhe procedurat e lirimit nga shtetësia si kompetencë e deleguar inicuese për ministritë përkatëse.
- Vërtetimin e origjinalitetit të dokumenteve të ndryshme si dhe deklarata, vërtetime dhe parashtesa të tjera, për nevojat e qytetarëve, duke u bazuar gjithmonë në dispozitat ligjore gjatë lëshimit të tyre.

Sektori i teknologjisë informative

Sektori i Teknologjisë Informative ka vazhduar me zbatimin e planifikimit vjetor të punëve si dhe punëve të përditshme siç janë: monitorimi i rrjetit, sistemeve, përkrahja e zyrtarëve etj.

- Në fillim të vitit janë testuar dhe sanuar disa kablllo të rrjetit ndërmjet pikave ndërlidhëse të rrjetit, kemi bërë pastrimin e rregullt të serverëve dhe pajisjeve tjera në Server Room.
- Poashtu, në muajin Janar kemi pasur një problem me sistemin e Intranetit ku i kemi referuar MAPL-së dhe kompanisë Cactus.
- Në aazhdimësi kemi pasur kërkesa për përkrahje nga stafi komunal, shkollave, zyrat e gjendjes civile dhe shëndetësia.
- Kemi bërë përditësimin e aplikacioneve, përkrahje në përditësimin e llogarive të zyrtarëve etj...

- Është bërë bartja e incizimeve të mbledhjeve nga kompjuteri i sallës së kuvendit tek NAS (Network Area Storage).
- Janë bërë instalime të reja të sistemit operativ dhe paketës MS Office në shumicën e kompjuterëve, janë blerë edhe kompjuterë të rinj që është dashur të konfigurohen dhe të futen në domenin qeveritar.
- Me kërkesë të disa drejtorëve dhe zyrës së prokurimit jemi marrë me përgatitjen e disa specifikacioneve për teknologji informative, E-kioskut etj.
- Kemi përkrahur vazhdimisht takimet e mbajtura në sallën e kuvendit, ruajtjen e incizimeve, transmetimin e mbledhjeve në ueb-faqe.
- Me kërkesë nga drejtori i drejtorisë për bujqësi kemi përgatitur dy lokacione për aplikim për subvencione në bujqësi, në Ratkoc dhe Krushë të Madhe.

Sektori për punë të Kuvendit dhe komiteteve

- Ndërmarrje e të gjitha masave të nevojshme për organizimin më të mirë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, përgatitja e materiale të nevojshme, dërgimi i ftesave dhe çështje të tjera rreth organizimit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal.
- Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës (6 mbledhje) të Kuvendit Komunal.
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.
- Dërgimi i të gjitha akteve në MAPL, sipas kërkesës së tyre.
- Përpilimi dhe lekturimi profesional të materialeve literare në gjuhët zyrtare në Komunën e Rahovecit.
- Pranimin dhe procedimin e materialeve dhe shpërndarjen e materialeve për anëtarët e asamblesë komunale nga zyrat e gjendjes civile të komunës së Rahovecit.
- Ka bërë propozimet (hartimet) e projekteve rregulloreve dhe propozimvendimeve të përgjithshme administrative, si dhe propozime për ndryshimin dhe plotësimin e akteve të përgjithshme nënligjore në fuqi (në juridiksionin komunal).

Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve

Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve, brenda kompetencave ka kryer punët rutinore pa ndonjë specifikë, ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbrim etj.).

Kemi menaxhuar me racionalitet të plotë dhe të domosdoshëm me fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësore e të cilave është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar në permanencë mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servisimin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate etj.

Njësia komunale për të drejtat e njeriut

Duke u bazuar në objektivat që i ka të planifikuara njësia komunale për të drejtat e njeriut për realizim të aktiviteteve gjatë gjithë vitit, NJKDNJ në gjashtëmujorshin e parë të këtij viti për zbatim, monitorim dhe raportim mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi promovimin dhe përhapjen e vlerave në fushën e të drejtave të njeriut, e në veçanti të gruas si dhe fuqizimi, integrimi i saj në jetën shoqërore. Poashtu, bashkëpunimi për formimin e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, me të gjitha institucione dhe me OJQ-të si dhe me organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare, ku janë kryer edhe këto aktivitete:

Aktivitetet

- Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punët nga NJKDNJ,
- Kërkes zyrës Ligjore për Hartimin e Rregullores për të drejtat e fëmijëve dhe formimit të Komitetit Konsultativ për personat me nevojat të veçanta,
- Është hartuar Rregullorja për të drejtat e fëmijëve, e cila ka kaluar në Kuvend,
- Është formuar Këshilli Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta,
- Ditët e hapura, zyrtari i Avokatit të Popullit me qytetarët kanë mbajtur gjithsej 4 takime, ku janë shqyrtuar 2 ankesa.
- Në bashkëpunim me zyrtarin e Avokatit të Popullit janë mbajtur dy ligjërata me nxënës të shkollave „Bekim Sylka dhe „Gëzim Hamza “ në Rahovec me temën: „Të drejtat e fëmijëve dhe ndëshkimet trupore me mësimdhënës”,
- Me ndihmën e psikologëve të OJQ „Medika Kosova” dhe “Medika Gjakova” kemi trajtuar 3 raste të dhunës seksuale gjatë luftës të cilat jemi duke i ndihmuar për aplikim për pensionet që ju takojnë,
- Në bashkëpunim me OJQ „Rrjeti Qeliza” janë mbajtur ligjërata „Trafikimi me qenie njerëzore “ në tri shkolla të mesme të Komunës së Rahovecit, ku pas përfundimit të ligjëratës, nga donatorët kemi ndihmuar dy vajza të trafikuar me makinë për qepje, e që emrat e viktimave i kemi marrë një në polici dhe një në Qendrën për Punë Sociale.

Riatdhesimi

- Gjithsej 13 persona të riatdhesuar janë regjistruar dhe kanë hyrë në sistem për të kërkuar ndihmë. Vlen të thuhet, se të gjithë personat dhe familjet e lajmëruar në zyrën tonë, janë pritur dhe janë informuar në detaje lidhur me procesin e riatdhesimit dhe mënyrën e përfitimit.
- Për këtë periudhë ka përfunduar ndërtimi i një shtëpie 75 m2 ku është strehuar një familje rome 9 anëtarësh, është duke u ndërtuar shtëpia e të riatdhesuarit .
- Kemi ndihmuar 29 personat të riatdhesuar në përgatitjet e planeve të biznesit në IADK. në vlerë 2000€ me participim 10%.

Zyra për integritet evropiane

Zyra për Integritet Evropiane ka kryer funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011, për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integritet evropiane, në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integritet Evropiane

Aktivitetet

- Mbikëqyrja e aktivitetetve të drejtorive që burojnë nga PKZMSA-ja, si dhe dokumentet e tjera strategjike të MAPL-së dhe Qeverisë së Kosovës.
- Obligimet e komunave që dalin nga Agjenda Evropiane, duke u bazuar në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit.
- Në programin e IADK-së, janë dorëzuar tridhjet e tetë (38) aplikacione për Personat të Riatdhesuar për Grante.
- Pjesëmarrje në Grupin Punues për Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Rahovecit për periudhën 2019/2021.
- Pranimi i kërkesave dhe përgatitja e lëndëve të personave të riatdhesuar për akomodim, planbiznese dhe rindërtim.
- Futja e të dhënave në SMR-në.

Barazia gjinore

Edhe pse në Komunën tonë sfidë mbetet implementimi i Ligjit për Barazi Gjinore dhe arritja e barazisë gjinore, prapëseprapë, fal mbështetjes komunale, organizatave të ndryshme ndërkombëtare si dhe angazhimit të përbashkët të të gjithë akterëve por edhe i ZBGJ-së, kemi arritur të realizojmë një pjesë të madhe të aktiviteteve të parapara për këtë periudhë gjashtëmujore dhe njëherit të bazuara në Planin Vjetor të Punës për arritjen e Barazisë Gjinore.

Aktivitetet e përmbushura nga Plani Vjetor i Punës

- Në bashkëpunim me grupin joformal të grave kemi shënuar aktivitete të ndryshme me rastin e shënimit të festës së Gruas, 8 Marsit.
- Dorëzime të statistikave gjinore në Komunën e Rahovecit ku është mbajtur evidencë rreth statistikave gjinore, si në administratën komunale, shëndetësi, arsim dhe gjithsej për banorët e Komunës, në baza etnie dhe gjinore.
- Mbajtja e tryezës me gra asambleiste dhe OJQ-të e Komunës së Rahovecit për kërkesat buxhetore për vitin 2019.
- Takimi i organizuar tek OJQ “Hareja” për projektin e parandalimit të sëmundjeve ngjitëse te moshat e hershme rinore.
- Takim me punë për buxhetimin gjinor i organizuar nga OSBE-ja.
- Përgatitja e lëndëve për personat e riatdhesuar.

Drejtorja e Administratës ka kryer edhe punë të tjera administrative të cilat janë deleguar nga organet qendrore të pushtetit të Republikës së Kosovës si dhe punë të tjera administrative të autorizuara dhe të urdhëruara nga Kryetari Komunës si:

- Rregullimi i sportelit për mërgimtarë.
- Ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për mërgatën që t’i ofrojnë informata dhe këshilla më të efektshme.
- Lehtësimin i procedurave për marrjen e dokumenteve dhe shërbimeve të tjera të nevojshme në kohën e pushimeve për mërgatën.
- Zgjatja e orarit të punës nga Zyra e Gjendjes Civile për Muajin e Mërgimtarëve.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për muajin e mërgimtarëve, ku shumë shpejtë publikohet agjenda për muajin e mërgatës 2019.

DREJTORIA PËR FINANCË DHE BUXHET

Ky raport përfshinë të dhënat për periudhën Janar- Qershor 2019 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, konkretisht nga sektori për Buxhet & Financave dhe Sektori i Tatimit në Pronë

Sektori i Buxhetit dhe Financave

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe përgjegjësitë, ne si drejtori kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.

Në drejtorin e financave kemi arritur që detyrat të kryhen në afate ligjore dhe çdo e hyre dhe shpenzim të evidentohet dhe të dihet burimi apo shpenzimi.

Gjatë kësaj periudhe të punës kemi mbajtur disa takime me MF, me AKK dhe organizata të ndryshme apo donator që kryesisht janë trajtuar qështje financiare.

Tek Shpenzimet Operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime pa e dëmtuar procesin e punës, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga kapitalet e realisht kanë qene M & Shërbime, siç janë mirëmbajtja e ndërtesave dhe mirëmbajtja e rrugëve.

Detyrat tone si drejtori duke respektuar edhe afate ligjore të rregulluara më ligjet që rregullojnë financat publike.

Sipas muajve për gjatë vitit 2019 kemi realizuar këto detyra:

- Përgatitja e Cash Planit për buxhetin e vitit 2019 - (Janar 2019),
- Përgatitja e raportit financiar për gjashtë mujorin 2019 për Kuvendin komunal dhe Ministrin e Financave - (Janar -Qershor 2019)
- Raport, (informatë) për shpenzimet dhe të hyrat për tremujorin e parë 2019
- Prezantimi i KAB 2020-2022 në kuvend.
- Prezantimi i raportit të auditorit kombëtar për pasqyrat financiare 2018,në kuvend

Komuna e Rahovecit për vitin 2019 operon me një buxhet prej: 13,760,891.00 euro të përberë nga Grandi qeveritar dhe të hyrat vetanake:

Grandi i qeveritar	12,423,508.00 €
Të hyrat vetanake	1,168,768.00 €
Huamarrja	168,615.00 €
Gjithsej	13,760,891.00 €

Shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike në vitin 2019 është siç vijon:

Paga e mëditje	7,537,669.00 €
Mallra dhe shërbime	1,514,330.00 €
Shpenzime komunal	255,500.00 €
Subvencione	250,001.00 €
Investime kapitale	4,203,391.00 €

Të hyrat e bartura nga viti 2018 në vitin 2019 janë 402,564.38 euro.

Shpenzimi i buxheti në vitin 2019

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë zotuar 1,643 lëndë dhe janë kryer 1,397 pagesa.

Nr.	Përshkrimi	Lëndët te certifikuara	Buxheti i aprovuar 2019	Buxheti alokuar	Shpenzimet	Shpenzim/Alokim
1	Paga dhe mëditje	0	7,559,595.01	3,670,089.38	3,648,163.38	99.40
2	Mallra dhe	1861	1,387,617.84	810,440.34	379,714.48	46.85
3	Shërbime Komunale	810	255,500.00	167,650.02	115,104.67	68.66
4	Subvencione	375	250,001.00	1,183,787.87	1,036,785.84	87.58
5	Investime Kapitale	281	4,652,993.91	4,156,670.19	2,251,894.48	54.18
	Totali	1394	15,105,707.76	9,988,637.80	7,431,662.85	74.40

Vërejte : 1 milion € Subvencione janë alokuar për dëmet në Bujqësi.

Të hyrat vetanake

Tatimi në pronë

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2019 sektori i tatimit në pronë ka realizuar të hyra prej 247,450.24 € apo 63.65 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 388,767.00) euro. Regjistrimet e reja janë 108 objekte, ose 18.193 m². Verifikimi i objekteve është 238, ose 37.657 m². Përqindja e realizimit të Tatimit në Pronë, në raport me planifikimin është 63.65 %, ndërsa në raport me vitin 2018 është 19.69 %.

Të hyrat në përgjithësi:

Të hyrat e përgjithshme vetanake të realizuara për këtë periudhë janë 605,607.74 euro apo 51.84% të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 1,168,767.00).

Përgatitja e buxheti për vitin 2019

Me 15.05.2019 kemi pranuar Qarkoren Buxhetore 2020/1 nga Ministria e Financave e cila paraqet bazën për hartimin e Buxhetit për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitet 2021 dhe 2022. Me këtë qarkore buxhetore janë ndare kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2019, ku Komunës së Rahovecit sipas kësaj Qarkoreje ju ka ndarë një buxhet prej 14,735,891.00€

Kemi përgatitur dhe kemi dërguar në Kuvend Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB për vitet 2020-2022 e cila pritet të aprovohet në Kuvend deri me 30.09.2018.

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2019 do të paraqesim sipas kategorive ekonomike që aktualisht janë funksionale:

Pagat dhe mëditje	7,559,595.01€;
Mallrat dhe Shërbim	1,387,617.84€;
Shpenzimet Komunale	255,500.00€;
Subvencionet dhe Transferet	250,001.00€;
Shpenzimet Kapitale	4,652,993.91€
TOTAL	13,760,891.00€

Sfidat për vitin 2019:

- Realizimi (inkasimi) i të hyrave vetanake gjatë vitit 2019,
- Përgatitja e buxhetit për vitin 2020
- Stafi jo i mjaftueshëm në sektorin e financave dhe tatimin në prone.
- Realizimi në përqindje me të lart të buxhetit.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Raporti gjashtëmuor i punës për vitin 2019 i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec, paraqet punën, zhvillimin dhe të arriturat kryesore të drejtorisë dhe stafit të saj. Përmes këtij raporti, DSHMS, paraqet detyrat dhe të arriturat drejt realizimit të planit të punës si dhe detyrat e tjera që dalin sipas detyrës zyrtare për të ofruar shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës së Rahovecit.

DSHMS-ja ka bashkëpunuar dhe mbështetur organizatat joqeveritare të cilat kanë qenë të gatshme për bashkëpunim, ku kemi pasur suksese në të gjitha fushat duke ndihmuar në realizimin e qëllimit të përbashkët para qytetarëve të komunës tonë.

Caktimi i prioriteteve të punës dhe përcjelljen e nevojave sociale, shërbimeve shëndetësore ka qenë punë e përditshme e DSHMS-së dhe stafit të saj.

Aktivitetet e DSHPS-së

- Konsultimet dhe takimet e rregullta me stafin, Drejtorin e QPS-së dhe të QKMF-së në Rahovec;
- Përpilimi i raporteve javore, mujore të punës për vitin 2019, dhe krijimi nevojës për raportim të vazhdueshëm;
- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHMS-së;
- Shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë ndaj kërkesave të ndryshme të qytetarëve, si dhe të atyre për ndihmë momentale-financiare;
- Ka vazhduar ofrimi i shërbimeve në QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, me dy ndërrime, të cilat tanimë janë të përhershme;
- Shënimi i përvjetorit të dhurimit të gjakut në Dejnë dhe Ratkoc, poashtu ka vazhduar dhurimi i gjakut edhe në Vrajkë, Dobidol dhe Krushë të Madhe, Kramovik, Sopniq etj;
- Në muajin mars 2019 është nënshkruar marrëveshja me CARITAS KOSOVA për ofrimin e shërbimeve mjekësore - programi "Home Care- Kujdesi Shtëpiak" për persona në nevojë, persona në regjim shtrati, ku janë angazhuar 48 punëtorë shëndetësor, dhe në bashkëpunim me DKA-në kemi angazhuar edhe 5 pedagogë dhe psikologë. Për dallim nga herat e tjera, kjo marrëveshje ka shkuar me procedurë të prokurimit, pas vërejtjeve të dhëna nga Auditori Gjeneral, pasi që më heret kjo marrëveshje është nënshkruar vetëm me negocim;
- Shërbimet në shëndetësi janë avancuar - kemi pranuar mjekë, stomatologë të ri, poashtu janë avancuar edhe shërbimet në fizioterapeuti, që më herët nuk kemi pasur shërbime të fizioterapeutike. Tash kemi fizioterapeut permanent në QKMF, e në të ardhmen shpresojmë që shërbimet e tilla të ofrojmë edhe në dy QMF-të, apo qendra më të mëdha, si në Ratkoc dhe Krushë të Madhe;
- Kemi avancuar me shërbime stomatologjike, kemi punësuar dy stomatologë të ri. Tash kemi stomatologë permanent në dy QMF-të, në Drenoc, dhe Fortesë, presim shumë shpejtë të angazhojmë stomatologë edhe në dy QMF të tjera, në Opterushë dhe Çifllak;
- Kemi subvencionuar OJQ-të, që merren me veprimtaritë sociale, si shoqatat: "Hareja", "Hendikos" dhe shumë shoqata të tjera;
- Presim shumë shpejtë që të hapet Reparti i Hemodializës në QKMF, gjë që ishte dhe është një sfidë e cila po tejkalohet. Reparti do të hapet në pjesën e dytë të vitit 2019 dhe pacientët me dializë do të kenë mundësi që shërbimet t'i marrin në repartin e Hemodializës në QKMF- Rahovec;
- Shërbimet diagnostike janë avancuar, kemi të angazhuar specialistin e biokimisë në laborator, poashtu, në radiologji kemi të angazhuar edhe specialistin e Radiologjisë (Radiolog).

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Ndërtimi i QKMF-së, faza e dytë dhe përfundimtare, projekti deri më tani është përfunduar 70%, besojmë që me ndihmën e qeverisë së Kosovës, brenda vitit do të përfundojmë objektin e QKMF-së dhe Emergjencës.
- Dezinsektimi, Dezinfektim dhe Derratizimi- DDD - jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik.
- Ndërtimi i QMF-së në Çifllak, është në procedurë prokurimi.
- Dixhitalizimi i Rentgenit - i paraparë në pjesën e dytë të vitit 2019.
- Renovimi i ndërtesës së QP-së – i përfunduar si projekt.

DREJTORIA PËR ARSIM

Drejtoria për Arsim në gjashtëmujoin e parë të vitit 2019 ka punuar në përputhje të plotë me planifikimet e bëra sipas planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë këtij gjashtëmuji. Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të përmbledhura sipas muajve, siç vijon:

Aktivitetet për periudhën (Janar - Mars 2019)

- Në fillim të muajit Janar është mbajtur takimi i parë i këtij viti kalendarik me drejtorët e shkollave. Pas këtij takimi, është themeluar dhe funksionalizuar Ekipi Profesional Monitorues dhe Vlerësues në kuadër të DKA-së dhe Aktivat Profesionale. Poashtu, gjatë muajit Janar, DKA ka nisur hartimin e projekteve të parapara të fillojnë në vitin 2019, siç janë projektet për ndërtimin e shkollave, projektet për ngrohjen qendrore në shkollat e komunës sonë, projektet në drenazhimin dhe hidroizolim të disa shkollave, etj.
- Është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunim ndërmjet DKA-së dhe Agjencisë për Zhvillim të Luksemburgut, që nëpërmjet projektit KSV/015 të krijohet Sistemi i Informimit për Orientim në Karrierë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme.
- Në datat 12, 13, 14 dhe 15 Shkurt, u mbajtën 4 debate me të gjithë mësimdhënësit e 4 fushave kurrikulare, në të cilat u finalizua harmonizimi i instrumenteve të vlerësimit të njohurive të nxënësve. Debatet u realizuara gjatë kësaj jave ishin ato me mësimdhënësit e këtyre fushave kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Edukata fizike, Sporti dhe Shëndeti, Shoqëria dhe Mjedisja dhe Matematika.
- Në datat 20, 21, dhe 22 Shkurt, u mbajtën 3 debate me të gjithë mësimdhënësit e 3 fushave kurrikulare, në të cilat u finalizua harmonizimi i instrumenteve të vlerësimit të njohurive të nxënësve. Debatet u realizuara gjatë kësaj jave ishin ato me mësimdhënësit e këtyre fushave kurrikulare: Shkencat e Natyrës, Jeta dhe Puna dhe fusha e Arteve.
- U mbajtën garat shkollore të olimpiadës matematike në secilën shkollë, ndërsa më 23 shkurt u organizua dhe u mbajt gara komunale e olimpiadës së matematikës, ku pjesëmarrës ishin nxënësit fitues të garave shkollore nga klasat e 9, 10, 11 dhe 12.
- Në muajin Mars, janë mbajtur aktivitete dhe manifestime të ndryshme të organizuara nga DKA për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit.
- Janë përgatitur paramasat për projektet e ngrohjes qendrore në 3 shkolla dhe paramasat për drenazhimin dhe hidroizolim të 2 shkollave.
- Është hapur tenderi për projektin e ndërtimit të Shfmu “Liria” në Fortesë, tenderi për ngrohje qendrore në 3 shkolla dhe tenderi për drenazhimin dhe hidroizolim të 2 shkollave.
- Ekipi i psikologëve dhe pedagogëve filloi me vizitat njoftuese në disa shkolla të komunës.

Aktivitetet për periudhën (Prill- Qershor 2019)

- Në muajin Prill, janë përgatitur skicat për projektet e ngrohjes qendrore në 3 shkolla, për të cilat është nxjerrë urdhëresa për shpalljen e tenderit .
- Janë përgatitur dhe janë dërguar në zyrën e prokurimit skicat për projektet e drenazhimit dhe hidroizolimit në 2 shkolla, për të cilat është nxjerrë urdhëresa për hapjen e tenderit, ku së shpejti do të lidhet kontrata.
- Drejtoria së bashku me Qendrën Rinore SHL-Kosova kanë organizuar dhe mbajtur sesionin informues me maturantët, këshillat e nxënësve, mësimdhënësit e fushës kurrikulare Jeta dhe Puna për orientimin në karrierë.
- Nëpër shkolla kanë filluar të mbahen garat shkollore ndërmjet nxënësve, të cilat janë përgatitje për fillimin e mbajtjes së garave komunale lëndore.

- Është përgatitur projekti për ndërtimin e objektit të shkollës “Liria” në Fortesë, për të cilin është nxjerrë urdhëresa për hapjen e tenderit. Jemi në pritje të përfundimit të procedurave.
- Nëpër shkolla kanë vazhduar të mbahen garat shkollore ndërmjet nxënësve, të cilat janë përgatitje për fillimin e mbajtjes së garave komunale dhe garave të tjera që ka organizuar Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Hartimi i detyrave projektuese për 2 çerdhe të reja, ku tashmë jemi afër për të filluar me procedura të prokurimit.
- U mbajt një aktivitet pastrimi me nxënës për nder të Ditës së Tokës dhe poashtu u mbajtën 2 orë letrare me nxënës për të shënuar ditën e librit.
- Në muajin Maj, janë mbajtur garat komunale me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme për kreativitet dhe mendim kritik.
- Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik janë marrë 4 projektet e dizajnuara për zbatimin e masave të efijencës së energjisë.
- Është mbajtur mbledhje me të gjithë drejtorët e shkollave për t’u mobilizuar në organizimin testimit të nxënësve në Garën Nationale të Diturisë.
- Së bashku me përfaqësuesit e Zyres së Komuniteteve kemi vizituar disa shkolla, në të cilat vijojnë mësimet nxënësit e komuniteteve RAE, me ç’rast jemi njohur nga afër me vijueshmërinë në mësimet të këtyre nxënësve.
- Në të gjitha shkollat e komunës sonë është organizuar dhe është mbajtur me sukses Testi Gjithpërfshirës me të gjithë nxënësit, nga klasa 1 deri në klasën e 12, në kuadër të Garës Nationale të Diturisë.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe me Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave është mbajtur ushtrimi “Simulim për mbrojtjen nga tërmetet. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë mbi 400 nxënës të ciklit të lartë të shkollave fillore dhe të shkollave të mesme. Kemi filluar përgatitjet për organizimin e Testit të Arritshmërisë me klasat e 9-ta. Kemi filluar përgatitjet për mbajtjen e aktivitetit sportiv me nxënësit që kanë lindur në vitin 2008, aktivitet ky i cili parashikohej të mbahej më 27 Maj 2019 nga Komiteti Olimpik i Kosovës.
- DKA dhe SHML “Xhelal Hajda-Toni” kanë nëshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), në partneritet me USAID, për të zbatuar projektin ASSET, për ngritjen e Qendrës së Karrierës në SHML “Xhelal Hajda –Toni”, projekt ky i dizajnuar për të zhvilluar shkathtësitë për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë. Motoja e këtij projekti është “Përgatitja e të rinjve për jetë dhe punë”.
- Në muajin Qershor, DKA në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, organizoi disa aktivitete pastrimi të ambientit në disa lokalitete, të paracaktuara, me ç’rast këtij aktiviteti iu bashkuan edhe mësimdhënësit dhe nxënësit.
- Drejtori i DKA-së ka marrë pjesë në prezantimin e Programit të Caritas-it Zviceran për “Ngritjen e kapaciteteve të edukimit parafillor”, me theks të veçantë në projektin e mbështetjes dhe përkrahjes në furnizim me inventar të klasave të parafillores në shkollat e komunës sonë.
- DKA në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, organizoi disa aktivitete pastrimi të ambientit në disa lokalitete të paracaktuara nga plani operativ, me ç’rast këtij aktiviteti iu bashkuan edhe mësimdhënësit dhe nxënësit. Aktivitete pastrimi pati në fshatrat Dejnë, Dobidol, Çifllak, Kramovik, Guri i Kuq dhe Polluzhë
- DKA në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, organizoi disa aktivitete pastrimi të ambientit në disa lokalitete të paracaktuara nga plani operativ, me ç’rast këtij aktiviteti iu bashkuan edhe mësimdhënësit dhe nxënësit. Aktivitete pastrimi pati në fshatrat Opterushë, Zogisht, Retijë dhe Hoçë e Vogël.
- Është mbajtur pjesa e pare e testit të maturës me të gjithë maturantët e komunës sonë. Procesi ka rrjedhur mirë, pa probleme.
- DKA së bashku me DKRS, për nder të Ditës së Çlirimit kanë organizuar Koncert për Fëmijë, i cili u mbajt në Palestrën “Mizahir Isma”.

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka për qëllim ngritjen dhe modernizimin e tregut në sektorin privat, shërbimet efikase për të gjitha bizneset e komunës sonë, poashtu, ofrimin e kushteve të të bërit biznes me një klimë më të përshtatshme për të gjithë bizneset e komunës së Rahovecit.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planin e punës për vitin 2019. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në bazë të organogramit të organizimit të brendshëm, ka të organizuar këta sektorë:

- Sektori për Ekonomi dhe Zhvillim
- Sektori për Turizëm

Aktivitetet e DEZHT-së

- Largimi i taksave komunale për bizneset prodhuese - në bazë të rregullores: 01.nr.576 . dt 28.02.2017 janë liruar 63% të bizneseve që merren me veprimtari prodhuese, kafiteritë, bizneset e tekstilit dhe të gjitha bodrumet e prodhimit të verërave (familjare) etj.
- Poashtu, jemi në përpilim të një liste të bizneseve që nuk janë aktive dhe që kanë obligime financiare ndaj komunës, t'i'u falen borxhet, me ndryshim-plotësim të Rregullores për Taksa dhe Tarifa komunale. Ky veprim po ndodhë gjatë këtij viti.
- Në bazë të një hulumtimi dhe anketimi që ju është bërë bizneseve në Kosovë nga INDEKSI I KONKURUESHMËRISË SË KOMUNAVE, Rahoveci renditet në vendin e dytë bashkë me zyrën tone të Regjistrimit të Bizneseve (ARBK-në), për shërbime të shpejta dhe efikase.
- Rritja e numrit të bizneseve për 5% gjatë katër viteve - në vitin 2019 ka një ngritje të regjistrimit të bizneseve, sipas informatave që i kemi nga zyra e ARBK-së.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Krijimi i Zonës Ekonomike dhe Zonës Turistike - Më datë 22.06.2018, me vendim të Qeverisë së Kosovës është krijuar Zona Ekonomike me një hapësirë prej 35,84 ha.
- Ka mbetur të bëhet vetëm licencimi i zonës industriale nga ana e MTI dhe fillimi i investimeve direkte në zonë.
- Ndërsa, në zonën turistike kemi bërë shtigje të reja të ecjes dhe këtë vit pritët të bëhet edhe asfaltimi i rrugës prej Epopesë së UÇK-së deri te Maja e Shkodranit.
- Përkrahja për biznese prodhuese dhe përpunuese të metalit, drurit, plastikës dhe artizanateve- Është bërë thirrja për përkrahjen e tyre.

Zyra për taksa afariste komunale

Tabela e të hyrave për periudhën raportuese

Muajt	Objektivi 2019	Viti 2019
	75.000,00 €	SHUMA
Janar		6.177,00 €
Shkurt		5.525,00 €
Mars		5.765,00 €
Prill		8.682,00 €
Maj		13.425,00 €
Qershor		8,654.00 €
TOTALI		48,228.00 €

Të hyrat nga qiraja për periudhën Janar - Qershor dhe saldoja është paraqitur në tabelën më poshtë:

1	Të hyrat nga qiraja për periudhën Janar - Qershor 2019	20,501.902 €
2	Të hyrat nga saldoja për periudhën Janar -Qershor 2019	48,868.68€

Zyra e regjistrimit të bizneseve

Për periudhën Janar - Qershor 2019, në Zyrën e Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve (QKRB) janë të regjistruara në protokoll, biznese të reja dhe janë shqyrtuar gjithsej lëndët si në tabelën vijuese:

Nr.	Përshkrimi	Viti 2019 (Janar- Qershor)
1	Biznese të reja	62
2	Shuarje Biznesi	23
3	Informatë Biznesi	27
4	Ndryshim Biznesi	39
5	Duplikat Çertifikatë	1
6	Çertifikatë UNMIK-RKS	0
7	Vërtetime	2
8	Konfirmime	4
9	Çertifikatë e Re	487
10	Numri fiskal	0
11	Konsultime + Korigjime	0
Gjithsej		645

Regjistrimi i pasurisë komunale

Punët dhe detyrat e punës janë kryer me efikasitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm, në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës nga ana e menaxhmentit.

Gjatë periudhës Janar –Qershor janë bërë këto regjistrime:

Regjistrimet e pasurisë mbi 1000€	Regjistrimet e pasurisë nën 1000€	Regjistrimi i ngastrave të tokës
67	18	165
2,105,253 €	4,460,00€	17,837,700€

Zyra për informacione turistike (ZIT-TIC)

Zyra për Informacione Turistike, në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e përcaktuara për periudhën janar-qershor 2019

- Pritje dhe informim i të gjithë turistëve që kanë frekuentuar komunën tonë gjatë kësaj periudhe;
- Takime me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që lidhen me sektorin e turizmit.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionojnë dy sektorë:

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit
- Sektori i Mjedisit.

Sektori i urbanizmit dhe planifikimit

Gjatë periudhës gjashtëmujore, në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë kryer punët të cilat janë paraparë, në bazë të Planit të Punës për vitin 2019. Kërkesat e palëve në këtë sektor janë shqyrtuar në afatin ligjor.

Gjithsej, në periudhën Janar – Qershor 2019 janë shqyrtuar kërkesa të qytetarëve, janë aprovuar, janë refuzuar, janë ceduar, ndërsa kërkesa në shqyrtim janë edhe dy lëndët e cilat kanë qenë të trashëguara nga viti 2018.

Nga këto kërkesa janë lëshuar: kushte ndërtimore, leje ndërtimore, leje rrënimi, pëlqime, leje përdorimi, ndërrim-destinimi, vërtetime urbanistike, vendime, referenca, njoftime dhe shkresa të tjera.

Aktivitetet e DUPMM-së

- Në fillim të janarit është shpallur tenderi, sipas planit të prokurimit, dhe në mars është lidhur kontrata për hartimin e projekteve në Komunën e Rahovecit. Gjatë këtij gjashtëmujori janë hartuar projektet për investime kapitale të Komunës së Rahovecit dhe të projekteve në bashkëfinancim me organizatat e tjera buxhetore: Ndërtimi i SHFMU “Liria” në Fortesë, terrenet sportive në Komunën e Rahovecit, projektet për asfaltimin e dy rrugëve (rruga Rahovec-Hamovc-Fortesë dhe Rruga Xërxë-Sapniq-Ratkoc). Është hartuar projekti për QMF-në në Çifllak, parqet në komunën e Rahovecit, rruga nga Epopeja e UÇK-së deri te Maja e Shkodranit, parkingjet në qytetin e Rahovecit, si dhe janë dhënë detyrat projektuese për hartimin e projekteve, si: Ndërtimi i çerdhes në Xërxë dhe Krushë të Madhe, ndërtimi i kullës prej guri mbi Opterushë kushtuar heronjve Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi – Mici dhe i tre bashkëluftëtarëve të tyre dëshmorë, si dhe projekti për Zonën Ekonomike për marrjen e pëlqimeve, me qëllim licencimin e kësaj zone.
- Mbikëqyrja e projekteve kapitale është bërë me kujdes nga kompania e kontraktuar. Operatori që ka për detyrë mbikëqyrjen e projekteve kapitale, vazhdimisht ka përpiluar raporte mbi punët e kryera si dhe raporte për Drejtorinë e Urbanizmit, si menaxhere e kësaj kontrate të rëndësishme për rritjen e cilësisë të punëve dhe zbatimit të kontratave për projektet kapitale të financuara nga Komuna e Rahovecit.
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në mars të këtij viti, ka propozuar që në qytetin e Rahovecit të planifikohet ndërtimi i një sheshi qendror, është propozuar lokacioni i konceptimit të sheshit, që përfshin një hapësirë prej 3 hektarë, pronë komunale e Rahovecit. Vendet që janë propozuar për krijimin e sheshit, me qëllim hapjen e zonës qendrore, janë vendet në të cilat sot ndodhen stadiumi i qytetit, tregu javor, parku i qytetit, vendi ku ka qenë Eko-Regjioni, hapësira e Hotel Parkut së bashku me parking si dhe hapësirat e tjera komunale përreth.
- Me qëllim të planifikimit dhe projektimit sa më të mirë të sheshit qendror të qytetit, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka lidhur kontaktet me organizatën ndërkombëtare që merret me Planifikim Urban, UN-Habitat, për të bashkëpunuar në krijimin e një koncepti dhe hartimit të detyrave projektuese për shpalljen e konkursit ndërkombëtar të dizajnit të sheshit. Fillimisht kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me UN-Habitat, me qëllim të bashkëpunimit të Komunës së Rahovecit me këtë organizatë në fushën e planifikimit hapësinor. Tani kemi përpiluar planin për mbajtjen e diskutimeve dhe analizave të nevojshme për planifikimin sa më të saktë të sheshit së bashku me UN-Habitat, kemi kërkuar nga KEDS-i e “KRU Gjakova” informatat për rrjetin e elektrikës, ujësjellësit dhe kanalizimit në hapësirën e propozuar për shesh, janë bërë matjet gjeodezike dhe është krijuar ekipi komunal për planifikim, ku së shpejti do të lidhim marrëveshje të re me UN-Habitat për mbajtjen e konkursit ndërkombëtar të projektit ideor për sheshin qendror të qytetit të Rahovecit.
- Është shpallur tenderi për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, poashtu, sipas planit të prokurimit dhe planit të punës për vitin 2019, shumë shpejtë pritet të lidhet edhe kontrata për të vazhduar me punë të tjera rreth procesit të hartimit së bashku me kompaninë konsulente.

- Është planifikuar të lidhet kontrata për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit, mirëpo për shkak të ankesave të operatorëve që kanë konkuruar në konkursin për hartimin e Hartës Zonale në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), nuk është lidhur kontrata dhe ende është në proces të rivlerësimit.
- Në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, përveç kompanisë së kontraktuar, kemi angazhuar edhe një punëtorë për mbledhjen e të dhënave të kërkuara, të dhënat për të gjithë infrastrukturën e komunës së Rahovecit, për kanalizimet, rrugët, rrjetin elektrik etj, në pjesën e dytë të këtij viti, synojmë që draftin e PZHK-së ta dërgojmë në kuvend për aprovim.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

Gjatë këtij gjashtëmujori, punët në investimet kapitale të menaxhuara nga Drejtoria per Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit kanë vazhduar:

- Kompleksi i Dëshmorëve në Gradish – janë shtuar punët në këtë projekt, është duke u punuar dhe këtë vit planifikohet të përfundohej.
- Renovimi dhe fasadimi i objektit për banim kolektiv – punimet kanë vazhduar sipas planit për menaxhimin e kontratës, tani është në fazën e fundit, të renovimit të çatisë së objektit në rrugën Xhelal Hajda.
- Rregullimi i shtratit të lumit në Krushë të Madhe – punimet kanë vazhduar, poashtu ka pasur ndërprerje për shkak të problemeve me kolektorë të ujërave të zeza që janë derdhur në këtë lum, është zgjidhur problemi dhe tani kompania e kontraktuar është duke i vazhduar punimet.
- Krijimi i hapësirave të glibëruara dhe mbjellja e drunjve dekorativ – punimet me këtë projekt janë përmbyllur, janë pranuar të gjitha situacionet dhe raportet e mbikëqyrjes.
- Rregullimi i shtratit të lumit në Zoqisht – punimet kanë përfunduar, jemi në pritje të raportit të komisionit për pranim teknik.
- Ndërtesa për banim social – për shkak të borxheve në këtë projekt, s’kemi arritur ta përfundojmë në këtë gjashtëmujor, mirëpo këtë vit synojmë ta përmbyllem.
- Busti për dëshmorin Mustafë Ibishi – është vendosur busti në oborrin e shkollës që mban emrin e këtij dëshmori.

Sektori i Mjedisit

Në kuadër të sektorit të mjedisit shqyrtohen kërkesat nga qytetarët për Leje Mjedisore Komunale si dhe kryhen aktivitete të tjera rreth mbrojtjes së mjedisit.

- Gjatë periudhës Janar – Qershor në këtë sektor janë lëshuar - Leje Mjedisore Komunale dhe janë realizuar të hyra.
- Poashtu, në kuadër të këtij sektori janë shënuar edhe disa aktivitete në fushën e mjedisit si: shënimi i Ditës Botërore të Pyjeve, Ditës Botërore të Ujit, Ditës Botërore të Tokës dhe Ditës Botërore të Mjedisit.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike janë identifikuar deponitë ilegale në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Janë realizuar aktivitete të përbashkëta me drejtori të tjera të komunës së Rahovecit, në pastrimin e deponive ilegale dhe aksione për pastrimin e mjeditit.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Qysh në fillim të vitit 2019 i jemi qasur punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2019.

Gjatë periudhës gjashtë mujore për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e Drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	440	10,170 €
Gjeodezi	1127	9,810 €
Referenti	2,790+18 L.Z.	11,150 €
Totali	4,357+18 L.Z.	31,130 €

- Në bazë të planit për vitin 2019 kemi incizuar dhe përfunduar disa procese të shpronësimit për interes të përgjithshëm për hapje të rrugëve të reja, siç janë: shpronësimi dhe zgjerimi i rrugës “Edit Durham”, akt vlerësimi i hapjes së rrugës publike nëpër parcelat e zonës kadastrale në Rahovec të fabrika e Plastikës etj.
- Kemi filluar në bashkëpunim me Agjensionin Kadastral të Kosovës dhe jemi ende në proces të inventarizimit dhe skenimit të dokumentacionit, i cili ende nuk është skenuar.
- Zyrtarisht kemi incizuar komplet rrugën që na dërgon te Maja e Shkodranit, rrugën Rahovec-Xërxë, Rahovec-Malishevë, rrugën tranzite deri te hyrja për tranzit për Therandë etj.
- Me kërkesë të avokatit të komunës, kemi përgatitur historiatet e parcelave kadastrale në nivel komune dhe kemi prezentuar dokumentacionin e kërkuar.
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për KPF për shpallje me interes të përgjithshëm të lëndëve në nivel Komune.
- Në bashkëpunim të ngushtë me Agjensionin Kadastral të Kosovës kemi përgatitur linjën zyrtare për ofrimin e shërbimeve edhe në pika të tjera të komunës, si në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc, ky proces ka filluar shumë mirë dhe është duke treguar rezultatet e veta në ofrimin e shërbimeve qytetarëve edhe në këto zona.
- Me kërkesë nga DKRS janë evidentuar të gjitha parcelat publike në ZK si në Rahovec, Dejnë, Apterushë etj, për projektimin e fushave sportive.
- Me kërkesë të kryetarve të fshatrave kemi kufizuar rrugë publike, sheshe, varrezat e fshatit, hapësirat e shkollës, rrugë fushore etj.
- Me kërkesë zyrtare të Inspektoratit kemi identifikuar parcelat të uzurpuara dhe kemi nxjerr aktvendime për uzurpim.
- Kemi përfunduar materialin e kërkuar nga Banka Botërore në lidhje me projektin për modernizimin e sistemit të ujitjes në të gjitha zonat kadastrale.
- Përgjigje në kërkesat e parashtruara nga Avokati i Komunës.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë 6 MUJORIT të parë të vitit 2019

Sipas planit të prokurimit të dorëzuar në (Dhjetor 2018), DSHP ka filluar të respektojë datat e dhëna në planifikim dhe menjëherë gjatë muajit janar ka përgatitur dy projekte: Projektin për furnizim me gypa nga PVC dhe projektin për intervenime emergjente.

- Gjatë fillim vitit është mbajtur takimi i tretë me radhë i komisionit komunal për stacionin e autobusëve dhe në këtë periudhë u mar vendim për shpalljen e konkursit për bordin e këtij stacioni. Pas konkursit është formuar bordi prej katër anëtarëve si dhe është shpallur konkursi për kryeshef ekzekutiv,
- Gjatë muajit janar është mbajtur debati i dytë publik, me ekspertë të komunës nga fusha të ndryshme që kanë njohuri rreth projektit të autostradës dhe pikërisht tema e këtij debati ka qenë Autostrada e Dukagjinit,

- Pas reshjeve të mëdha të borës në të gjithë territorin e komunës sonë, kemi pasur angazhime me dy kompanitë e kontraktuar nga Komuna e Rahovecit që vazhdimisht ishim në dispozicion të plotë në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve,
- Kemi caktuar zyrtarin për efikasitet që do të kujdeset më shumë me grupin tjetër punues të komunës, që në bashkëpunim me organizatën Gjermane GIZ, kanë krijuar databasën për mbledhjen e informatave të mjaftueshme në terren, në mënyrë që të dalim me raporte të sakta për gjendjen e objekteve institucionale në komunën tonë,
- Më 21 Janar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është mbajtur takim me organizatën UNDP, ku në takim të përbashkët është kërkuar mbështetje në disa projekte në kuadër të mbrojtjes së mjedisit si dhe forma e pranim-dorëzimit të impiantit në Kramavik të KRU Gjakova, që ka qenë investim nga UNDP,
- Ka filluar puna në ndërtimin e disa segmenteve rrugore në qytet dhe fshatra. Punimet kanë përfunduar në fshatin Polluzhë e Pastasel, në rrugën "Tafil Zymberi" në Rahovec dhe në rrugën e Zaqishtit ku punimet ende vazhdojnë edhe në lagjet tjera të qytetit,
- Është bërë një ndërhyrje emergjente në rrugën Fortesë-Celinë, në sanimin e gropës së krijuar në rrugë,
- Janë dërguar kërkesa zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës për projektet në vazhdim, është kërkuar të ndahet buxheti i Ministrisë për marrëveshjet e bashkëpunimit që i kemi si komunë me MIT, në projektet e trashëguara nga viti 2018 dhe ato të vitit 2019,
- Në mbledhjet e mbajtura të Kuvendit të Komunës si drejtori kemi pasur dy pika të rendit të ditës, një për themelimin e komitetit konsultativ për shërbime publike si dhe vendimin për interes të përgjithshëm të pronës ku kalon traseja e rrugës tranzite,
- Janë bërë marrëveshjet e bashkëfinancimit nga Ministria e Infrastrukturës me komunën e Rahovecit për të investuar në disa projekte që kapin shifrën mbi 1.5 milion €, ndërtimi i rrugës Rahovec- Hamoc-Fortesë dhe ndërtimi i rrugës Xërxë-Sapniq-Ratkoc, këto dy projekte tashmë janë të shpallura,
- Janë përfunduar një mori segmente rrugore të ndriçimit publik, si: 2 km i ndriçimit publik në Xërxë, janë përfunduar 3 rrugë kryesore të ndriçimit publik të lagjeve në qytet, rruga kryesore në Ratkoc në gjatësi prej 1.4 km, ndriçimi publik në varrezat e fshatit Hoçë e Vogël, rruga kryesore në Dejnë, ku vlen të theksojmë, se me vetiniciativë vullnetare, janë ndriçuar edhe 7 segmente rrugore në Dejnë,
- Ka filluar projekti i trajtimit të kanalizimeve në komunën tonë dhe deri më tani llogaritet projekti më i madh i trajtimit të ujërave fekale, ku prin qyteti i Rahovecit, pastaj edhe në 16 vendbanime të tjera, janë rehabilituar disa degëzime të kanalizimeve në Ratkoc, është përfunduar një lagje në Celinë, vazhdon projekti sipas prioriteteve edhe në vendbanime të tjera,
- Është përmbyllur segmenti i ndërtimit të trotuareve në Drenoc, në Malësi të Vogël, ka filluar në Sapniq dhe vazhdon ende,
- Janë bërë disa ndërhyrje emergjente në kanalizimin e ujërave fekale në Vrajak,
- Janë dërguar kërkesa zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës për projektet në vazhdim,
- Kemi kërkuar nga përfaqësues të UNDP-së mbështetje të projekteve në mjedis, është organizuar një takim me përfaqësues të kësaj organizate, me datën 19 shkurt në Rahovec,
- Gjatë muajit Mars, kemi mbajtur takim me të gjithë pronarët e shfrytëzuesve të garazheve publike, ku do të merren të gjitha masat dhe do të bëhet një verifikim i hollësishëm që këto garazhe të marrin epilog,
- Ka filluar puna në mirëmbajtjen e hapësirave publike, pastrimi i varrezave si dhe pastrimi i lapidarëve dhe varrezave të dëshmorëve e të vrarëve.
- Është bërë përirimi i ndriçimit në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Hoçë e Vogël.
- Ka filluar ndërtimi i mureve mbrojtëse në komunën tonë, është realizuar ndërtimi i murit në fshatin Krushë e Madhe, lagja e komuniteteve, ku për shkak të problemeve pronësore jemi detyruar të ndërhyjmë si komunë, në Rahovec në rrugën "Asllan Kleçka"- ende vazhdon projekti,
- Është përfunduar ndërtimi i murit mbrojtës të ri tek varrezat e qytetit, dhe pritet të përfundojë projekti në tërësi i rrethrotullimit.
- Janë mbajtur diskutime publike në lagjet urbane dhe vendbanimet e komunës sonë.

- Është shpallur projekti i ndërtimit të tre udhëkryqeve me semaphore të rinj, në muajin korrik fillojnë punimet,
- Në muajin Maj 2019, është lidhur një marrëveshje mirëkuptimi në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe komunës së Rahovecit për projektin më të madh të komunës sonë, “Rruga 4 korsi Rahovec-Xërxë”,
- Ka përfunduar asfaltimi i rrugës tranzite mbi qytet,
- Ka përfunduar asfaltimi i rrugës Krushë e Madhe-Randobravë,
- Kemi organizuar aksionin në pastrimin e hapësirave publike, është duke vazhduar projekti i heqjes së deponive inerte në komunën tonë, në kuadër të projektit për intervenime emergjente,
- Është përpiluar dokumenti që tregon raportin e investimeve kapitale për vitin 2018, ku ky dokument është publikuar në web-faqe të komunës!
- Sa i përket projekteve kapitale, dy projekte kapitale me MIT tashmë janë shpallur, rruga Rahovec-Hamoc-Fortese si dhe rruga Xërxë-Sapniq-Ratkoc, janë në procedurë të rregullt të tenderimit publik,
- Nga data 24 Maj, ka filluar aksioni për pastrimin e hapësirave publike, është duke vazhduar projekti i heqjes së deponive inerte në komunën tonë. Në kuadër të projektit për intervenime emergjente kemi bërë disa ndërhyrje, si dhe përmes organizimit të të gjitha shkollave, vullnetarëve dhe të gjitha institucioneve,
- Kemi mbajtur një takim me zyrtarë nga KRU Gjakova lidhur me disa projekte për furnizim me ujë të pijshëm,
- Kemi nënshkruar dy marrëveshje mirëkuptimi për projekte ndërmjet komunës së Rahovecit dhe MAPL-së, trajtimi i kanalizimeve dhe ndriçimi publik, si projekte të fituara (grande) në kuadër të performancës komunale, vlera e grandit është 60,000.00 euro.
- Jemi në përfundim të mbledhjes së të dhënave për ndriçim publik në kuadër të projektit për efikasitet të energjisë, tashmë janë duke u kompletuar të dhënat në databazë,
- Janë ri-dërguar kërkesat për planifikim të buxhetit në nivelin qendror për Ministrinë e Infrastrukturës, edhe 10 kërkesa janë ripërsëritur, kryesisht kërkesa për rrugë dhe Sheshin Qendror në qytet,
- Jemi në përgatitjen e fundit të projektit për parkingjet e reja në qytet,
- Poashtu jemi në procedurë për shpalljen e projektit për auto bartje,
- Në kuadër të drejtorisë për shërbime publike gjatë periudhës 6 mujore janë adresuar 178 kërkesa për çështje komunale, 83 kërkesa për objekte të përkohshme, të gjitha kërkesat e adresuara në drejtim të DSHP-së l’u kthehen përgjigje me shkrim dhe në intranet.

Sfidat e drejtorisë për shërbime publike për vitin 2019 janë:

- Kemi patur kërkesa të mëdha për rrjete të reja të kanalizimit, ndërtimit të rrugëve lokale, kërkesa për rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara,
- Kërkesa për mirëmbajtjen e përrrenjve dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane,
- Kërkesa të vazhdueshme për ndriçim publik në të gjitha vendbanimet,
- Kërkesa të vazhdueshme për ndërtim të trotuareve, në shumë vendbanime
- Mbeturinat e amvisërise që ende hidhen kudo, vend e pa vend, ku krijohen deponi ilegale,
- Furnizimi me ujë të pijshëm për zonat që ende nuk kanë ujë të pijshëm,
- Çështja e trajtimit të ujërave atmosferike në rrugët kryesore të qytetit.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Një ndër sektorët kryesor të cilët kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit është Bujqësia dhe Zhvillimi Rural, për këtë arsye mbështetja (përkrahja) për investimet në fermat/ekonomitë bujqësore është e një rëndësie vendimtare për të përmirësuar sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Rahovec, për të rritur prodhimtarinë dhe cilësinë e produkteve, kualitetin, vlerën e

prodhimit, fermerëve i nevojitet edhe përkrahja e cila është duke u bërë në mënyrën më të mirë, duke pasur si qëllim përafrimin e nevojave si dhe rritjen e standardeve.

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e mjedisit sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Shumica e fermave bujqësore në vendin tonë janë të masës së madhe andaj nevoja për rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet bujqve dhe prodhuesve luan një rol shumë të rëndësishëm në mënyrë që të përmbushen nevojat e tregut.

Bazuar në faktin se shumica e prodhimeve konsumohet drejtpërdrejtë nga familja në fermë, lind nevoja për përkrahje të investimeve në asetet fizike të fermave që kanë orientim komercial dhe janë në gjendje të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme.

Aktivitetet e DBPZHR-së

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2019, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vehte aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuara sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Pranim i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për tremujorin e katërt të vitit 2018 për fermerët blegtor (MBPZHR hap thirrjen në baza 3 mujore, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë).
- Poashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 5 zyrtarë të rinj me kontratë për punë specifike të cilët janë trajnuar dhe aftësuar për përdorim të programit të ministrisë gjatë procesit të aplikimit dhe digjitalizimi i parcelave),
- Në tremujorin e parë të vitit, në bashkëpunim me organizatën IADK me të cilën kemi të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi kemi implementuar disa projekte si:
 - Projekti për trajnim të të rinjëve në sektorin e bujqësisë për grupmoshat 18-29 vjeç,
 - Aplikimi dhe shpërndarja e granteve për të riatdhesuarit,
 - Grantet në sektorin e Bimëve Mjekësore Aromatike – BMA.
- Në bashkëpunim me Qendrën Grumbulluese “Agrocelina” është organizuar takim me fermerë të komunës sonë. Në këtë takim është paraqitur planifikimi i QG “Agrocelina” për vitin 2019 dhe u është prezantuar fermerëve oferta për eksport, në mënyrë që të lidhen kontratat me këtë Qendër Grumbulluese.
- DBPZHR ka ndërmarr masat dhe është përgatitur me kohë për hapjen e thirrjeve nga MBPZHR për pagesa direkte (jemi kujdesur që të furnizohemi me material administrativ për të përballuar fluksin e madh të fermerëve),
- Lidhur me pranimin e aplikacioneve, për herë të parë kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu, leje e veçantë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra. E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces.

Ky proces i fazes së aplikimit është drejt përfundimit, deri më tani kan kryer këtë proces 1,622 fermer. Të gjitha aplikacionet e pranuar nga fermerët do të kontrollohen, kompletohen dhe do të dërgohen në AZHB për pagesë.

- Duke e parë që fermerët e komunës sonë gjatë viteve të kaluara kanë hasur në vështirësi në kompletim të dokumenteve dhe hartim të projekteve, ne kemi marr përsipër që të ju dalim në ndihmë fermerëve duke asistuar dhe këshilluar fermerët për mënyrën e aplikimit, kompletim të dokumenteve dhe hartimin e projekteve.
- Për këtë arsye, ne si komunë për herë të parë kemi ndërmarrë që projektet të kryhen në kuadër të drejtorisë dhe janë pa pagesë. Gjatë kësaj kohe kemi zhvilluar procedurat për shpallje të tenderit si dhe është lidhur kontrata për “Konsulencë dhe hartim i projekteve për fermerë” që do të aplikojnë për grante në ministri. Faza e aplikimit ka filluar më 1 qershor dhe do të vazhdoj deri më 1 korrik, deri më tani janë trajtuar, mbi 200 fermer, dhe deri me datë: 28.06.2019 janë kompletuar dhe dorëzuar 28 projekte për sektorë të ndryshëm. Afati për aplikim me kërkesë të drejtorisë sonë është zgjatur deri më 12 korrik 2019.
- Në kuadër të zyrës këshillimore e cila ka lidhje direkte me MBPZHR, janë organizuar trajnime për fermerë, kryesisht në sektorin e Blegtorisë dhe të Bletarise. Ndërkohë në periudhën e dytë të vitit duke u bazuar në planin e hartuar nga MBPZHR do të mbahen edhe trajnime në sektorët e perimkulturës dhe të vreshtarisë.
- Në sektorin e blegtorisë, në bashkëpunim me Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinës është kryer repelimi i kafshëve të komunës sonë për parandalimin dhe mbrojtje nga rriqrat (gjithsej 6,147 gjedhe 12,140 dele dhe 1,402 dhi në 33 fshatra dhe qytet).
- Në bashkëpunim me drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, janë zhvilluar procedurat për dhënie të pronës komunale me qira. Janë shpallur ankande publike dhe pasi janë përfunduar procedurat janë lidhur edhe kontratat me qiramarrësit.
- Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për dëmshpërblim të fermerëve dhe ndarja e mjeteve prej 1 milion Euro ka aktualizuar temën e dëmeve të shkaktuara gjatë vitit 2018. Përpilimi i listave pranimi i dokumenteve dhe dërgimi i tyre në Ministri të Financave ka karakterizuar tremujorin e dytë të këtij viti. Deri më tani janë kompenzuar 1,224 fermer poashtu janë trajtuar mbi 100 raste të ankesave të cilat janë verifikuar dhe shqyrtuar nga komisioni.
- Poashtu edhe këtë vit muaji maj dhe qershor janë përcjellur me shira të rrëmbyeshëm
- Më 26 prill kemi hapur thirrje për pranim të aplikacioneve për mekanizëm bujqësor, thirrja ka qëndruar e hapur deri më 24 maj. Gjatë kësaj peridhue janë pranuar gjithsej 844 aplikacione, për 12 pajisje bujqësore për sektor të ndryshëm si: vreshtari, perimtari, blegtori, bletari etj.
- Kemi formuar komision për vlerësim të këtyre aplikacioneve dhe është duke vazhduar procesi i vlerësimit duke u bazuar në kriteret e përcaktuara. Poashtu janë zhvilluar edhe procedurat e prokurimit për furnizim me këto pajisje.
- Në sektorin e pylltarisë është shënuar Dita Ndërkombëtare Pyjeve - Në bashkëpunim me Asociacionin e Pronarëve Privat të Pyjeve është organizuar Dita Ndërkombëtare e Pyjeve, janë siguruar 1,000 fidane për komunën e Rahovecit të cilat janë mbjell në lokacione ku janë përkujtuar të rënë për liri me moton “ Një fidan, një kujtim”.
- Poashtu, duke u bazuar në planin për rritje të sipërfaqeve me pyje të reja të aprovuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, është përkufizuar lokacioni në vendin e quajtur Boka.
- Pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët si dhe shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: Vërtetim për fermer, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë etj.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Me përmirësimin e kushteve klimatike ka rifilluar nërtimi i serrave nga Operatori Ekonomik që ka kontratë me komunën e Rahovecit. Në qershor ky projekt ka përfunduar dhe janë ndërtuar gjithsej 117 serra.
- Përfundimi i këtij projekti hap rrugën për shpallje të thirrjes së re për fermerë.

- Edhe përkundër motit jo të mirë që ka mbizotëruar në këtë periudhë raportuese, punimet janë zhvilluar me intenzitet më të dobët, tani me përmirësimin e kushteve atmosferike punimet kanë marrur hov të zhvillimit dhe janë duke vazhduar.
- Projekti për uljen e nivelit të përroit në fshatin Celinë, ka vazhduar edhe përkundër faktit se gjatë punimeve janë shfaqur disa probleme, si është rasti me nënkalimin te hekurudha, pengesat e gypëve të sistemit të ujitjes, por që tani janë tejkaluar dhe projekti është në fazën përfundimtare. Tani punimet janë duke vazhduar në segmentin e tretë nën magjistralen Prizren-Gjakovë, dhe me përfundimin e këtij segmenti do të konsiderohet i tërë projekti i përfunduar.
- Projekti “Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit” - janë kryer të gjitha pozicionet dhe është pranuar teknikisht. Kanë filluar procedurat për fazën e dytë, ku theksi do të bie te ndërtimi i shtëpizave (tezgëve) prej druri që shërbejnë për ekspozim dhe shitje të produkteve bujqësore si dhe disa pozicioneve që janë të parapara me projekt.
- Projekti i kullimit të tokave bujqësore në Xërxë - banorët kanë parashtruar kërkesë që kanali në segmentin përgjatë rrugës të ndërtohet i mbyllur. Ne e kemi aprovuar këtë kërkesë pasi kemi konsideruar se ka arsyeshmëri. Projekti është duke vazhduar sipas planit dinamik të paraqitur nga operatori ekonomik.

Përfundim

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Duke u bazuar në planin e punës kemi devijim nga ajo çka ne kemi planifikuar pasi që periudha e parë që përfshinë muajt janar, shkurt dhe mars kemi paraparë që të zhvillohet procesi i aplikimit për pagesa direkte - subvencione në kuadër të MBPZHR-së, dihet se hapja e fazës së aplikimit këtë vit është e vonuar nga ana e ministrisë dhe si rezultat i kësaj ka edhe mospërputhje me planin vjetor të punës

Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm.

Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionist të fushave, me theks të veçant ingjiner të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.

DREJTORIA PËR INSPEKTIM

